



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**



---

**DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË  
PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

**PUNIM PËR GRADËN SHKENCORE “DOKTOR” NË GJUHËSI**

**Specialiteti: DIDAKTIKË**

Disertante:

M.A. Enkela Dalipi (Gegprifti)

Udhëheqëse shkencore:

Prof. Dr. Andromaqi Haloçi

*Tiranë, Korrik 2015*



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**

---



**KOMISIONI I VLERËSIMIT:**

Prof. dr. Artur Sula - (Kryetar, Oponent)

\_\_\_\_\_

Prof. dr. Raul Lilo - (Oponent)

\_\_\_\_\_

Prof. dr. Irena Ndoci Lama - (Anëtare)

\_\_\_\_\_

Prof. asoc. dr. Elida Tabaku- (Anëtare)

\_\_\_\_\_

Prof. asoc. dr. Eldina Nasufi- (Anëtare)

\_\_\_\_\_

**Tiranë, Korrik 2015**

## **Falënderime**

Do të doja të shprehja falënderimet e mia për të gjithë ata të cilët më kanë ndihmuar në realizimin e këtij punimi.

Mirënjohje për Prof. Dr. Andromaqi Haloçi, udhëheqësen shkencore, e cila me përkushtim të pashoq ka ndjekur ecurinë e këtij punimi.

Falënderime të veçanta shkojnë për miqtë, kolegët e mi të Departamentit të gjuhës italiane sugjerimet dhe mbështetjen e tyre të pakursyer.

Falënderoj nga zemra prindërit e mi, bashkëshortin, Fredin, për kujdesin e treguar, inkurajimin e vazhdueshëm dhe nxitjen për të përgatitur një punim sa më dinjitoz, dhe veçanërisht tre vajzat e mia, Rean, Sarën dhe Vivienin

# PASQYRA E LËNDËS

## HYRJE

- 0.1. Përligjja e punimit.....I
- 0.2. Objekti dhe hipotezat e punimit.....III
- 0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit.....V

## KREU I

### NATYRA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT DHE RAPORTI I TYRE ME GJUHËN E ZAKONSHME

- I.1. Përkufizimi i gjuhëve të huaja të specialitetit.....fq.1
- I.2. Natyra e gjuhëve të specialitetit.....fq.6
- I.3. Raporti i ndërsjelltë mes gjuhës së zakonshme dhe GJHS-it .....fq.10
- I.3.1. Rezultatet e punës kërkimore.....fq.11

## KREU II

### VEÇORITË E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT. ANALIZË E GJUHËS ITALIANE JURIDIKE, EKONOMIKE DHE MJEKËSORE

- II.1. Veçori të përgjithshme të GJHS-it.....fq.16
- II.1.1. Veçori leksikore.....fq.16
- II.1.2. Veçori morfo-sintaksore.....fq.20
- II.1.3. Veçori tekstuale.....fq.21
- II.1.4. Veçori jashtëgjuhësore.....fq.24
- II.2. Analizë e Gjuhës italiane ekonomike, juridike dhe mjekësore.....fq.25
- II.2.1. Analizë e gjuhës italiane juridike.....fq.26
- II.2.2. Analizë e gjuhës italiane ekonomike.....fq.31
- II.2.3. Analizë e gjuhës italiane mjekësore.....fq.35

### **KREU III**

#### **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË SHOQËRINË E SOTME KOMPLEKSE DHE TË SEKTORIALIZUAR**

- III.1. Mësimi i gjuhëve të huaja të specialitetit sot në botë.....fq.42
- III.2. Problematikat që verifikohen gjatë procesit të mësimdhënies së GJHS-it.....fq.50
- III.3. Mësuesi i gjuhëve të specialitetit, gjuhëtar apo specialist i fushës?.....fq.53
  - III.3.1. Roli dhe kompetencat e mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit.....fq.54
- III.4. Ndërveprimi mësues-nxënës, një proces i rëndësishëm për mësimdhënien-mësimnxënien e gjuhëve të huaja të specialitetit.....fq.57
- III.5. Analiza e nevojave, pikënisje e kurrikulës së Gj.H.S. ....fq.60
- III.6. Formimi i vazhdueshëm profesional i mësuesit të GJHS-it, domosdoshmëri në realitetin e sotëm të mësimdhënies.....fq.65

### **KREU IV**

#### **AFTËSITË E STUDIMIT DREJT PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NË GJUHË SPECIALITETI**

- IV.1. Vështirësitë e nxënësve gjatë përvetësimit të aftësive të studimit.....fq.68
  - IV.1.1. Metoda e vëzhgimit të vështirësive mbi aftësitë e studimit.....fq.69
- IV.2. Aftësitë e studimit për përvetësimin e GJHS.....fq.74
- IV.3. Studime teorike mbi komunikimin e specializuar: .....fq.85
- IV.4. Përvetësimi i kompetencës së komunikimit në GJHS-it.....fq.90

### **KREU V**

#### **DIMENSIONI NDËRKULTUROR NË MËSIMDHËNIEN/MËSIMNXËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT**

- V.1. Mësimdhënia ndërkulturore e gjuhëve të huaja.....fq.96
  - V.1.1. Vështirësitë e komunikimit ndërkulturore.....fq.100
  - V.1.2. Strategjitë didaktike në funksion të komunikimit ndërkulturore.....fq.105
- V.2. Aspekte socio-kulturore në komunikimin e specializuar.....fq.107

V.2.1. Specifikat socio-kulturore në gjuhën juridike.....	fq.109
V.2.2. Specifikat socio-kulturore në gjuhën ekonomike.....	fq.114
V.2.3. Specifika socio-kulturore në gjuhës italiane mjekësore.....	fq.119

## **KREU VI**

### **NJËSI DIDAKTIKE NË GJUHËN ITALIANE JURIDIKE, EKONOMIKE DHE MJEKËSORE**

V1.1. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane juridike.....	fq.122
VI.1.1. Programimi i përmbajtjes.....	fq.122
VI.1.2. Veprimtari praktike.....	fq.126
VI.2. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane ekonomike.....	fq.138
VI.2.1. Programimi i përmbajtjes.....	fq.138
VI.2.2. Veprimtari praktike.....	fq.141
VI.3. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane mjekësore.....	fq.150
VI.3.1. Programimi i përmbajtjes.....	fq.150
VI.3.2. Veprimtari praktike.....	fq.154

<b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>fq.168</b>
--	---------------

<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>fq.175</b>
--------------------------	---------------

#### **SHTOJCA 1**

Veprimtari kërkimore në fjalorin italian <i>Zingarelli</i> .....	fq.182
--	--------

#### **SHTOJCA 2**

Pyetësor mbi mësimdhënien e GJHS-it.....	fq.205
--	--------

#### **SHTOJCA 3**

Glosar i termave juridikë, ekonomikë, mjekësorë në gjuhën italiane .....	fq.208
--	--------

## **Falënderime**

Do të doja të shprehja falënderimet e mia për të gjithë ata të cilët më kanë ndihmuar në realizimin e këtij punimi.

Mirënjohje për Prof. Dr. Andromaqi Haloçi, udhëheqësen shkencore, e cila me përkushtim të pashoq ka ndjekur ecurinë e këtij punimi.

Falënderime të veçanta shkojnë për miqtë, kolegët e mi të Departamentit të gjuhës italiane sugjerimet dhe mbështetjen e tyre të pakursyer.

Falënderoj nga zemra prindërit e mi, bashkëshortin, Fredin, për kujdesin e treguar, inkurajimin e vazhdueshëm dhe nxitjen për të përgatitur një punim sa më dinjitoz, dhe veçanërisht tre vajzat e mia, Rean, Sarën dhe Vivienin

# PASQYRA E LËNDËS

## HYRJE

- 0.1. Përligjja e punimit.....I
- 0.2. Objekti dhe hipotezat e punimit.....III
- 0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit.....V

## KREU I

### NATYRA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT DHE RAPORTI I TYRE ME GJUHËN E ZAKONSHME

- I.1. Përkufizimi i gjuhëve të huaja të specialitetit.....fq.1
- I.2. Natyra e gjuhëve të specialitetit.....fq.6
- I.3. Raporti i ndërsjelltë mes gjuhës së zakonshme dhe GJHS-it .....fq.10
- I.3.1. Rezultatet e punës kërkimore.....fq.11

## KREU II

### VEÇORITË E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT. ANALIZË E GJUHËS ITALIANE JURIDIKE, EKONOMIKE DHE MJEKËSORE

- II.1. Veçori të përgjithshme të GJHS-it.....fq.16
- II.1.1. Veçori leksikore.....fq.16
- II.1.2. Veçori morfo-sintaksore.....fq.20
- II.1.3. Veçori tekstuale.....fq.21
- II.1.4. Veçori jashtëgjuhësore.....fq.24
- II.2. Analizë e Gjuhës italiane ekonomike, juridike dhe mjekësore.....fq.25
- II.2.1. Analizë e gjuhës italiane juridike.....fq.26
- II.2.2. Analizë e gjuhës italiane ekonomike.....fq.31
- II.2.3. Analizë e gjuhës italiane mjekësore.....fq.35



### **KREU III**

#### **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË SHOQËRINË E SOTME KOMPLEKSE DHE TË SEKTORIALIZUAR**

- III.1. Mësimi i gjuhëve të huaja të specialitetit sot në botë.....fq.42
- III.2. Problematikat që verifikohen gjatë procesit të mësimdhënies së GJHS-it.....fq.50
- III.3. Mësuesi i gjuhëve të specialitetit, gjuhëtar apo specialist i fushës?.....fq.53
  - III.3.1. Roli dhe kompetencat e mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit.....fq.54
- III.4. Ndërveprimi mësues-nxënës, një proces i rëndësishëm për mësimdhënien-mësimnxënien e gjuhëve të huaja të specialitetit.....fq.57
- III.5. Analiza e nevojave, pikënisje e kurrikulës së Gj.H.S. ....fq.60
- III.6. Formimi i vazhdueshëm profesional i mësuesit të GJHS-it, domosdoshmëri në realitetin e sotëm të mësimdhënies.....fq.65

### **KREU IV**

#### **AFTËSITË E STUDIMIT DREJT PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NË GJUHË SPECIALITETI**

- IV.1. Vështirësitë e nxënësve gjatë përvetësimit të aftësive të studimit.....fq.68
  - IV.1.1. Metoda e vëzhgimit të vështirësive mbi aftësitë e studimit.....fq.69
- IV.2. Aftësitë e studimit për përvetësimin e GJHS.....fq.74
- IV.3. Studime teorike mbi komunikimin e specializuar: .....fq.85
- IV.4. Përvetësimi i kompetencës së komunikimit në GJHS-it.....fq.90

### **KREU V**

#### **DIMENSIONI NDËRKULTUROR NË MËSIMDHËNIEN/MËSIMNXËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT**

- V.1. Mësimdhënia ndërkulturore e gjuhëve të huaja.....fq.96
  - V.1.1. Vështirësitë e komunikimit ndërkulturore.....fq.100
  - V.1.2. Strategjitë didaktike në funksion të komunikimit ndërkulturore.....fq.105
- V.2. Aspekte socio-kulturore në komunikimin e specializuar.....fq.107

V.2.1. Specifikat socio-kulturore në gjuhën juridike.....	fq.109
V.2.2. Specifikat socio-kulturore në gjuhën ekonomike.....	fq.114
V.2.3. Specifika socio-kulturore në gjuhës italiane mjekësore.....	fq.119

## **KREU VI**

### **NJËSI DIDAKTIKE NË GJUHËN ITALIANE JURIDIKE, EKONOMIKE DHE MJEKËSORE**

V1.1. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane juridike.....	fq.122
VI.1.1. Programimi i përmbajtjes.....	fq.122
VI.1.2. Veprimtari praktike.....	fq.126
VI.2. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane ekonomike.....	fq.138
VI.2.1. Programimi i përmbajtjes.....	fq.138
VI.2.2. Veprimtari praktike.....	fq.141
VI.3. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane mjekësore.....	fq.150
VI.3.1. Programimi i përmbajtjes.....	fq.150
VI.3.2. Veprimtari praktike.....	fq.154

<b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>fq.168</b>
--	---------------

<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>fq.175</b>
--------------------------	---------------

#### **SHTOJCA 1**

Veprimtari kërkimore në fjalorin italian <i>Zingarelli</i> .....	fq.182
--	--------

#### **SHTOJCA 2**

Pyetësor mbi mësimdhënien e GJHS-it.....	fq.205
--	--------

#### **SHTOJCA 3**

Glosar i termave juridikë, ekonomikë, mjekësorë në gjuhën italiane .....	fq.208
--	--------

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## KREU I

### NATYRA E GJUHËVE TË SPECIALITETIT DHE RAPORTI I TYRE ME GJUHËN E ZAKONSHME

#### I.1. Përkufizimi i Gjuhëve të Specialitetit

Ekziston një çështje terminologjike lidhur me përkufizimin e gjuhëve të specialitetit. J.Martin i vendos gjuhët e specialitetit mes “*realites introuvables*”<sup>1</sup>, të cilat i shmangen analizës dhe formalizimit, edhe pse janë qartësisht të pranishme në përdorimin e përditshëm të çdo gjuhe, në të cilën prodhohen tekste të karakterit sekorial, teknik apo shkencor.

Në fakt, mungon një term i unifikuar në referim të tyre, të cilat përgjithësisht quhen edhe *gjuhë të veçanta, nënkode, mikrogjuhë*, apo *gjuhë sektoriale*, në ambientin anglosakson *gjuhë për qëllime të veçanta*, ku fjala kyçe është pikërisht qëllime, pra një gjuhë që u intereson atyre të cilët kanë qëllime të caktuara për ta mësuar. Kjo shumëllojshmëri terminologjike, e cila shpesh mund të duket shenjë konfuzioni, është dëshmia e etapave kronologjike të mësimin të gjuhës së huaj për një qëllim të caktuar. Pavarësisht nuancave që marrin këto terma, dhe që janë objekt i studimeve të shumta, ajo që i bashkon është aspekti funksional: pra janë gjuhë, të cilat përdoren me një funksion specifik e që shpesh janë të pakuptueshme për individë të cilët nuk janë pjesë e sektorit.

Në këtë punim është zgjedhur të përdoret termi i përgjithshëm “**Gjuhë specialiteti**”, i cili përfshin tërësinë e përkufizimeve të zgjedhura nga studiues të ndryshëm të fushës, pavarësisht nuancave. Gjuhët e specialitetit, edhe pse kanë një histori të tyre, shënojnë mungesa të një koordinimi të përgjithshëm lidhur me kërkime sistematike të një fushe, në proces zhvillimi. Ekzistojnë publikime dhe studime të ndryshme, të cilat paraqesin shpesh një mungesë të dukshme homogjeniteti dhe këndvështrime të ndryshme. Pra, ndihet mungesa e një vizioni të përgjithshëm apo të një teorie referuese, tek të cilat të inkuadrohen kërkimet parciais apo të specializuara.

Problematika e gjuhëve të specialitetit është e pranishme, në mënyrë të kodifikuar, që në vitet Tridhjetë të shekullit të kaluar. Gjuhëtari britanik John Ruper Firth<sup>2</sup>, në nivel zbatues propozon një përfaqje situacionale, bazuar mbi përdorimin gjuhësor, duke i konsideruar varietetet e gjuhëve të veçanta, lidhur me role të caktuara shoqërore, interesa

---

<sup>1</sup> J. Martin. *La langue de specialite: propositions pour une recherche*. “Bulletin CILA”, 39 (1984), fq..23

<sup>2</sup> John Ruper Firth (1890-1960), leader i Gjuhësisë britanike në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

profesionale, apo aktivitete pune, si “*restricted languages*” (gjuhë të kufizuara)<sup>3</sup>. Studimet e Firth-it mbi gjuhët e kufizuara u zgjeruan dhe u thelluan nga të ashtuquajturit gjuhëtarë neo-firthianë, të cilët përpunuan teknika të veçanta të gjuhësisë deskriptive, të njohura si ‘Analizë e regjistrit’. Në fund të viteve Gjashtëdhjetë, analiza e regjistrit ka qenë teknika më e zhvilluar për të mësuar anglishten për qëllime të veçanta.

Fillimisht studimet preknin tematika kryesisht leksikore lidhur me këto gjuhë. Më vonë, ato u përqëndruan, në njëzetvjeçarim e fundit të shekullit të kaluar, në fushën e didaktikës. Përqaqsa është e llojit funksional, janë nevoja dhe çështje që propozohen në procesin dhe praktikën didaktike, por edhe në aspektin teorik, të cilat kanë nxitur propozimin e modeleve të reja të mësimdhënies së gjuhëve të specialitetit. Vitet e fundit, është nënvizuar edhe në kërkimet didaktike, nevoja në rritje për një komunikim të qartë dhe të kuptueshëm, edhe pse e karakterit të specializuar, në një disiplinë të caktuar.

Nga një analizë kërkimore mbi literaturën dhe studimet që janë kryer në fushën e glotodidaktikës, jemi përpjekur të sjellim disa përkufizime të zërave akademikë bashkëkohorë më të spikatur të shkollës italiane, lidhur me gjuhët e specialitetit.

Termi i cili përdoret fillimisht ishte *gjuhë të veçanta*, edhe pse përdorimi ishte tejet i kufizuar, për t’iu referuar gjuhëve të cilat përdornin rregulla dhe simbole të veçanta. Për shembull, si gjuhë e veçantë njihet *Kodi Q*, përgjithësisht i përdorur në sektorin e komunikacioneve. Në këtë rast, kemi një kod komunikimi të ndryshëm nga ai gjuhësor, ku edhe pse përdoren shkronja, numra dhe shenja pikësimi, janë të pranishme konvencione tërësisht autonome dhe të ndryshme.

Gjatë viteve, ‘70 merr jetë përkufizimi *Gjuha për qëllime specifike*, sipas modelit anglosakson (*Language for Specific Purpose*), duke zënë një vend të dukshëm në didaktikën e gjuhëve të huaja. Në veçanti, ky përkufizim i referohej çdo lloj mësimdhënieje e cila kishte për qëllim të plotësonte qëllime praktike, të dobishme dhe qartësisht të identifikueshme.

Studiuesi i gjuhëve **Gian Luigi Beccaria**, në vitin 1973, për herë të parë sqaron problemin lidhur me përkufizimin e gjuhëve të specialitetit, duke bërë dallimin mes *gjuhëve të veçanta* dhe *gjuhëve sektoriale*. Me përkufizimin e parë, ai nënkupton një gjuhë më teknike, ndërsa me termin e dytë një gjuhë, e cila sikurse shprehet ai “*bashkon maksimumin e zgjerimit terminologjik me maksimumin e teknikizmave*,”<sup>4</sup> duke iu referuar në këtë mënyrë nëndarjes që vjen nga studimet gjermanofone, të cilat karakterizojnë termin e parë si *zhargon* (*Fachsprache*) dhe termin e dytë si *gjuhë teknike* (*Sonderprache*), jo domosdoshmërisht të specializuara, por që mund të identifikohen me një gjuhë të specializuar (për shembull gjuha e politikës apo e gazetarisë). Teza që studiuesi përpiket të tregojë është se përmes gjuhëve sektoriale, të konsideruara si gjuhë prestigjioze është arritur të kthehet gjuha italiane një gjuhë të të gjithë qytetarëve, dhe jo e kufizuar vetëm tek një elitë. Bëhet fjalë për raportin mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhës së specialitetit, për të cilën do të flitet në vazhdim. Beccaria parapëlqen termin *gjuhë*

<sup>3</sup> Annamaria Caimi Valentini, *Esp-Lsp, un modello teoriko-applicativo per una didattica di microlingua*. Fq.164-165.

<sup>4</sup> Beccaria G.L. cituar në Cavagnoli S. *La Comunicazione Specialistica*. Carocci, 2007, fq.15

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

*settoriale*, i cili pas publikimit të librit të tij në vitin 1973, gjeti një përdorim gjithnjë e më të gjerë në fushat e kritikës, politikës dhe gazetarisë, kurse nuk mungon edhe termi *gjuhë të veçanta*, i përdorur njëzet vjet më vonë, në Fjalorin e Gjuhësisë, hartuar po nga Beccaria në vitin 1994.

**Dardano M.**<sup>5</sup>, duke përdorur termin gjuhë sektoriale dallon mes tyre *gjuhët e forta* (të organizuara dhe të qëndrueshme nga pikëpamja leksikore, sikurse është gjuha e matematikës) dhe *gjuhët e dobëta* (me organizime leksikore më pak të strukturuar, duke iu referuar gjuhës juridike).

**Balboni P.E.**<sup>6</sup>, një studiues i njohur dhe bashkëkohor i glotodidaktikës, teksa trajton gjerësisht këtë problem, i referohet termit *Mikrogjuhë*, të cilin e përdor kryesisht në didaktikën e gjuhëve të huaja dhe të studimeve glotodidaktike për të mësuar “gjuhën për qëllime të veçanta”. Termi *mikrogjuhë*, përcakton sipas Balbonit një varietetet gjuhe që specialistët e një sektori të caktuar shkencor apo profesional e përdorin me një qëllim të dyfishtë:

1. Të shprehin maksimumin e qartësisë (për shembull, duke zëvendësuar fjalën me termin);
2. Të lejojnë atë që e përdor të identifikohet si anëtar i grupit shkencor-profesional që ndan një mikrogjuhë.

Ai propozon një klasifikim me gjashtë nëndarje:

- Mikrogjuha e shkencave juridiko-ekonomike;
- Mikrogjuha e filozofisë dhe e shkencave sociale;
- Mikrogjuha e shkencave natyrore;
- Mikrogjuha e shkencës dhe teknologjisë;
- Mikrogjuha e komunikimit;
- Mikrogjuha e Forcave të Armatosura.

Teksa flet për didaktikën bashkëpunuese, Balboni e ndan termin ‘mikrogjuhë’ në dy pjesë përbërëse: nxënësi ofron kompetencën e tij lidhur me termin ‘*micro*’, ndërsa mësuesi kontribuon me kompetencën e tij në ‘*gjuhë*’. Këto kategori të përcaktuara nga Balboni, nuk pranohen apo klasifikohen në mënyrë të ngjashme nga studiues të tjerë të fushës.

**Berruto G.**<sup>7</sup> krahas përkufizimit *Gjuhë të veçanta*, (1990), përdor në mënyrë sinonimike edhe termin *nënkode*. Ato ai i përcakton si varietete të karakterizuara nga një leksik i veçantë dhe të përdorura për të komunikuar argumente, të lidhur me aktivitete të caktuara profesionale. Gjuhët e veçanta Berruto i ndan në tre nivele:

<sup>5</sup> Dardano M. *Linguaggi settoriali e processi di riformulazione*. Dress, 1987. Fq. 140-142.

<sup>6</sup> Balboni P.E. *Le microlingue scientifico-professionali. Natura e Insegnamento*. Utet .Fq 10-11.

<sup>7</sup> Cavagnoli S. *La Comunicazione Specialistica*. Carocci, 2007, fq.15.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- *Gjuhët e veçanta, në kuptimin e ngushtë të fjalës*, nënkode të mirëfillta të cilat dallohen nga një leksik i veçantë dhe nga një morfosintaksë dhe tekste karakteristike;
- *Gjuhët e veçanta në kuptimin e gjërë, ose gjuhët sektoriale*, të cilat nuk kanë një leksik të caktuar specifik, por janë të lidhura gjithësesi me fusha përdorimi të veçanta, me zgjedhje leksikore dhe tekstuale të përshtatshme për situata komunikuese.
- *Zhargonet*, të cilat kanë një leksik të veçantë, me mekanizmat e veta semantike dhe të fjalëformimit, por pa veçorinë e nomenklaturës. Ato janë të lidhura me grupe apo përdorues, por jo me sfera argumentash dhe fushash jashtëgjuhësore.

**Sobrero A.**<sup>8</sup> në studimin e tij të vitit 1993, i referohet, sikurse Berruto, termit *Gjuhë të veçanta*, duke e konsideruar këtë përkufizim si më të përgjithshëm kundrejt emërtimeve të tjera. Gjuhët e veçanta, sipas tij, janë një bashkësi e përcaktuar, që përfshijnë në brendësi të saj varietete të diferencuara. Kriteri i diferencimit është kriteri i specializimit, ku Sorbrero përcakton dy nënsisteme:

- *Gjuhët e specializuara*, që i përkasin dhe karakterizojnë disiplina me një gradë të lartë specializimi, sikurse mjekësia, fizika, informatika, gjuhësia, e drejta, të cilat kanë një leksik specifik dhe rregulla tipike, konvencionalisht të caktuara dhe të pranuar, zgjedhje sintaksore të sakta dhe struktura tekstuale të kodifikuara;
- *Gjuhët sektoriale*, të përdorura në sektorë të veçantë, me një nivel më të ulët specialiteti, të cilat i përkasin sektorëve dhe fushave të punës; ato nuk kanë një leksik të vetin specifik, as rregulla të veçanta, por importojnë nga gjuha e zakonshme fjalë, shprehje, metafora e teknikizma. Këtu, Sorbrero përfshin gjuhën e medias së shkruar, të politikës dhe të publicitetit.

Diferenca më thelbësore mes gjuhëve të specializuara dhe gjuhëve sektoriale, sipas Sobreros, qëndron në nivelin më të lartë apo më të ulët të leksikut të specializuar, veçori kjo e cila lidhet me modalitetin dhe qëllimet e përdorimit të tyre. Mesazhet e gjuhëve sektoriale përhapen në pjesën më të madhe të tyre nga masmedia: grada më e ulët e specialitetit të leksikut i detyrohet faktit të kuptimit të tij nga ana e një publiku më të gjerë, kurse gjuhët e specializuara ruajnë një terminologji lartësisht të specializuar, pasi edhe qarkullimi i mesazheve është më i kufizuar dhe i caktuar për ekspertët e fushës. Pra, ndryshimi lidhet me leksikun dhe me rregullat mbi formimin e fjalëve: një përdorim i ngurtë apo më pak i ngurtë i termave, sikurse dhe nga sasia e termave specifike të një gjuhe. Nga një analizë e thjeshtë vërejmë se si Sorbrero nisët nga gjuhët sektoriale për të arritur tek gjuhët e veçanta, të cilat konsiderohen prej tij si një hiperonim.

**Mengaldo P.V.**<sup>9</sup> (1994), në lidhje me përshkrimin e aspekteve kryesore të gjuhëve të specialitetit, i referohet pjesërisht Berruttos, duke dalluar në të njëjtën mënyrë *gjuhët e veçanta nga gjuhët sektoriale*: të parave ai u jep statusin e një nënkodi të mirëfilltë, me veçori leksikore dhe pjesërisht morfo-sintaksore të tyre. Ndërsa, me gjuhë sektoriale, ai i

<sup>8</sup> Sobrero A. A. *Introduzione all'italiano contemporaneo*. Laterza, Roma-Bari 1993.

<sup>9</sup> Cavagnoli S. *La Comunicazione Specialistica*. Carocci, 2007, fq.15.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

referohet atyre gjuhëve, të cilat kanë një status më të përgjithshëm. Veçoritë e tyre janë zgjedhjet leksikore të përcaktuara, formula sintaksore dhe tekstuale të ndryshme. Një shembull për kategorinë e gjuhëve sektoriale, sipas Mengaldos është gjuha juridike.

Përkufizimin *gjuhë sektoriale* japin edhe **Pittano G.** dhe **Bersani G.**<sup>10</sup> (1993), në publikimet e tyre, kryesisht të karakterit didaktik, duke nënkuptuar me këtë term të gjitha format gjuhësore, të cilat janë më specifike kundrejt gjuhës së zakonshme (kryesisht në fushat e gazetarisë, politikës, të së drejtës, të sportit etj).

**Gotti M.**<sup>11</sup> (1991) përdor termin *gjuhë specialiteti*, në perspektivën e përdoruesit të gjuhës, pra të ekspertit, dhe i referohet në këtë mënyrë realitetit të fushave të ndryshme profesionale.

Tabela e mëposhtme sjell përkufizimet e përdorura në studime dhe publikime të zërave italianë më të njohur të fushës së gjuhësisë. Ajo që spikat është fakti se i njëjti autor mund të ketë përdorur më shumë se një përkufizim për termin në fjalë, ç'ka imponon një liri subjektive në përdorimin e tyre.

**Tabela I.1.**  
**Përkufizimet**<sup>12</sup>

<b>Përkufizimet</b>	<b>Autorët</b>
Gjuhë e veçantë	Berruto, Sobrero, Cortelazzo, Mengaldo
Mikrogjuhë	Balboni, Freddi
Gjuhë sektoriale	Beccaria, Bertinetto, Rossini Favretti
Gjuhë të specializuara	Porcelli, Ciambaghi
Gjuhë speciale	De Mauro, Cecioni
Gjuhë për qëllime të veçanta/ Nënkode	Balboni, Porcelli, Ciliberti, Titone
Gjuhë specialitetit	Gotti, Cavagnoli
Komunikim i specializuar	Kalverkamper, Cavagnoli

<sup>10</sup> Pittano G, Bersani S. *L'italiano. Le tecniche del parlare e dello scrivere*. Sonzogno, Milano

<sup>11</sup> Gotti M. *I linguaggi specialistici: caratteristiche linguistiche e criteri pragmatici*, në Cavagnoli S. *La Comunicazione Specialistica*. Carocci, 2007, fq.16.

<sup>12</sup> Në këtë tabelë janë shtuar edhe emra të tjerë studiuesish të cilët bashkohen me autorët e përmendur në tekst në përdorimet e përkufizimeve mbi gjuhët e specialitetit.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Paraqitja e mendimeve dhe e përkufizimeve të ndryshme, përdorimi i diferencuar i shumë termave me funksionin sinonimik, lë vend për një zgjedhje personale, që në thelbin e saj bashkohet me qëllimin e njohjes dhe përvetësimit të këtyre gjuhëve.

Nisur nga sa më lart dhe, duke konsideruar lirinë subjektive të përdorimit të termit, kemi përzgjedhur në këtë punim të përdorim përkufizimin **Gjuhë Specialiteti**, pasi është një term i cili në të shumtën e rasteve është i lidhur me dimensionin pragmatik të gjuhës: atë të komunikimit dhe vendos theksin mbi të tre elementët e komunikimit: folësin, gjuhën dhe realitetin në të cilën ndodh komunikimi i specializuar.

Tendenca e viteve të fundit, e bazuar, jo thjesht në aspektin formal të përkufizimit, por kryesisht në atë substancial, pra të përmbajtjes, është kalimi nga përdorimi i termit gjuhë specialiteti në termin komunikim i specializuar, i cili mban parasysh raportet e ndryshme që ekzistojnë dhe zhvillohen mes lëndës – gjuhës – trupit – veprimit – dialogut – aktorëve, në ndërveprimet e tyre nga më të ndryshmet.

Dhe të flasësh për komunikim të specializuar, mund të jetë edhe një mënyrë për të zgjidhur problemin e diversiteteve mbi përkufizimet e ndryshme. Edhe qëllimi i këtij punimi është pikërisht mësimi i gjuhëve të specialitetit, në funksion të komunikimit të specializuar, duke konsideruar aspektet pragmatikë dhe kulturorë, në funksion të përvetësimit të kompetencës së komunikimit mes kulturave të ndryshme.

## I.2. Natyra e gjuhëve të specialitetit

Shtrojmë pyetjen: Cilët janë kriteret sasiorë dhe cilësorë që mund të etiketojnë një gjuhë si gjuhë specialiteti? Sa specializim disiplinor duhet të jetë i pranishëm (leksiku, sintaksa, aspekte të përmbajtjes etj) në një gjuhë, në mënyrë që të arrihet *niveli i pragut* të kompetencave shkencore dhe profesionale të lidhura me të.

Për të klasifikuar një gjuhë, si gjuhë specialiteti, në këtë punim kemi menduar të zgjedhim si kriteret:

1. Tekstin e specialitetit
2. Komunikimin e specialitetit

Le të fillojmë me analizën e kriterit të klasifikimit të gjuhëve të specialitetit, duke u nisur nga **teksti i specialitetit**.

Çfarë është një tekst i specialitetit?

Një përkufizim i thjeshtë mund të jetë: është një tekst (zakonisht i shkruar), me një gjuhë specifike, me veçori leksiko-morfo-sintaksore, i cili ndjek disa rregulla të dhëna nga disiplina e referencës, të kuptueshëm për specialistët e fushës. Lidhja me disiplinën referuese, në bazë të mendimit të specializuar dhe të shfaqjeve të tij konkrete, shprehet përmes tekstit.

Pra, teksti i specialitetit duhet t'i përgjigjet kriterit të mungesës së emocioneve, të transparencës, të saktësisë apo të karakterit shkencor. Ky pohim, lejon të diferencohen



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

gjuhët e specialitetit nga gjuha e letërsisë, pasi kjo e fundit, e ndryshme edhe nga gjuha e zakonshme, arrin qëllimin e saj estetik duke luajtur pikërisht me ambiguitetin, sinoniminë, metaforën, metoniminë, dhe jo mbi saktësinë e termit të specialitetit. Diferenca mes një teksti të zakonshëm dhe një teksti të specialitetit është pikërisht mungesa e lirisë dhe e krijimtarisë tekstuale të autorit, i cili duhet t'i qëndrojë rregullave të hekurta, nëse dëshiron që teksti i tij të arrijë qëllimin e komunikimit më të madh të mundshëm (brenda një rrethi të ngushtë).

Tekstet e specialitetit përputhen me strukturën konvencionale “*e cila gjendet në çdo lloj teksti dhe ndikon edhe në zhvillimin konceptual dhe retorik, e si rrjedhojë edhe në zgjedhjet gjuhësore*”<sup>13</sup>.

Teksti i specialitetit, nisët nga gjuha e zakonshme dhe merr forma të cilat ekzistojnë edhe në realizimin e një teksti të zakonshëm, por ai vjen duke u specializuar nga rregulla të cilat respektohen nga studiuesi i disiplinës. Veçoria e tij lidhet me shkallën e lartë të specializimit të përmbajtjes.

**Sager**<sup>14</sup> përcakton tre kritere për të konsideruar një tekst, si tekst i gjuhës së specialitetit:

- Përkatësia
- Ekonomia
- Saktësia

**Sobrero**<sup>15</sup> kufizohet vetëm në dy kritere: saktësia dhe neutraliteti emotiv.

**Serianni**<sup>16</sup> tregon si karakteristikë primare referueshmërinë, lidhjen objektive mes shenjës dhe shënjesit.

Këto kritere, janë të ndërvarura mes tyre me qëllim që komunikimi të arrijë qëllimin e vet dhe ekuilibri i tyre është i rëndësishëm për dobishmërinë maksimale të procesit komunikativ të specializuar.

Klasifikimi i gjuhëve të specialitetit sipas **kriterit të komunikimit të specializuar**.

Gjuhët e specialitetit klasifikohen si një varietet diafazik që i referohen situatës, kontekstit social dhe rolit të bashkëbiseduesëve në një kontest të caktuar e në raport mes tyre<sup>17</sup>. Dimensioni diafazik, i quajtur në fushën e komunikimit të specializuar si *dimension vertikal*, gërshetohet shpesh me *dimensionin horizontal*, i cili përfshin disiplinat e ndryshme dhe nëndisiplinat.

<sup>13</sup> Borello E. *L'incomunicabilità di massa: linguaggi settoriali: funzionamento e apprendimento*. Botimet Orso, Alessandria, 1994. Fq. 17.

<sup>14</sup> Sager J, Dungworth D, Mc Donald P. *English Special languages. Principles and Practice in Science and technology*, Brandstetter, Wiesbaden.1980. Fq.52.

<sup>15</sup> Sobrero A. *Introduzione all'italiano contemporaneo*, Laterza, Roma-Bari. 1993.Fq. 243

<sup>16</sup> Serianni L. *Italiani scritti*. Il Mulino, Bologna. 2003. Fq. 243

<sup>17</sup> Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 27

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Dimensioni vertikal përcakton nivelet e ndryshme komunikuese, nga ai më i specializuari në të cilin autorët e komunikimit janë ekskluzivisht specialistë, tek një nivel komunikues më i ulët, ku autorët mund të jenë ekspertë ose jo ekspertë.

Në çdo disipline, gjenden nivele të ndryshme komunikuese, të cilat dallohen mes tyre sipas objektit dhe qëllimit të komunikimit. Në lidhje me klasifikimin e gjuhëve të specialitetit, duke marrë si pikënisje nivelin dhe qëllimet e komunikimit, po sjellim në vijim mendime të studiuesëve të ndryshëm.

**Ischreyt**,<sup>18</sup> (1965), që në vitet Gjashtëdhjetë, përcaktonte tre nivele klasifikimi të gjuhëve të specialitetit: (Tab. I.2):

**Tabela I.2.**

### Tipologjitë e gjuhëve të specialitetit sipas komunikimit:

Lloji i gjuhës	Qëllimet e komunikimit	Niveli i specializimit
Gjuha e teorisë dhe e kërkimit shkencor	Komunikim mes ekspertëve, kryesisht në komunikimin me shkrim.	Shkallë e lartë specializimi
Gjuha e specialitetit profesional	Komunikim mes punonjësve të një sektori të dhënë, kryesisht në bashkëbisedim (komunikimin me gojë).	Nivel mesatar specializimi. Gjuhë e pasur me terma të përgjithshëm.
Gjuha teknike	Komunikim në fushën tekniko-industriale (aktivitete prodhuese, administratë, shpërndarje)	Nivel mesatar - i ulët specializimi. Lidhje e fortë me gjuhën e publicitetit.

Sikurse mund të kuptohet nga tabela, Ischreyt, gjuhët e specialitetit i klasifikon në bazë të qëllimeve të komunikimit, e më specifikisht sipas kriterit të afërsisë më të madhe apo më të vogël me fushën profesionale. Nga ana tjetër, shikojmë se ai i jep më shumë rëndësi aktorëve të komunikimit, dhe më pak gjuhës.

Ndryshe nga **Ischreyt**, në analizën e komunikimit të specializuar, **Cortellazzo**<sup>19</sup> i referohet niveleve sociolinguistike. Sipas tij *niveli i parë* është tejet i specializuar, me një distancë maksimale nga gjuha e zakonshme. *Niveli i dytë* realizohet mes teknikëve dhe

<sup>18</sup> Ischreyt, në Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 65

<sup>19</sup> Cortellazzo M.A. në *Le lingue speciali*. Fq.20 Tubingen, Niemayer, 1988.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

*niveli i tretë*, realizohet në kontaktin ekspert - jo ekspert dhe gjen zbatim përmes medias dhe didaktikës.

Edhe **Hoffman**<sup>20</sup> nisat nga qëllimet e komunikimit për të përcaktuar natyrën e gjuhëve të specialitetit, sikurse përmbledhur në tabelën e mëposhtme (Tab.I.3.)

**Tabela I.3.**

### **Tipologjitë e gjuhëve të specialitetit sipas komunikimit**

<b>Lloji i gjuhës</b>	<b>Qëllimet e komunikimit</b>	<b>Niveli i specializimit</b>
Gjuha e kërkimit bazë	Komunikim mes ekspertëve.	Niveli i lartë specializimi. Formalizim dhe simbole.
Gjuha e kërkimit eksperimental	Komunikim mes ekspertëve (teknikë).	Niveli i lartë specializimi. Formalizim dhe simbole.
Gjuha e kërkimit të aplikuar dhe e teknikës	Komunikim mes ekspertëve (teknikë) dhe punonjësve të një sektori të dhënë	Niveli mesatar specializimi. Gjuhë e zakonshme me struktura sintaksore të ngurta dhe prani të termave të specializuara.
Gjuha e prodhimit	Komunikim mes teknikëve të prodhimit dhe punëtorëve të kualifikuar	Niveli i ulët specializimi. Përdorim i gjuhës së zakonshme me praninë e ndonjë termi.
Gjuha e konsumit	Komunikim mes personelit të prodhimit, të konsumit dhe të konsumatorëve	Niveli i ulët specializimi. Përdorim i gjuhës së zakonshme me praninë e ndonjë termi teknik.

Duke analizuar tabelat e mësipërme, vërejmë se sipas qëllimeve dhe nivelit të komunikimit, përcaktohet natyra e gjuhëve të specialitetit. Realizimi i tyre në tekste specialiteti dhe në komunikimin e specializuar sjellin një lloj arsyesimi lidhur me raportin që ato kanë me gjuhën e zakonshme. Në çështjen në vijim, do të analizojmë më hollësisht këtë raport.

<sup>20</sup> Hoffman në Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 65

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## I.3. Raporti i ndërsjelltë mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialiteteve

Raporti mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit është një ndër temat mjaft të debatuar kryesisht në vitet Tetëdhjetë e Nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Pjesa më e madhe e metodologëve dhe gjuhëtarëve nuk mbështesin tezën e dallimit ndarës që ekziston mes gjuhës bazë dhe gjuhëve të specialitetit. Ky dallim, përcaktohet si pjesë e një konceptimi të ngushtë të gjuhës, që sheh njëtrajtshmërinë në një sistem abstrakt, ngushtësisht gjuhësor, pa marrë parasysh përdorimet dhe ndryshueshmërinë e situatave komunikuese, identitetin e bashkëbiseduesëve si dhe qëllimet e tyre në komunikim. Studimet e kryera nënvizojnë në mënyrë unanime faktin se raporti mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit është i ndërsjelltë. Diskutimi zhvillohet në lidhje më afërsinë më të madhe apo më të vogël me gjuhën e zakonshme dhe mbi varësinë e drejtëpërdrejtë të gjuhëve të specialitetit nga gjuha standarde. Kjo teori, gjen mbështetje në zbatimin didaktik, ku sikurse do ta trajtojmë në kreun e tretë të këtij punimi, mësimi i gjuhës së huaj të specialitetit duhet të paraprihet nga njohuri të përgjithshme të gjuhës bazë.

J. Binon dhe S. Verlainde raportin mes gjuhës standarde dhe gjuhës së specialitetit e lidhin me raportin që ekziston mes gjuhës dhe ligjërimit, leksikut dhe fjalorit. “*Sistemi gjuhësor, kodi është i njëjtë për të gjithë, por çdo folës përdor prerje të realitetit të ndryshme, në funksion të situatës dhe qëllimit të komunikimit që do të realizojë*”<sup>21</sup>. Duke marrë parasysh faktin se gjuhët e specialitetit kanë një funksion komunikimi, janë nënsisteme të gjuhës së përgjithshme, shtrojmë pyetjen se cilët mund të jenë treguesit e autonomisë së tyre gjuhësore.

*Bungarten*<sup>22</sup> dallon treguesit e llojit sociologjik e psikologjik, të lidhur me shkencën e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi del në plan të parë kur analizohen gjuhët e specialitetit, dhe kjo nënkupton edhe një raport të drejtëpërdrejtë mes teksteve/gjuhë specialiteti dhe teksteve/gjuhë e zakonshme, duke përforcuar tezën se nuk ekziston gjuha e specialitetit, pa gjuhën e zakonshme. Në këtë kuptim, gjuha është një polisistem, një kostelacion varietetesh (sektoriale, gjeografike, sociale), të cilat kanë një strukturë të përbashkët të gramatikës dhe/ose një leksik bazë.

Nga ana tjetër, kufinj të mes gjuhëve të specialitetit dhe gjuhës standarde nuk janë asnjëherë të qarta e mbi të gjitha të qëndrueshme. Ato spostohen mbi një bosht fleksibël që sipas kontekstit, periudhës historike dhe kulturës referuese qëndron pak a shumë në ekuilibër mes dy poleve.

Gjuha e zakonshme u ofron *lëndën e parë* gjuhëve të specialitetit, jo vetëm në nivelin fonologjik/ortografik dhe morfosintaksor, por kryesisht në atë leksikor, ku fjalëve të zakonshme u caktohen terma dhe shprehje karakteristike. Sasia e fjalëve që kalojnë nga

<sup>21</sup> J. Binon, S. Verlainde. *Les langues de spécialités: mythe ou réalité* në *Actes du XXII Congrès international de linguistique et philologie romane*. Bruxelles, 1988. Fq. 616-620,

<sup>22</sup> Bungarten T. ‘*Fachsprachenitheorie*’, fq 31, Atticon, Tostedt, 1993. fq 31

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

një *kontenitor* në tjetrin është çështje e frekuencës së përdorimit të një termi të caktuar. Mjetet e komunikimit janë përcaktuese për kalimin e termave dhe strukturave gjuhësore nga gjuha e specialitetit në gjuhën e zakonshme.

### **I.3.1. Rezultatet e punës kërkimore (Shtojca nr. 1)**

Për të vërtetuar hipotezën e parë, të parashtruar në Hyrjen e këtij punimi, lidhur me raportin e ndërsjelltë midis gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit, përveç analizës teorike, jemi mbështetur edhe tek rezultatet e një pune kërkimore, sjellë në trajtën e një fjalorthi (**Shtojca nr 1**, *bashkangjitur këtij punimi*). Ky aktivitet kërkimor është ushtruar mbi fjalorin në gjuhën italiane *Zingarelli*, ku janë sjellë fjalë të gjuhës së zakonshme, të transferuara në terma dhe të përdorura në gjuhë të ndryshme specialiteti dhe anasjelltas.

#### **Qëllimet e kërkimit:**

1. Të vërtetohet raporti i ndërsjelltë ndërmjet gjuhës së zakonshme dhe gjuhës së specialitetit.
2. Përdorimi i raportit fjalë-term dhe anasjelltas për qëllime didaktike, në funksion të kryerjes së veprimtarive në klasë<sup>23</sup>.
3. Kuptimi i termave shkencorë dhe përdorimi i tyre në kontekste të ndryshme.
4. Përdorimi i raportit fjalë-term në funksion të kompetencës së komunikimit të specializuar.
5. Sjellja e një fjalorthi specifik dhe praktik për gjuhët italiane të specialiteteve të ndryshme, i cili mund t'u vijë në ndihmë nxënësve, studentëve, mësuesëve, përkthyesëve dhe studiuesëve të fushave të ndryshme në gjuhën italiane

Duam të sqarojmë, se objekt i këtij hulumtimi, nuk janë të gjitha termat e gjuhëve të specialiteteve të ndryshme<sup>24</sup>, por:

1. Fjalët e gjuhës së zakonshme, të cilat kthehen në terma në gjuhë specialiteti.
2. Termat e gjuhëve të specialitetit, të cilat përdoren në gjuhën e zakonshme.
3. Terma që përdoren njëkohësisht në disa gjuhë specialiteti dhe jo në gjuhën e zakonshme.

Duke iu referuar analizës së pjesës së parë të kërkimit (pika 1), mund të themi se gjuha e zakonshme ofron përdorime të termave, jo vetëm në një gjuhë specialiteti, por njëkohësisht në disa gjuhë të specialitetit, ndonjëherë edhe jo të afërta, për të cilat shpesh vetëm konteksti lejon të merret kuptimi.

<sup>23</sup> Të shikohet Kreu i Gjashtë këtij punimi

<sup>24</sup> Të shikohet shtojca 3 e cila sjell glosarin e termave juridikë, ekonomike dhe mjekësorë

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Nga ky kërkim, rezulton gjithashtu se pjesa më e madhe e fjalëve të gjuhës së zakonshme përdoret në gjuhën juridike, në gjuhën mjekësore, ekonomike dhe, një numër më i vogël, në gjuhët e specialiteteve të tjera si: fizikë, matematikë, sport, biologji etj.

Në vijim, po sjellim disa shembuj, të shkëputur nga Fjalorthi, me shpjegimet përkatëse.

Folja '*appellare* (thërras), në gjuhën e zakonshme ka kuptimin 'thërras dikë sipas emrit'. Në gjuhën juridike përdoret për t'u ankimuar.

Mbiemri '*attivo*' (aktiv) ka si kuptimin parësor cilësinë e një personi i cili karakterizohet nga veprimi. Në **kontekstin gjuhësor**, ky mbiemër përdoret për të treguar një formë të foljes ku kryefjala kryen veprimin. Në **kontekstin ekonomik** përdoret në referim të bilancit pozitiv të një veprimi financiar.

Emri '*Consiglio*' (këshill), përdoret në gjuhën e zakonshme për t'i dhënë sugjerime dikujt, ndërsa në **gjuhën juridiko-ekonomike**, i referohet një organi apo një enti kolegjial me funksione të ndryshme.

Fjala '*Esercizio*' (ushtrim), përdoret në gjuhën e zakonshme për të përsëritur veprimet e për t'u stërvitur në një aktivitet, ndërsa në **gjuhën ekonomike** i referohet ushtrimit të aktivitetit të një kompanie.

Fjala '*espressione*' (shprehje), ka si kuptimin parësor aktin, apo efektin e të shprehurit; Në **kontekstin gjuhësor** shpreh një element të jashtëm të shenjës gjuhësore, ndërsa në **gjuhën matematikore** shpreh një seri termash, simbolesh dhe shenjash të një teorie.

Fjala '*indicatore*' (tregues), që tregon, zbulon diçka, përdoret në **gjuhën ekonomike** për të shprehur treguesin e ecurisë së një sektori të veçantë ekonomik, në **gjuhën kimike** për të treguar një substancë, e cila përmes ndryshimit të ngjyrës përcakton gjendjen acide apo alkaline të një tretësire.

Fjala '*influenza*' (ndikim), në gjuhën e zakonshme tregon një veprim të ushtruar nga dikush mbi vende apo persona, në **gjuhën e fizikës** shpreh aftësinë sipas së cilës disa trupa veprojnë në distancë mbi të tjerë. Në gjuhën **mjekësore**, për të treguar një sëmundje infektive dhe ngjitëse të rrugëve të frymëmarrjes.

Fjala '*intervallo*' (interval), e cila tregon një periudhë kohore mes dy fakteve apo veprimeve, e përdorur në **gjuhën e muzikës** tregon distancën mes tingujsh të së njëjtës gamë, ndërsa në **gjuhën e matematikës** tregon bashkësinë e numrave realë, më të mëdha se një numër dhe më të vegjël se një numër tjetër.

Fjala '*lesione*' (dëmtim,) shpreh aktin, efektin e një dëmi, në **gjuhën mjekësore** tregon çdo lloj ndryshimi anatomik apo funksional, shkaktuar nga një agjent mekanik, në **gjuhën juridike** përdoret në të drejtën penale në referim të dhunës fizike.

Fjala '*loggia*' (llozh), në gjuhën e zakonshme tregon një ndërtesë të hapur me kollona, ndërsa në **gjuhën mjekësore**, shpreh kavitetin në të cilin ndodhet një pjesë e një organi.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Fjala ‘*operatore*’ (*operator*), në gjuhën e zakonshme i referohet dikujt që vepron në përgjithësi, në **gjuhën mjekësore**, kirurgut, në **gjuhën ekonomike** dikush që ndërhyr në treg si shitës apo blerës, në **gjuhën e matematikës**, shpreh një funksion apo aplikacion.

(Për më shumë të shikohet materiali në shtojcën 1 të këtij punimi).

Nga shembujt e mësipërm nxjerrim konkluzionin se fjala transferohet lehtësisht në term në një fushë specialiteti.

Një transferim i tillë duket i mundshëm për dy arsye:

- a. **E para**, pasi përdorimi i thjeshtë në një kontekst të specializuar orienton termin e përgjithshëm drejt një kuptimi teknik, duke i dhënë specifika që e dallojnë nga pikëpamja semantike: fenomen ky i cili i korrespondon funksionit *konotativ* të gjuhës.
- b. **E dyta** pasi, për asocim me fjalët e tjera të thjeshta, shkohet në formimin e njësive leksikore komplekse, pra në krijimin e fjalëve të reja: fenomen i cili i korrespondon funksionit *denotativ* të gjuhës.

Në gjuhët e specialitetit pra, fjala ripërkufizohet, kthehet në term, eliminohen rastet e sinonimisë dhe shprehet një koncept i caktuar. Nga ana tjetër polivalenca e këtyre termave ndikon që ato të ruajnë të paprekur bërthamën e tyre semantike edhe kur zhvendosen në një kontekst tjetër specifik.

Në **pjesën e dytë të kërkimit (pika 2)**, grupohen termat e gjuhëve të ndryshme të specialitetit të përdorura si fjalë në gjuhën e zakonshme.

Nga këndvështrimi i analizës cilësore, do të shikojmë se pjesa më e madhe e termave të gjuhëve të ndryshme të specialitetit përdoren me kuptim metaforik në gjuhën e zakonshme. Kalimi i anasjelltë krijohet nga tendenca e përdorimit të një fjale ekzistuese për të përcaktuar diçka të re (psh përdorimi i fjalës ‘*navigare*’ për të treguar kalimin nga njëra faqe në tjetrën të rrjetit Internet, që në këtë rast është përkthimi i termit anglisht *to surf*). Një tendencë e tillë është më ekonomike kundrejt krijimit të një termi të ri.

Në vijim disa shembuj, me shpjegimet përkatëse:

Termi ‘*abortire*’ kuptimi i parë i të cilit përdoret në **fushën e mjekësisë**, në gjuhën e zakonshme përdoret me kuptim të figurshëm (*të dështojë një iniciativë para se ajo të nisë*).

Termi ‘*amalgama*’, kuptimi i parë i të cilit përdoret në **fushën e fizikës**, në gjuhën e zakonshme merr kuptim të figurshëm (*përzjerje idesh*).

Termi ‘*armonia*’, kuptimi i parë i të cilit përdoret në **gjuhën e muzikës** për të treguar një instrument muzikor, në gjuhën e zakonshme shpreh (*një marrëveshje idesh apo mjetesh*).

Termi ‘*arteria*’, kuptimi i parë i të cilit përdoret në **gjuhën mjekësore**, në gjuhën e zakonshme përdoret për të treguar (*një rrugë të rëndësishme të komunikimit rrugor*).

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Termi '*bilancio*' kuptimi i parë i të cilit përdoret në **gjuhën ekonomike**, për të pasqyruar të ardhurat e një shoqërie, në gjuhën e zakonshme përdoret për të treguar (*një vlerësim përmbledhës të një situatë*).

Termi '*embrione*', kuptimi i parë i të cilit përdoret në fushën e biologjisë, për të treguar një individ në stadin e parë të zhvillimit, në gjuhën e zakonshme përdoret për të treguar (*një ide e cila nis të marrë formë*).

Termi '*iniezione*' kuptimi i parë i të cilit përdoret në **gjuhën mjekësore**, për të treguar një teknikë terapeutike, përdoret në gjuhën e zakonshme për të shprehur (*çdo veprim ndihme materiale apo morale në një situatë kritike*).

(Për më shumë të shikohet materiali në shtojcën 1 të këtij punimi)

Në lidhje me këtë pjesë mund të nxjerrim dy vlerësime:

1. Termat e gjuhëve të specialitetit kur përdoren si fjalë në gjuhën e zakonshme marrin kuptim figurativ.
2. Një pjesë e konsiderueshme e termave të gjuhëve të specialitetit janë kthyer tashmë të një përdorimi të zakonshëm dhe kanë humbur çdo aspekt specializimi. Mund të themi pra se gjuhët e specialitetit ua kanë *dhuruar* ato gjuhës së zakonshme. Le të mendojmë për shembull për termin *objektiv* kundrejt *qëllim*, *fenomen* kundrejt *rast* të cilat përdoren natyrshëm dhe pa ngarkesën e termit në gjuhën e zakonshme.

**Në pjesën e tretë të këtij kërkimi** janë grupuar terma që përdoren vetëm në gjuhë të specialiteteve të ndryshme dhe jo në gjuhën e zakonshme. Nga rezultatet e nxjerra, rezulton se mes gjuhëve të specialiteteve ka një komunikim të vazhdueshëm leksikor. Njohja dhe përvetësimi i tyre gjen zbatim në një komunikim gjithnjë e më shumë të specializuar.

Në vijim disa shembuj<sup>25</sup>:

Termi '*Arbitraggio*' gjen përdorim në **gjuhën juridike, ekonomike**, por edhe në **gjuhë e sportit**.

Termi '*Bipolare*' përdoret në **gjuhën e fizikës, politikës dhe mjekësisë**.

Termi '*Equazione*' përdoret në **gjuhën e matematikës** dhe në gjuhën e **Astronomisë**.

Termi '*Eruzione*' gjen përdorim në **gjuhën mjekësore**, por edhe në **Gjeologji, Mjekësi**.

Termi '*Etico*' përdoret në gjuhën e **filozofisë dhe në gjuhësi**.

Termi '*Depressione*' përdoret në **gjuhën mjekësore**, në **gjuhën ekonomike**, por edhe në atë të **gjeologjisë**.

Termi '*Formula*' përdoret në **gjuhën juridike**, në **gjuhën e matematikës**, në **gjuhën e kimisë**.

<sup>25</sup> Shpjegimi i kuptimit të termave gjendet në Shtojcën nr.1



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Termi '*Quoziente*', i përdorur në gjuhën e Matematikës, gjen përdorim në gjuhën mjekësore, por edhe në gjuhën juridike.

(Për më shumë të shikohet materiali në shtojcën 1 të këtij punimi)

Nisur nga analiza sasiore, ushtruar mbi fjalorin 'Zingarelli', objekt i këtij kërkimi, konstatojmë se terminologjia mjekësore konsiderohet si më produktive, për shkak të përdorimit metaforik të termave, jo vetëm në gjuhën standarde, por edhe në gjuhë të tjera të specialitetit. Terma të tillë të gjuhës së mjekësisë si: *atrofia e një zyre publike, sistemi kapilar i kredisë, zemra e qytetit, paralizë e tregut, kolaps i ekonomisë, ndërhyrje traumatike etj.* janë të pranishme dukshëm në gjuhën politike apo socio-ekonomike.

Nisur nga analiza cilësore e këtij kërkimi konstatojmë se *shtegtimi* i fjalëve nga gjuha e zakonshme në gjuhët e specialitetit dhe anasjelltas është një fenomen, i cili karakterizon në mënyrë të qëndrueshme përdorimin gjuhësor. Në këtë *udhëtim*, diçka mund të humbasë dhe diçka qëndron: fjalët që kthehen në terma transportojnë kuptimin e tyre, i cili ruhet edhe në kontekstin e specializuar. Le të mendojmë se sa e vështirë do të ishte të kuptohej koncepti fizik i *forces*, pa iu referuar kuptimit në gjuhën e zakonshme.

Në përfundim të kësaj analize vërtetojmë qartësisht lidhjen e ngushtë midis gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit. Ky raport i ndërsjelltë kontribuon në evoluimin e gjuhës, në lëvizjen dialektike të një shkëmbimi të vazhdueshëm, në lindjen dhe shuarjen e fjalëve dhe kuptimeve. Nuk ka ndarje apo kufinj gjuhësorë mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhës së specialitetit. Raporti mes tyre është një *continuum* që shtrihet nga e para tek e dyta, me një gamë nivelesh të ndërmjetme. Pikënisje për zhvillimin e gjuhëve të specialitetit është gjuha e zakonshme ose gjuha mëmë, e cila u ofron të parave rregullat morfosintaksore, funksionet dhe procedurat e nevojshme për komunikim. Gjuha bazë dhe gjuhët e specialitetit kanë të përbashkët në mënyrë të padiskutueshme gramatikën. Specifikat gramatikore dhe veçoritë morfo - sintaksore i përkasin vetëm aspektit sasior, dhe jo atij cilësor.

Sjellja e kësaj analize mbi natyrën dhe marrëdhënien e ndërsjelltë midis gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit është e rëndësishme në radhë të parë për mësuesit të cilët mund t'i referohen kësaj analize për zbatimin konkret të veprimtarive didaktike në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## KREU II

### VEÇORITË E GJUHËVE TË SPECIALITETIT. ANALIZË E GJUHËS ITALIANE JURIDIKE, EKONOMIKE DHE MJEKËSORE

#### II.1. Veçori të përgjithshme të GJHS-it

Gjuhët e specialitetit karakterizohen nga specifika gjuhësore (leksikorë, morfo-sintaksorë, tekstuale) dhe jashtëgjuhësore, të tilla që i bëjnë ato qartësisht të dallueshme nga gjuha e zakonshme, edhe pse janë pjesë përbërëse e saj. Fillimisht, në këtë kapitull, do të analizojmë veçoritë e përgjithshme të Gjuhëve të Specialitetit në nivelin teorik, dhe në vazhdim do të ndalemi specifikisht në veçoritë e gjuhës italiane juridike, ekonomike dhe mjekësore, duke i parë ato në rrafshin krahasues.

#### Veçori leksikore

Midis veçorive të ndryshme që gjuha zotëron është përshtatja e saj për nevojat komunikimi. ~~Qëllimi i komunikimit, i pasht~~ niset nga qëllime dhe nevoja të caktuara dhe shpreh funksione specifike. Gjuha, nën ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësore i ruan të paprekura karakteristikat e saj strukturore dhe gramatikore, por vë në përdorim një pasuri leksikore të përshtatshme për qëllime të një komunikimi të caktuar. Jo thjesht folësit kalojnë nga regjistrat informalë në regjistra gjithnjë e më të kontrolluar dhe formalë, por, sipas argumentit në fushën e eksperiencës në të cilën realizohet komunikimi, ndodh që përdoret një leksik specialiteti i tillë, me konfiguracionin e një nomenklature të veçantë.

Në kërkimet dhe studimet mbi gjuhët e specialitetit, pikënisje e analizës së tyre është dimensionin leksikor dhe terminologjik. Elementi leksikor është konsideruar për një kohë të gjatë si karakteristika kryesore e gjuhëve të specialitetit, komponenti më i drejtpërdrejtë, i lidhur me disiplinën dhe me aspektet e saj teknike.

Leksiku i specializuar quhet terminologji, e mbizotëruar nga teknikizma ku fjala kthehet në term, dhe si i tillë vetëm një kuptim.

Dallojmë dy lloje teknikizmash:

- a) **Teknicizma specifikë.** Gjuhët e specialitetit karakterizohen nga *monosemia*, pra çdo term mbart në vetvete një kuptim të vetëm, ndryshe nga polivalenca e gjuhës bazë, ku termat janë polisemantikë dhe mund të kenë konotacione të ndryshme në varësi të kontekstit dhe përdorimit. Duke qënë të tilla, këto teknikizma specifikë

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

nuk kanë asnjë sinonim në gjuhën e zakonshme, (*organet anatomike apo emërtimet e patologjive*).

- b) **Teknicizma kolateralë.** Fjalët janë nxjerrë nga gjuha e zakonshme dhe ndryshe nga tecnicizmat specifike, kanë sinonimet e tyre përkatëse. Tecnicizmat kolateralë janë shprehje e ndarjes së gjuhës së specialitetit nga gjuha e zakonshme; nga ana tjetër, vihet re edhe mungesa e specificitetit: shprehja parafoljore “*në ngarkim të*” përdoret si në gjuhën e mjekësisë (*një infeksion në ngarkim të stomakut*), ashtu edhe në gjuhën e jurisprudencës, (*një krim në ngarkim të të pandehurit*). Përdorimi i tecnicizmave kolateralë është edhe një faktor prestigji: mjeku apo juristi përmes këtij instrumenti shkëputet nga personi i cili kërkon asistencë, duke shënuar një nivel të ndryshëm kompetence dhe një eksperiencë më të madhe e profesionale mbi fushën, kundrejt folësit të zakonshëm, gjë që nuk jepet nga tecnicizmat specifike. Edhe këto të fundit, nxjerrin në pah njohurinë e plotë të kuptimit të tyre nga ana e folësit, vetëm nëse përdoren pranë tecnicizmave kolateralë. Tecnicizmat specifike kanë thjesht funksion tregues në caktimin e një reference, kurse ato kolateralë kanë më shumë funksionin konotativ.

Pra termi përdoret edhe si mjet njohjeje mes anëtarëve të një komuniteti shkencor. Për shembull, duke iu referuar gjuhës italiane shprehja *all'uopo* në vend të shprehjes *a tal fine*, ose *il paziente accusa dolore* në raport me *il paziente riferisce di aver dolore, di sentirsi male*.

Ndërsa tecnicizmat specifike (ose primare) mund të përdoren edhe nga jo ekspertë, në komunikimin e përditshëm (*takikardi, udiencë, etj*), tecnicizmat kolateralë janë të një përdorimi më të vështirë e më të kufizuar. (*Pacienti (Infermieres): Sono qui per togliere le tonsille. Infermierja (mjekut): Dottore, c'e' un paziente per una tonsillectomia.*

### 1. Vecoritë e termit:

#### a. Monoreferueshmëria

Monoreferueshmëria (një kuptim i vetëm për çdo term) është një ndër veçoritë të cilat diferencojnë gjuhët e specialitetit nga gjuha e zakonshme. Termi përdoret për t'iu referuar vetëm një objekti, koncepti apo procesi. Jo se ekziston një referent i vetëm për termin, por, në një kontekst të dhënë, një termi të caktuar mund t'i caktohet vetëm një kuptim.

Për shembull:

fjala ‘*romantico*’ në gjuhën e zakonshme ka si sinonim fjalën ‘*sentimentale*’ (sentimental), ndërsa termi ‘*romantico*’ (romantik) në gjuhën e kritikës letrare i referohet shkrimtarëve të fundit të shekullit të Shtatëmbëdhjetë dhe mesit të parë të shekullit Tetëqind;

fjala ‘*divisa*’ në gjuhën ushake, ka si sinonim fjalën ‘*uniforme*’, (uniformë), ndërsa në fushën bankare ka si sinonim fjalën ‘*monetta*’ (monedhë);

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

fjala ‘*agente*’ në gjuhën e kimisë kthehet në term ‘*Sostanza che provoca una reazione*’ (Lëndë e cila shkakton një reaksion).

### b. Mungesë emocionesh

Ndryshe nga teksti letrar apo nga gjuha e zakonshme ku fjala merr ngarkesë emocionale, në gjuhët e specialitetit termi është i zhveshur nga emocionet dhe nga subjektiviteti.

### c. Saktësia dhe qëndrueshmëria

Ambiguiteti i një fjale kundrejt termit është më i madh. Termi, pasi pranohet si i tillë nga komuniteti shkencor apo profesional qëndron, dhe ndryshimi i tij është i vështirë. Në lidhje me saktësinë mund të themi se ka disa nivele të saktësisë së një termi, duke u nisur nga një hiperonim (psh: *reato/omicidio/omicidio premeditato*).

Përsa i përket qëndrueshmërisë, gjuhët e specialitetit kanë një sistem të qëndrueshëm për formimin e koncepteve, të cilat lejojnë njohjen dhe krijimin e pakufizuar të termave të mëtejshëm (psh. termat që mbarojnë me prapashtesën *-ato-* në fushën e kimisë i referohen kriprave). Shpesh qëndrueshmëria e një termi kërcënohet nga ndërkombëtarizimi progresiv i kërkimit shkencor.

### d. Transparenca dhe sintetizimi

Diferenca mes një termi dhe një fjale qëndron në faktin se termi është i pranuar dhe i përdorur nga një grup specialistësh më i ngushtë kundrejt komunitetit të folësve.

Ndërsa sintetizimi, lehtëson fluksin e mendimit përmes shkrirjes së dy termave (psh: *banca dati, estratto-conto, analisi-programmatore* në fushën e informatikës, si dhe përdorimi i akronimeve apo shkurtimeve.

### e. Prania e njësive leksikore të larta

Gjuhët e specialitetit karakterizohen nga shprehje, të formuara nga fjalë ose grupe fjalësh të cilat marrin një kuptim specifik, vetëm nëse merren së bashku. Këto quhen **njësi leksikore të larta**. Të tilla gjenden edhe në gjuhën e zakonshme. Për shembull, *Tavola rotonda (tryezë pune)* është një njësi leksikore e lartë, pasi vetëm bashkësia e këtyre fjalëve tregon një debat ku ndërhyjnë disa persona. Por, në gjuhët e specialitetit ato kanë një frekuencë përdorimi më të lartë. Kuptimi i një njësie leksikore të lartë nuk mund të ndërtohet duke mbledhur kuptimet e fjalëve të veçanta që e përbëjnë atë. Një njësi leksikore e lartë dallohet nga një bashkësi e lirë fjalësh, pasi nuk është e mundur të ndryshohet rendi i fjalëve apo të ndërpritet sekuenca, duke futur një element tjetër si mbiemër. Nëse do të na duhet të shtojmë një element të ri duhet ta vendosim atë para ose pas njësive leksikore të lartë. Për shembull: mund të shprehemi: ‘*un’importante tavola rotonda*’, por jo ‘*una tavola importante rotonda*’. Shembuj të njësive leksikore të larta në gjuhë specialiteti: *battito cardiaco, societa’ azionaria, tessuto osseo, sistema autore, peso atomico, pressione atmosferica* etj.


# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## 2. Krijimi i termave të rinj

Për çdo objekt të ri, proces, koncept shkencor, teknologjik e profesional nevojitet një term që ta përcaktojë. Termat e rinj priren të jenë transparentë, pra të kuptueshëm edhe për dikë që nuk e ka hasur atë më parë e që mund ta interpretojë përmes një procesi *semasiologjik*<sup>26</sup>. Pra lexuesi nisët nga forma e fjalës për të ndërtuar kuptimin e saj. Në të vërtetë, leximi në gjuhët e specialitetit bazohet veçanërisht mbi procesin e anasjelltë, i quajtur *onomasiologji*,<sup>27</sup> ku kuptimi i termit del në bazë të pozicionit që ai ka në fjali.

Më poshtë po sjellim mënyrat e krijimit të termave të rinj në gjuhët e specialitetit:

### a. Fjalë nga gjuha e zakonshme



Shembuj: *base, carica, composto, forza, resistenza, attrito, azione, insieme, funzione, piano, peso, massa, stato, asse, cerchio, etj.*<sup>28</sup>

### b. Neologjizmat (shpesh fjalë të përbëra): Neologjizmi është fenomeni më interesant, më i gjallë i leksikut të gjuhëve të specialitetit

Shembuj:

*biodegradabile, elettrocardiogramma, pluridisciplinarita', interplanetario, isomero etj.*

### c. Huazimet (të përshtatura ose jo) nga gjuhët e huaja, apo sigla:

Shembuj:

*cracker, bit, byte, feed-back, laser (nga Light Amplification by Stimulated Emission of Radiation), radar ( nga radio Detection and ranging).*

Si krijohet një term i ri?

Për të krijuar terma të rinj përdoren shpesh parashtesat e prapashtesat me origjinë greko-latine, të cilat janë pjesë e bagazhit të përbashkët të të gjithë specialistëve, pavarësisht sferës së studimit të tyre.

Një ndër rezultatet e procesit të neologjizmit është ndërkombëtarizimi progresiv i gjuhëve shkencore e profesionale, terminologjia e të cilave rezulton e qartë për çdo specialist, pavarësisht nga gjuha në të cilin termi është përdorur.

Në përfundim mund të themi se terminologjia specifike është një element i rëndësishëm dhe tipizues i gjuhëve të specialitetit, përmes së cilës transferohen njohurinë disiplinore brenda një sektori të caktuar.

<sup>26</sup> Balboni. *Le Microlingue Scientifico –professionali. Natura e insegnamento.* Fq. 49.

<sup>27</sup> Shpjegime më të detajuara për termat *semasiologji* dhe *onomasiologji* jepen në kreun e tretë të këtij punimi, ku trajtohen aftësitë e leximit

<sup>28</sup> Shembuj të tjerë me shpjegimet përkatëse sillen në komentet mbi Shtojcën nr. 1 të këtij punimi (fq. 18-19)

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## II.1.2. Veçori morfologjiko-sintaksore

Folëm për karakteristikat në nivelin leksikor të gjuhëve të specialitetit, por leksiku nuk është sfera e vetme ku duhet të drejtohem për të nxjerrë në pah veçoritë e këtyre gjuhëve. Ka ndryshime mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit edhe në nivelin morfologjiko - sintaksor. Por, këto ndryshime lidhur me përdorimin e strukturave të gjuhës së zakonshme konsistojnë kryesisht në aspektin sasior. Pavarësisht veçorive, gjuhët e specialitetit nuk kanë një morfologji apo sintaksë të ndryshme nga ajo e gjuhës së zakonshme, por aty gjejnë përdorim më të gjërë e më të shpeshtë disa struktura specifike, dhe më pak disa të tjera. Le t'i referohemi më hollësisht veçorive morfo-sintaksore të gjuhëve të specialitetit:

### - Përparësia e emrit kundrejt foljes

Tendenca e përgjithshme në gjuhët e specialitetit është shfuqizimi apo reduktimi progresiv i rolit të foljes, e cila merr më pak ngarkesë kuptimore në raport me emrin.

Emërzimi përfaqëson një alternativë ekonomike e cila lejon të nxjerrë në pah veprimin e kryer nga folja.

### *Shembuj:*

#### **Gjuha e zakonshme:**

*-Lo spinoto va **collegato** con la relativa spina per far passare la corrente.*

#### **Gjuha e specialitetit:**

*-Il **collegamento** dello spinoto con la relativa spina fa passare la corrente.*

### - Përdorimi foljor

#### **a. Koha e foljes.**

Teksti i specialitetit organizohet nëpërmjet mekanizmave të cilat imponojnë një zgjedhje të saktë të kohëve dhe mënyrave foljore. Për të shprehur një përkufizim, i cili është universal, atemporal, jo i lidhur me situata të veçanta, as me personalitetin e formuluesit përdoret mënyra dëftore, koha e tashme, e cila shpreh edhe objektivitetin real të fjalisë.

### *Shembuj:*

*-Si chiamano perpendicolarì due reti che si intersecano formando quattro angoli retti.*

*-Un corpo emerso nell'acqua riceve una spinta.*

#### **b. Forma pësore e foljes**

Në gjuhët e specialitetit dhe përgjithësisht, në gjuhën e shkruar vërehet një mbizotërim i formës pësore kundrejt formës veprare, me qëllim nxjerrjen në pah të kryefjalës kundrejt kundrinorit.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

### c. Format pavetore

Karakterit objektiv i një teksti në gjuhë specialiteti, i shprehur përmes përdorimit të formave pavetore apo të vetës së tretë njëjës, është veçoria më e dukshme e gjuhëve shkencore – profesionale.

Përdoren gjerësisht fojet tipike si (*dimostrare, evidenziare, confermare, come dimostra l'elenco....*), etj.

### d. Format foljore të pashtjelluara,

Nga studimet mbi aspektet foljore në tekstet e specialitetit rezulton një përdorim më i lartë i formave foljore të pashtjelluara (paskajore, përcjellore e pjesore), kundrejt përdorimit të tyre në gjuhën e zakonshme (35% kundrejt 17%).<sup>29</sup> Përdoren kryesisht në gjuhën juridike dhe në gjuhën ekonomike dhe më pak në gjuhën mjekësore. Në dukje e thjeshtësojnë fjalinë, por realisht e bëjnë atë më pak të kuptueshme, për jo ekspertët

(*un elenco stilato, a dimostrarlo, affittasi casa, pregasi confermare disponibilità).*

### -Mungesa e elementëve frazorë.

Nevoja për një sintetizim maksimal nga njëra anë dhe dendësi informacioni nga ana tjetër sjell edhe shmangien e elementëve frazorë, nyje, parafjalë, të cilat vlerësohen të një rëndësie dytësore dhe kuptimi i tyre nënkuptohet nga konteksti (*pregasi effettuare pagamento, pressione e battito cardiale regolati*).

Elementët e mësipërm morfo-sintaksorë, kontribuojnë për të krijuar edhe veçori të tjera: përdorimi i shpeshtë i formës pjesore të foljes e kthen tonin e bisedës në neutral, jo personal, me mungesë emocionesh, mbizotëron qëllimi informativ mbi komponentin emotiv ose estetik, mbizotëron sinteza dhe efikasiteti si dhe objektiviteti shkencor. Jo se këto teknikizma morfo-sintaksorë nuk gjejnë përdorim në gjuhën e zakonshme, por intensiteti i përdorimit të tyre është më i lartë në gjuhët e specialitetit.

### II.1.3. Veçori tekstuale

Tekstet e specialitetit klasifikohen në tipologji tekstesh të ndryshme dhe me karakteristika qartësisht të përcaktuara. Përmendim këtu tekstet deskriptive të cilat sjellin raportet me hapësirën, tekstet narrative që ndjekin një linjë kohore, tekstet argumentative, lidhur me raportet mes koncepteve, tekste estetikë, fokusuar mbi formën e mesazhit e mund të vazhdojmë me radhë me tipologji të ndryshme.

---

<sup>29</sup> Rumszeëics cituar nga Barber CL. *Some measurable characteristics of modern scientific Prose. Gothenburg Studies in English*. Säales, 1985 fq 3-14.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Balboni, në analizën e tij sjell si një nëndarje të parë të teksteve të specialitetit, **tekstet epistemologjike** qëllimi i të cilave është dija, dhe **tekstet komunikuese**, qëllimi i të cilave është veprimi.

### • Tekste epistemologjike

Në gjuhët e specialitetit të fushës epistemologjike, sikurse gjuha e së drejtës, e filozofisë, e artit, e mjekësisë, teskti është i llojit argumentativo-shkencor. Ai kushtëzohet nga një përshkrim specifik. Përmendim këtu manualët shkollorë, tekstet e fizikës apo të historisë, revistat e specializuara dhe esetë specifike, të cilat kanë si qëllim dijen. *'Tekstet e natyrës epistemologjike karakterizohen si nga rregulla retorike, ashtu edhe nga rregulla logjiko-semanticë. Rregullat retorike lejojnë përcaktimin e llojeve të komunikimit. Rregullat logjiko-semanticë janë konceptuale dhe e organizojnë tekstin në paragrafë konceptuale'*.<sup>30</sup>

Disa shembuj të teksteve epistemologjike janë:

- a. *Vëllimet enciklopedike.*
- b. *Artikuj shkencorë:* nuk kanë përhapje në masë, por i drejtohen një publiku të interesuar. Karakterizohen nga një leksik i mirëfilltë shkencor.
- c. *Eseja:* Paraqet një strukturë hierarkike informacionesh, e cila sillet edhe grafikisht përmes përdorimit të paragrafeve dhe nënparagrafeve.
- d. *Raporti.* Studiuesi pasi prezanton një argument (*temën*) shkruan në vazhdim komentin mbi të (*remën*). Në koment specialisti sjell kontributin e tij personal dhe zgjeron konceptin e shprehur në argument.
- e. *Abstrakti dhe recension.* Karakterizohen nga sinteza dhe nga dendësia e informacioneve, nga struktura të bashkërenditura dhe të nënrenditura.

### • Tekste komunikuese

Këto tekste kanë si qëllim veprimin dhe mbizotëron aspekti i marrëdhënies ndërpersonale, më shumë se aspekti epistemologjik. Ato përqëndrohen tek modalitetet e vendosjes së kontakteve dhe raporteve njerëzore. Për shembull, për të realizuar një eksperiment në fizikë duhet të përgatitet kërkesa për prenotimin e sallës së laboratorit, kërkesa për materiale dhe pajisje, letra për thirrjen e pjesëmarrësve, dhënia e udhëzimeve etj.. Shembuj të teksteve komunikuese:

- a) *Letra tregtare.* Standartizimi teksual është i pranishëm në të gjitha fushat e disiplinave (*data, adresa, numri i protokollit, formulat e hapjes e të mbylljes*). Por, mund të shprehen edhe variante të ndryshme kulturore (pozicioni i ndryshëm i datës apo i dërguesit).
- b) *Fax-i.* Bëhet fjalë për module të gatshme të kompiuterit, i cili plotësohet me të dhëna specifike.
- c) *Kontratat:* tregojnë kushtet dhe detyrimet normative të kontraktuesëve. Kemi një gërshetim të gjuhës tregtare dhe juridike.

<sup>30</sup> Balboni E.P. *Le microlingue scientifico-professionali. Natura e insegnamento.* Fq. 34-36.



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- a. *Depliantet publicitarë*: Ndeshet shpesh prania e ikonave dhe imazheve që kanë si qëllim të zëvendësojnë tekstin apo t'i referohen atij.

Në vijim, po sjellim një listë me karakteristikat e teksteve të specialitetit sipas mendimeve të studiuesëve të ndryshëm:

**Hoffman**<sup>31</sup> sjell kriteret e mëposhtme që dallojnë gjuhët e specialitetit.

- Saktësia, thjeshtësia, qartësia;
- Objektiviteti;
- Abstraksioni;
- Përgjithësimet;
- Densiteti i informacionit;
- Shkurtime;
- Neutraliteti emotiv;
- Mungesa e ambiguitetit;
- Koherenca logjike;
- Përdorimi i termave/simboleve.

Pas analizës së një korpusi tekstesh në gjuhë të ndryshme specialiteti, po sjellim veçoritë tesktuale që i karakterizojnë këto gjuhë.

- **Prania e përkufizimeve**: objektet dhe konceptet e lidhura me argumentin e paraqitur përkufizohen saktësisht. Përkufizimi ëshë i saktë dhe nuk lejon ndërhyrje personale.
- **Koherenca dhe kohezioni** si dy elementë bazë të tekstit të shkruar. Një tekst ka një koherencë (lidhje e thelluar) të vetën logjiko-semantike (i ashtuquajtur fill i bisedës) dhe mbahet mbi mekanizma formalë të kohezionit (lidhja sipërfaqësore) që lidhin fjalitë (përemra, lidhorë etj).
- **Regjistri formal (zyrtar)**.
- **Funksioni referencial** (kujt i referohet, ajo që duhet të komunikohet).
- **Organizimi rigoroz i tekstit**: teksti i specialitetit paraqitet si një sekuencë informacionesh/udhëzimesh. Është i strukturuar përmes rregullave logjiko-semantike, me ndarje në paragrafë, të cilët kanë një kohezion të dukshëm dhe janë mbajtës së koncepteve. Fjalitë e pare e çdo paragrafi shpreh idenë kryesore. Struktura e tekstit bazohet mbi skemën thelbësore me katër pjesë Hyrja - Problemi – Zgjidhja – Përfundimi.
- **Raporti shkak-pasojë**. Rregullat retorike janë mjaft të theksuara, pasi janë tipike të komunitetit shkencor referues. Është i dukshëm funksioni organizativ i lidhorëve tekstualë të raportit shkak-pasojë; përdorimi i lidhorëve dhe i anaforave të tipit psh: “*shih më lart*”.
- **Prania e shembujve**: të pranishëm në masë më të madhe në tekstet e shkencave natyrore, dhe më pak në ato sociale. Prania më e vogël e shembujve në këto të fundit lidhet më mundësinë më të madhe për të interpretuar dhe përgjithësuar.
- **Prania e termave në gjuhë të huaja**.

<sup>31</sup> Cavagnoli S. *La Comunicazione Specialistica*. Carocci, 2007, fq.47.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- **Prania e kodeve jo gjuhësore**, simbole, figura dhe ndërveprimi mes imazhit dhe tekstit.


a) **Bibliografia** apo një listë referimesh bibliografike për veprat e cituara në tekst.

Në përfundim mund të themi se gjuhët e specialitetit janë një pasqyrim i drejtëpërdrejtë i raportit mes formës dhe përmbajtjes. Veçoritë leksikore e morfo-sintaksore justifikojnë veçoritë tekstuale sa më lart shpjeguar.

### II.1.4. Veçori jashtëgjuhësorë.

Gjuhët e specialitetit dallohen edhe nga prania e kodeve, jo gjuhësore, të tilla si: *numrat, formulat, simbolet kimike, grafikët, diagramet, (flowcharts) figurat, tabelat, siglat, apo akronimet*. Këto elementë paratekstualë, universalë, janë të pavaruar nga çfarëdolloj gjuhë e veçantë dhe ofrojnë një mënyrë të ndryshme nga ajo gjuhësore, për të përfaqësuar konceptet e specializuara. Nga ana tjetër, elementët jashtëgjuhësorë ndihmojnë në zgjerimin e transparencës së tekstit për ekspertët e sektorit.

Widdowson H.G., duke u nisur nga prania e vazhdueshme e elementëve jo gjuhësorë në tekste specialiteti ka arritur në përfundimin se ato përbëjnë “*strukturën e thellë, tërësinë e të dhënave universale që qëndrojnë në bazë të një teksti specialiteti.*”<sup>32</sup> Përmes procesit të tekstualizimit, kjo strukturë e thellë e komunikimit të specializuar kodifikohet në gjuhë të ndryshme sipas skemës së mëposhme:




Siç e shikojmë, Widdowson përfshin elementë të ndryshëm jo gjuhësorë (*formula, diagrame, tabela*) në strukturën e thellë të gjuhës, duke u nisur nga mendimi se këto elementë janë ‘universalë’ dhe të pavarur nga çdo gjuhë e veçantë.

Një skemë alternative do të ishte dhe kjo që po paraqesim në vijim, në të cilën elementët jo gjuhësorë (*formula, diagrame, tabela* ej), nuk përfshihen në strukturën e

<sup>32</sup> Widdowson në Gotti M. *Linguaggi specialistici: Caratteristiche linguistiche e criteri pragmatici*. Nuova Italia, Scandicci, Firenze, 1991. Fq. 12.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

thellë të gjuhës (e cila është e natyrës thelbësisht konceptuale), por ofrojnë një mënyrë të ndryshme nga ajo gjuhësore për të përfaqësuar vetë konceptet shkencore. Skema e mësipërme mund të riformulohet si më poshtë:



Në fakt, grafikët, tradicionalisht të lidhur me gjuhën shkencore, përdoren sot gjerësisht edhe në shkencat humane si: gjuhësia, historia, pedagogjia etj. Përdorimi gjithnjë e më i madh i 'ikonave', falë teknikave moderne, të cila importojnë në kompiuter imazhe të skanizuara apo të shkarkuara nga interneti, na lejon të përdorim një komunikim jashtëgjuhësor (konferencat, leksionet të shoqëruara me projektme në Power Point), i cili qëndron krahas komunikimit gjuhësor, duke e ndihmuar madje këtë të fundit. Kjo sjell aktivizimin e përputhjes mes gjuhës dhe imazhit. Nuk është e mundur të kuptosh një tekst gjuhësor, pa iu referuar grafikut i cili nga ana e vet kërkon gjuhën për ta shpjeguar.

### II.2. Analizë e gjuhës italiane juridike, ekonomike dhe mjekësore.

Në këtë çështje do të sjellim, në bazë të analizës së një korpusi tekstesh, si dhe glosarit, bashkangjitur këtij punimi (*shtojca nr.3*) specifikat e tre prej gjuhëve të specialitetit: gjuhës italiane juridike, gjuhës italiane ekonomike dhe gjuhës italiane mjekësore, të cilat janë pjesë e programeve universitare shqiptare, si në kontekstin publik ashtu dhe në atë privat. Qëllimi i kësaj analize është njohja e veçorive dhe specifikave të këtyre gjuhëve, jo vetëm për t'i përdorur ato gjatë procesit të mësimdhënies/mësimnxënies, (përgatitjes së njësive didaktike), por edhe në funksion të forcimit të kompetencës së komunikimit në këto gjuhë. Nga ana tjetër, do të shikojmë se si ndërveprojnë këto tre gjuhë me njëra tjetrën, veçanërisht në rrafshin leksikor, por edhe raportin e tyre me gjuhën e zakonshme.

#### II.2.1. Analizë e gjuhës italiane juridike

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Në çështjen e parë të këtij kreu, sollëm një panoramë të përgjithshme të veçorive leksiko-morfo-sintaksore, tekstuale dhe jashtëgjuhësore të gjuhëve të specialitetit. Por, realiteti i gjuhëve të specialitetit nuk është aspak homogjen, siç mund të duket në pamje të parë. Sikurse gjuha e zakonshme nuk është një realitet monolitik, por është e pajisur me varietete të shumëfishta, ashtu edhe në fushën e gjuhëve të specialitetit, krahas rregullave dhe karakteristikave të llojit të përgjithshëm, ka edhe veçori tipike përdorimi që i diferencojnë gjuhët e specialitetit. Kështu, ndryshe nga gjuhët tekniko-shkencore lidhur me disiplina të tilla si matematika, fizika apo kimia të cilat dallohen për faktin se janë gjuhë denotative, gjuha juridike, edhe pse paraqet një sërë tecnicizmash, rezulton të jetë një gjuhë konotative, ku është mjaft tipike dhe i shpeshtë përdorimi i perifrazimeve për të përkufizuar një koncept. Por, duhet të themi se për vetë natyrën komplekse të teksteve juridike, raporti mes gjuhës juridike dhe gjuhës së zakonshme është disi problematik. I tillë është edhe përkufizimi mbi vetë gjuhën juridike. Janë të shumtë studiuesit, juristë dhe gjuhëtarë, por përkufizimet e gjetura nënvizojnë mungesën e një kufiri të prerë dhe të qartë me gjuhën e zakonshme. Në fakt, flitet për gjuhën juridike, gjuhën e së drejtës, gjuhën ligjore, shpesh duke i konsideruar termat si sinonime, shpesh edhe duke i diferencuar në nivelin semantik.

Nga ana tjetër, brenda gjuhës të së drejtës dallojmë gjuhën e së drejtës private, të së drejtës publike, të së drejtës penale, të cilat ndryshojnë jo aq në aspektin gramatikor, por kryesisht në atë leksikor.

Gjuha juridike është një gjuhë dinamike me natyrë dialogjike.<sup>33</sup> Në kontekstin juridik, ndryshe nga gjuha e zakonshme, ku ka dallimes mes gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur, diferencat mes komunikimit me gojë dhe atij me shkrim, janë të pakta. Edhe në komunikimin me gojë ndihet prania e elementëve formalë, të kodifikuar, të karakterizuar nga forma e formula standarde, të tilla sikurse janë pretencat e gjykatave, formulat e betimit, e të ngjashme me to.

Sikurse do të shikojmë, fusha disiplinore nuk përcakton vetëm konotacionin e veçantë që leksiku merr, por edhe zgjedhje të karakterit morfo-sintaksor, tekstual e pragmatik, të cilat përshtaten me veçoritë epistemologjike, semantike dhe funksionale të komunikimit në fushën e së drejtës.

Duke iu referuar një korpusi tekstesh juridikë në gjuhën italiane<sup>34</sup>, kemi nxjerrë në pah veçoritë leksiko-morfo-sintaksore të kësaj gjuhe, me qëllim njohjen dhe përdorimin e tyre gjatë mësimdhënies/mësimnxënies.

### **Aspekte leksikore**

---

<sup>33</sup> Mannoni G. *Lingua, identitta' e diritto nella E'omen's Jurisprudence in USA*, në 'Quaderni del Dipartimento di linnguistica, 4', 1993. Fq.179-192.  
1993

<sup>34</sup> Korpusi i teksteve është sjellë në pjesën e Hyrjes të këtij punimi.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Gjuha juridike tenton të jetë *gjuha e pushtetit*, e cila përmes strukturave semantike i shmanget çdo kuptimi fjale në vetvete. Mjafton të kujtojmë tekstin e njohur të Italo Calvino-s ‘*Antilingua*’, ku autori flet për ‘*terrorin*’ semantik të gjuhës juridike.

Njohja e aspekteve leksikore është e rëndësishme për një përdorim të saktë dhe me kompetencë të gjuhës. Po sjellim në vijim specifikat leksikore të gjuhës juridike:

❖ Prania e teknikizmave specifikë.

Konceptet që në gjuhën e zakonshme përdoren si sinonime, dhe zëvendësojnë lirshëm njëri-tjetrin, në gjuhën juridike mbartin përkufizime të ndryshme. Kështu, nëse në gjuhën e zakonshme fjala ‘*multa*’ (*gjobë*) përdoret në kuptim të përgjithshëm, për të gjitha rastet e vendosjes së gjobës, në gjuhën italiane juridike, përdoren edhe termat ‘*contravvenzione*’ apo ‘*ammenda*’ të cilat sipas kodit civil italian, kanë specifika përdorimi të ndryshme. Shembuj të ngjashëm janë fjalët në gjuhën italiane: *reclusione/arresto, affitto/locazione, proprieta’ possesso, separazione/divorzio etj*).

❖ Gjuha juridike i referohet shpesh shprehjeve të kodifikuara të cilat marrin karakterin e frazave idiomatike. Më poshtë po sjellim ato më tipiket:

- *in sede di giudizio*
- *diritto a tenere*
- *premesso che*
- *preso atto di*
- *in deroga a*
- *far valere*
- *porre in essere*
- *a cessare da*
- *stare in giudizio*
- *per legge*
- *ai sensi della legge*
- *visto gli atti*
- *considerando che*

❖ Transpozimi në gjuhën juridike të fjalëve të huazuara nga gjuha e zakonshme, por që kanë një kuptim të ndryshëm dhe specifik në gjuhën teknike juridike, sipas tabelës së mëposhtme:

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

<b>Fjala</b>	<b>Gjuha e zakonshme</b>	<b>Gjuha juridike</b>
<b>Ramo</b>	Parte dell'albero ( <i>degë e pemës</i> )	Branca, settore di una disciplina ( <i>degë, sektor i një discipline</i> )
<b>Principio</b>	Inizio, origine ( <i>Fillim, origjinë</i> )	Fondamento, base di una scienza ( <i>Themel, baza e një shkence</i> )
<b>Disciplina</b>	Ordine, obbedienza ( <i>Disiplinë</i> )	Materia di studio, regole di insegnamento ( <i>Lëndë studime, rregulla mësimdhënieje</i> )
<b>Pena</b>	Sofferenza, disagio ( <i>vuajtje, shqetësim</i> )	Sanzione imposta a chi trasgredisce le norme giuridiche ( <i>sanksion i vendosur për thyerje të normave juridike</i> )
<b>Offesa</b>	Insulto, ingiustizia ( <i>fyerje, padrejtësi</i> )	Danno, delitto contro qualcosa o qualcuno ( <i>dëm, krim kundër diçkaje apo dikujti</i> )
<b>Obbligo</b>	Imposizione, impegno ( <i>impenjim</i> )	Dovere imposto dalla legge ( <i>detyrim ligjor</i> )

- ❖ Shkarkim i terminologjisë nga vlerësimet emocionuese.
- ❖ Në tekstet juridike gjejnë përdorim të shpeshtë shkurtimet të cilat i referohen ligjeve, institucioneve. Po sjellim si shembull, me shpjegimet përkatëse disa prej tyre të evidentuara në tekstet e analizuara.

Art = articolo (nen)

Att = disposizioni di attuazione (akte normative)

Cass= cassazione (kasacion)

c.c. = codice civile (kodi civil)

c.p. = codice penale (kodi penal)

cost = Costituzione (kushtetuta)

c.p.c. = codice di procedura civile (Kod i procedurës civile)

c.p.p. = codice di procedura penale (kod i procedurës penale)

cpv = capoverso (kryeradhë)

d.i. = decreto interministeriale (dekret ndërministerial)

d.m. = decreto ministeriale (dekret ministerial)

d.P.R. = decreto del Presidente della Repubblica (dekret i presidentit të Republikës)

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

l.= legge (ligj)

l.cos = legge costituzionale (ligj kushtetues)

l.dir.aut. = protezione del diritto dell'autore (mbrojtje e të drejtës së autorit)

l.rg = legge regionale (ligj rajonal)

reg. = regolamento (rregullore)

t.u. = testo unico (tekst i vetëm)

v. = vedi (shih)

Në përfundim të analizës leksikore të gjuhës italiane juridike, mund të themi se terminologjia juridike, është një aspekt i rëndësishëm që e diferencon këtë gjuhë nga gjuha e zakonshme, pavarësisht raportit të ndërsjellë mes tyre.

### **Aspekte morfo-sintaksore të gjuhës italiane juridike**

Në studimet e kryera nga gjuhëtarët mbi gjuhën juridike arrihet shpesh herë në tezën se kjo gjuhë, si të gjitha gjuhët e tjera të specialitetit, paraqet një sintaksë të qëndrueshme dhe aspekt fleksibël<sup>35</sup> dhe se ndryshimet me gjuhën e zakonshme verifikohen kryesisht në drejtimin sasiar, tezë kjo e cila bashkon gjuhët e specialitetit në tërësinë e tyre. Ndoshta, sikurse nënvizon Rovere,<sup>36</sup> është pikërisht ky motivi i mungesës së gramatikave specifike për gjuhët e specialitetit në përgjithësi dhe për gjuhën juridike në veçanti. Një përdorim i veçantë i strukturave gjuhësore, përtej pikëpamjes sasiore, duhet analizuar duke konsideruar lidhjen mes llojit të tekstit dhe zgjedhjeve sintaksore të bëra, pasi ndryshimet sintaksore janë të lidhura me funksionin e ndryshëm që vetë tekstet kanë. Përdorimi dhe frekuenca e mjeteve morfo-sintaksore është e ndryshme sipas tipologjisë tekstuale dhe nivelit komunikues në të cilin duhet të veprojë teksti.

Sintaksa juridiko-administrative është mjaft komplekse (prania e vazhdueshme e periudhave të gjata, me shumë fjali të nënrenditura të karakterizuara nga fjalë lidhëse të tilla si: si '*premesso che*', *preso atto di*', *ove*', *in deroga a*, të cilat shpesh krijojnë probleme interpretimi, prania e ndajshimeve, përdorimi i mohores dhe i mohores së dyfishtë etj). Nga pikëpamja morfo-sintaksore dhe e organizimit të tekstit, gjuha juridike, duke u diferencuar nga gjuhët e lëndëve shkencore të cilat karakterizohen nga një përdorim mjaft i kufizuar i kohëve të foljes, dallohet për një larshmëri kohësh foljore të mënyrës dëftore, por edhe të mënyrës lidhore, kushtore, apo për praninë e periudhave hipotetike, të përbëra nga fjali kryesore, të cilat shprehin shkakun dhe fjali të varura që shprehin pasojën.

Më poshtë, po sjellim shembuj, përmes të cilëve verifikohen veçoritë-morfo-sintaksore që karakterizojnë gjuhën italiane juridike:

---

<sup>35</sup> Dardano, 1987, fq. 366

<sup>36</sup> Rovere, G (1999), 'Aspetti grammaticali in testi giuridici' në D. Veronesi, *Gjuhësia juridike italiane dhe gjermane*, Unipress, Padova, fq. 261-71.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- ❖ Përdorimi i foljeve në kohën e tashme të mënyrës dëftore, kryesisht në rastin e përkufizimeve:  
(*La costituzione sancisce l'ordinamento dello Stato*).
- ❖ Përdorimi i kohës së ardhshme me vlerën e urdhërores:  
(*andra' fatto, verra' eseguito*).
- ❖ Përdorimi i formës pësore të foljeve të paraprirë nga foljet 'potere' dhe 'dovere':  
(*Nessuno puo' essere perseguito; Deve essere avvisata l'autorita'*).
- ❖ Përdorimi i shpeshtë i pjesores së tashme:  
(*costituente, dipendente, seguente*), apo i pjesores së përbërë: (*adottati, stabiliti, attribuiti, etj*).
- ❖ Përdorimi i pjesores së thjeshtë apo të përbërë me funksionin e emrit:  
(*rappresentare - rappresentante, votare - votante, delegare - delegato, candidare-candidato*).
- ❖ Përdorimi i formës së pashtjelluar së përcjellores, në fjalitë e nënrenditura, të cilat shprehin një raport kohor, mënyre, shkak me fjalinë kryesore. Në gjuhën juridike ky element ndikon për ta bërë tekstin më sintetik dhe konçiz:  
(*La Repubblica svolge molte delle sue funzioni, avvalendosi degli enti locali*).
- ❖ Përdorimi i i mënyrës lidhore, veçanërisht në fjalitë e përbëra:  
(*La Costituzione prevede che per tre scrutini ci possa essere una convergenza di voti da tante parte politiche sul candidato*).
- ❖ Përdorimi i lidhëzave bashkërenditëse në fjalitë e përbëra për të lidhur në mënyrë të thjeshtë dy koncepte apo fakte paralele:  
(*Il compito del giudice tutelare e' di sovrintendere alle tutele e di nominare il tutore di un minore*).
- ❖ Përdorimi i lidhëzave kohore në fjalitë e shtjelluara (eksplicite):  
(*Dopo che tutti i senatori avevano preso posto, il presidente metteva in discussione la delibera*).
- ❖ Përdorimi i përmerave lidhorë 'che', 'cui', 'il quale' të cilat lejojnë të shtojnë informacione mbi një element të një fjalie tjetër:  
(*Il diritto soggettivo e' ogni interesse, che un cittadino puo' pretendere di difendere, protetto da una legge dello stato*). Këtu përmerri lidhor 'che' lejon të shtojmë një informacion mbi fjalën 'interesse'. Vërejmë se ndryshe nga gjuha e folur në të cilën përdoren përmerat lidhorë 'che' e 'cui', në gjuhën e shkruar shpesh përmerri 'che' zëvendësohet nga përmerat 'il quale, la quale, i quali, le quali, për të saktësuar më shumë se cilës fjalë përmerri lidhor i referohet.



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- ❖ Përdorimi i lidhëzave të nënrenditura shkakore, lejore, kushtore (*se, qualora, nel caso in cui, a condizione che, a patto che, previa, salvo che, sempreche*), në rastet kur shprehet një hipotezë ose një kusht:  
*(Qualora commettesse un reato verrebbe punito; La riparazione dei seggi tra le Regioni, **previa** applicazione delle disposizioni del precedente comma, si effettua in proporzione alla popolazione delle Regioni).*
- ❖ Mungesa e mbiemrave të gradueshëm (në gjuhën juridike nuk gjejnë vend forma të tilla si ‘*më shumë konsultues*’ ose ‘*më pak juridik*’), si dhe mungesa e emrave të formuar me prapashtesat zvogëluese, zmadhuese apo përçmuese. Kjo shpjegohet me mungesën e notave vlerësuese, zvogëluese, përkeqësuese ose me kuptime të figurshme, apo me mungesën e elementit subjektiv në gjuhën juridike.
- ❖ Përdorimi i vazhdueshëm i mekanizmave të formimit të fjalëve dhe të prejardhjes së tyre përmes prapashtesave dhe krijimi i familjeve të fjalëve:  
*(costituire, costituzione, costituente, costituzionalita’, anticostituzionale, costituzionalismo etj).*
- ❖ Përdorimi i parashtesave –*dis-in-a-s* për formimin e fjalëve me kuptim të kundërt:  
*Uguaglianza – Disuguaglianza*  
*Approvazione- Disapprovazione*  
*Civile – Incivile*  
*Politico – Apolitico*  
*Incarcerare - Scarcerare*

Analiza e mësipërme lidhur me veçoritë e gjuhës juridike shërben si orientim për mësuesit të cilët japin këtë lëndë, për përgatitjen e veprimtarive didaktike, duke u përqëndruar në këto veçori. Kështu, në njësinë didaktike e cila do të trajtohet në kreun e fundit të këtij punimi për mësimin dhe përvetësimin e gjuhës italiane juridike, për përgatitjen e veprimtarive didaktike, u jemi referuar këtyre veçorive, për një mësimdhënie të gjuhës italiane juridike në funksion të forcimit të kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturor.

### II.2.2. Analizë e gjuhës italiane ekonomike

Gjuha ekonomike inkuadrohet si një gjuhë specialiteti e cila ka veçoritë tipike të saj që e dallojnë, jo vetëm nga gjuha e zakonshme, por edhe nga gjuhët e disiplinave të tjera. Fusha e shkencave ekonomike përbëhet nga shumë disiplina (*ekonomia politike, politika ekonomike, e drejta ekonomike, disiplinat financiare dhe të ndërmarrjeve, deri tek ato të marketingut dhe të menaxhimit*), që pasqyrojnë dijet me të cilat ekonomia është

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

ushqyer dhe përcaktuar gjatë zhvillimit të saj historik. Një nëndarje e tillë i korrispondon edhe kompleksiteti epistemik dhe gjuhësor i studimeve ekonomike të përqëndruara mbi analizën e situatave të veçanta, tepër komplekske. Duke u nisur nga një këndvështrim i jashtëm ose «vertikal», sipas shpjegimit të Cortelazzo-s,<sup>37</sup> 'gjuha ekonomike dhe e financës paraqet një artikullim të pasur në lloje apo nivele tekstuale të diferencuara dhe me përhapje të ndryshme. Shkohet nga niveli i specialitetit (në të cilin vërehet tendenca e mbizotërimit të teknikizmave dhe terminologjisë konceptuale), në një nivel të lartë formalizimi, ku spikasin dukshëm grafikët, ikonat, apo termat në gjuhë të huaj, kryesisht ato të terminologjisë anglo-amerikane.

### **Aspekte leksikore**

Nëse do të krahasonim nivelin e lexueshmërisë të teksteve ekonomike kundrejt atyre të fushave të tjera disiplinore mund të shprehemi se gjuha e ekonomisë mban një tregues kuptueshmërie me të vogël. Kjo për shkak të teknikizmave, të cilat janë të pakuptueshëm për ata që nuk janë specialistë të fushës.

#### **❖ Leksiku i specializuar.**

Leksiku i specializuar ose ndryshe terminologjia ekonomike është rezultat i një procesi të ngadaltë që, duke përjashtuar kalket dhe përkthimet nga gjuhë të tjera, e ka origjinën nga fjalë të gjuhës së zakonshme, të cilat duke u kthyer në terma, marrin një kuptim specifik. Kështu fjalët '*investimento*' (*investim*), '*mercato*' (*treg*) o '*azione*' (*veprim*), në gjuhën e zakonshme kanë një përdorim më të gjerë, në gjuhën ekonomike marrin një kuptim më të kufizuar. Në tabelën e mëposhtme sillen shembuj të tjerë, ku e njëjta fjalë ka kuptime të ndryshme në gjuhën e zakonshme dhe në gjuhën e specialitetit.

---

<sup>37</sup> Cortelazzo, Michele A. (1990), *Lingue speciali. La dimensione verticale*, Padova, Unipress

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

<b>Fjala</b>	<b>Gjuha e zakonshme</b>	<b>Gjuha ekonomike</b>
<b>Utile</b>	Servizi <b>utili</b> (shërbime të dobishme)	<b>Gli utili</b> della societa (Fitimet e shoqërisë)
<b>Bene</b>	Fa <b>bene</b> il suo lavoro (kryen mirë punën e tij)	Questo e' un <b>bene</b> comune (kjo është një pasuri e përbashkët)
<b>Esercizio</b>	L' <b>esercizio</b> di matematica (ushtrimi i matematikës)	<b>L'esercizio</b> dell'attivitita' (ushtrimi aktivitetit)
<b>Parte</b>	<b>Da queste parti</b> (nga këto anë)	<b>Le parti</b> hanno firmato il contratto (palët kanë firmosur kontratën)

Nga ana tjetër, fjalët e gjuhës së zakonshme kanë sinonimet e tyre përkatëse në gjuhën ekonomike. Përdorimi i tyre kundrejt fjalëve të zakonshme është tregues i kompetencës gjuhësore në fushën ekonomike dhe rrit standardin e komunikimit

Më poshtë një tabelë pasqyruese e raportit mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhës ekonomike.

<b>Fjalë të gjuhës së zakonshme</b>	<b>Terma të gjuhës ekonomike</b>
Condizione	Clausola
Concordato	Pattuito
Pagare su un conto bancario	Versare
Proprietario	Titolare
Somma	Importo
Pagamento	Versamento
Comprare	Acquistare
Decidere	Deliberare
Prestito	Mutuo
Ritirare	Prelevare
Percentuale	Tasso
Operazioni	Transazioni

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- Një element tjetër karakterizues i gjuhës ekonomike është përdorimi i **njësive leksikore të larta**, sikurse edhe në gjuhët e tjera të specialitetit:

*Carta di credito, partita Iva, capitale sociale, in contanti, conto corrente, tasso d'interesse, persona giuridica, indicatore economico, gara d'appalto, collegio sindacale, carta di credito, ragione sociale, carta assegni: etj*

- Përdorimi i **mekanizmave analogjiko-metaforike** me gjuhët e tjera të specialitetit.

Për shembull: termat *liquidità* (likuiditet) e *circolazione* (qarkullim), të përdorura në gjuhën ekonomike janë në analogji metaforike me terma të gjuhës mjekësore (*fluks dhe qarkullimi i gjakut*).

- Prania e **termave dhe shprehjeve juridikë** në tekste ekonomiko-tregtare, kryesisht në hartimin e kontratave, akteve të themelimit të shoqërive tregtare e të ngjashme me to.

- Përdorimi i gjerë i **siglave** si:

**Srl** (società a responsabilità limitata- shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

**Spa** (società per azioni- shoqëri aksionerësh);

**S.s** (società semplice)- shoqëri të thjeshta

**Cda** (Consiglio di amministrazione- bordi drejtues)

**ISO** (International Standard Organisation-Organizata e Standardeve Ndërkombëtare)

**B2C** (Commercio elettronico tra aziende - Tregti elektronike mes ndërmarrjeve)

**PIL** (Prodotto interno lordo- Produkti i përgjithshëm bruto)

**BOT** (Buoni ordinari del tesoro- Bono të zakonshme thesari)

### Aspekte morfo-sintaksore

Duke mos dashur të përsërisim veçoritë morfo-sintaksore, tipike për të gjitha gjuhët e specialitetit, trajtuar në çështjen e parë të këtij punimi, pas analizës së korpusit tekstual ekonomik (*kontrata, dokumente bankare, artikuj gazetash të faqes ekonomike etj*), po nxjerrim në pah ato veçori morfo-sintaksore të cilat karakterizojnë specifikisht gjuhën italiane ekonomike.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- Përdorimi i **nyjes së shquar** në gjininë mashkullore, numri njëjës, para citimit të përqindjeve:
  - *Il 32% delle pensioni erogate tra il 1992 e il 1995 e' superiore di almeno il 30% rispetto all'importo che si sarebbe raggiunto con il calcolo contributivo.*
- Përdorimi i **parafjalëve të përbëra** para shifrave:
  - *Il tasso d'interesse sulle norme depositate e' pari al 2%;*
  - *Ci sono alcuni beni ed alcuni servizi per i quali la legge prevede delle aliquote del 4%*
- Prania e lidhëzave të nënrenditura, të cilat shprehin raportin shkak-pasojë
  - *poiche', dato che.... , se.....allora, quindi, dunque, infatti etj.*
- Prania e fjalive të përbëra, në të cilat krahas formave të shtjelluara, me përdorime të ndryshme mënyrash foljore, përdoren edhe format e pashtjelluara, si paskajorja, përcjellorja e pjesorja.
  - *Va avanti l'operazione trasparenza per **informare** i cittadini di quanto le vecchie regole previdenziali fossero generose.*
  - *La Repubblica **svolge** molte delle sue funzioni, **avvalendosi** degli uffici deenti locali.*
- Përdorimi i formës pësore të foljeve, me zëvendësim të foljes ndihmëse 'essere' me foljen 'venire' në kohët e thjeshta:
  - *Questi contratti **sono scritti** dal venditore*
  - *Il contratto **viene firmato** dal rappresentante della societa'.*

Në gjuhën ekonomike mbizotërojnë elementët jashtëgjuhësorë, të tilla si grafikë, diagrame, tabela të cilat shërbejnë për të pasqyruar të dhëna të ndryshme.

### II.2.3. Analizë e Gjuhës italiane mjekësore

Sikurse për gjuhën juridike dhe ekonomike dhe për gjuhën italiane mjekësore kemi analizuar një korpus tekstesh, prej të cilëve nxorrëm në pah aspekte leksikore dhe morfosintaksore, sipas shembujve të mëposhtëm.

#### Aspekte leksikore

- ❖ Në gjuhën italiane mjekësore, për një argument të caktuar përdoren zgjedhje gjuhësore (kryesisht leksikore), të ndryshme midis komunikimit vertikal dhe komunikimit horizontal. Përdorimi i termave specifike përcaktohet nga aktiviteti

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

profesional i folësve (mjekut, infermierit) dhe nga njohuritë e pacientit lidhur me leksikun e përdorur.

Shembull:

*Pacienti (Infermieres): Buongiorno. Sono qui per togliere le tonsille.*

*Infermierja (mjekut): Dottore, c'è un paziente per una tonsillectomia.*

- ❖ Fjalët e gjuhës së zakonshme marrin një kuptim të ndryshëm specifik kur përdoren në gjuhën mjekësore:

Fjala/Termi	Gjuha e zakonshme	Gjuha mjekësore
Carattere	Personalita' (karakter)	Caratteristica (veçori)
Sostanza	Prodotto (lëndë)	Composto (Përbërje)
Legame	Relazione (marrëdhënie)	Collegamento tra piu' elementi chimici (lidhje)
Loggia	Terrazza (Taracë)	Spazio in cui e' contenuto un organo. (hapësirë ku ndodhet një organ)
Tessuto	Stoffa (copë)	Insieme di cellule dello stesso tipo (tërësia e qelizave të së njëjtit lloj)
Vaso	Anfora (vazo)	Canale (enë gjaku)

- ❖ **Prania e njësive leksikore të larta**

Gjuha e mjekësisë karakterizohet nga prania e shumë të **njësive leksikore të larta**.

Shembuj:

*apparato circolatorio; battito cardiaco, stato patologico, parete toracica, corpo umano, gabbia toracica, scatola cranica et, parete ventricolare, dura madre, pia madre, sistema nervoso, midolo spinale, etj.*

- ❖ **Prania e termave me origjinë greko-latine**

Sikurse e shpjeguar më lart, terminologjia greko-latine, sot, sillen në formën e saj të paprekur, pra sikurse ka ekzistuar që në kohët e lashta. Në terminogjinë mjekësore nuk kemi thjesht huazime të zakonshme të fjalëve të reja nga fondi i leksikut të gjuhëve greko-latine, por kemi të bëjmë me huazime nga këto gjuhë të elementëve fjalëformuese

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

dhe termaformuese, të parashtesave, prapashtesave dhe të rrënjëve me aftësi termaformuese.

Në gjuhën italiane të mjekësisë, sikurse edhe në gjuhën shqipe është e mundur të krijohen fjalë të prejardhura përmes parashtesave, por e veçanta është së pjesa më e madhe e tyre janë me prejardhje etimologjiko greko-latine, të cila sjellin një kuptim të caktuar, duke ndihmuar në kuptimin e termit të ri të krijuar.

Terma mjekësorë me prejardhje greko-latine:

Parashtesat greko-latine	Termet mjekësorë
Semi (gjysëm)	Semimobile
Micro (i vogël)	Microcellulare
Inter (ndërmjet)	Interosseo
Intra (brenda)	Intrauterina
Endo (brenda)	Endoderma
Extra (jashtë)	Extracellulare
Ecto (jashtë)	Ectoderma
Eso (i jashtëm)	Esotermico
Proto (e përparme)	Protoplasma
Cito (qelizë)	Citoplasma
Poli (shumë)	Polifosili

- ❖ Emrat e terminologjisë mjekësore të cilat formohen me '**geno**' element me prejardhje latine, tregojnë një fenomen i cili prodhon, gjeneron. Më poshtë disa shembuj:

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Termine (Termi)	Definizione (Përkufizimi)
Patogeno	Që provokon sëmundje
Mutageno	Që prodhon ndryshime
Cancerogeno	Që sjell sëmundje tumorale

- ❖ Prapashtesa **-osi** – tregon një patologji e cila tenton për të qenë kronike (*osteoporosi, tubercolosi*).
- ❖ Prapashtesa **-ite**- tregon një proces inflamator akut: (*appendicite, peritonite, epatite*).
- ❖ **Huazime nga gjuhë të tjera, kryesisht nga gjuha angleze.** Ky fenomen dëshmon nga njëra anë natyrën ndërkombëtare të komuniteteve shkencore, dhe nga ana tjetër përcaktojnë se cilat shtete, (për arsye historike apo kulturore), kanë kontribuar duke eksportuar termat e gjuhës së tyre, për zhvillimin e një disipline të caktuar.

Gjuha mjekësore është e pasur me huazime angleze. Në vijim disa terma të cilat janë bërë pjesë e gjuhës mjekësore italiane:

Termine (termi)	Spiegazione (shpjegimi)
<b>Lifting</b>	Eliminazione chirurgica delle rughe del viso e del collo mediante innalzamento o tensione della pelle ( <i>eliminim kirurgjik i rrudhave të fytyrës dhe të qafës përmes ngritjes së lëkurës</i> ).
<b>Check-up</b>	Serie di analisi ed esami clinici mirati a dare un quadro completo delle condizioni di salute di una persona ( <i>një sërë analizash klinike që synojnë dhënin e një kuadri të plotë të shëndetit të njeriut</i> ).
<b>Screening</b>	Indagine di massa generalmente condotta su soggetti esposti ad alto rischio di malattie ( <i>kontroll në masë kryesisht mbi subjekte që ekspozohen me një rrezik të lart sëmundjesh</i> ).
<b>Strong unit</b>	<i>Reparto dove vengono ricoverati i pazienti con ictus (repart ku shtrohen të sëmurët me infart cerebral).</i>

- ❖ **Huazimi i termave nga shkencat gjeometrike.** Për të përshkruar formën e pjesëve të trupit të njeriut, gjuha e mjekësisë përdor edhe terma që përcaktojnë figura të ndryshme gjeometrike ë tilla si:



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

(piramidali circolare, ovoidale, rettangolare, romboencefalo, extrapiramidale etj).

### Aspekte morfo-sintaksore

Duke mos përsëritur veçoritë morfo-sintaksore që karakterizojnë përgjithësisht gjuhët e specialitetit, të trajtuara në kreun e parë të këtij punimi, do të ndalemi tek mekanizmat e krijimit të fjalëve të prejardhura dhe të përbëra.

- ❖ Formimi i mbiemrave nga emra përmes prapashtesave ‘ale’, ‘are’, ‘ico’ ‘ivo’, ‘ile’, ‘eo’, ‘ante’, ‘oso’

Sostantivi (Emra)	Aggettivi (Mbiemra)
Embrione	Embrionale
Struttura	Strutturale
Cellula	Cellulare
Polo	Polare
Genoma	Genomico
Morfogenesi	Morfogenetico
Enzima	Enzimatico
Ossidazione	Ossidativo
Asse	Assile
Osso	Osseo
Dominio	Dominante
Vena	Venoso

- ❖ Formimi i mbiemrave me kuptim të kundërt përmes parashtesave: **a, an, de, dis, in, ir, il, s**

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Aggettivi (Mbiemra)	Contrari (Kuptimi i kundërt)
Proteica	Aproteica
Consistente	Inconsistente
Organico	Inorganico
Ambulazione	Deambulazione

- ❖ Emrat e terminologjise mjekësore të cilat mbarojne më ‘**gramma**’, janë të gjinisë mashkullore. Ato janë fjalë të përbëra, me prejardhje etimologjike nga greqishtja (*graphein -shkruaj*); dhe tregojnë rezultatin e shkruar të një ekzaminimi:

*elettroencefalogramma (EEG):* rezultati i ekzaminimit kryer me elektrocefalografi;

- ❖ Emrat e terminologjise mjekësore të cilat mbarojne më ‘**grafo**’, janë te gjinisë mashkullore dhe tregojnë një aparaturë, një instrument:

*Elettrocardiografo:* instrument që shërben për të kontrolluar aktivitetin elektrik të zemrës.

- ❖ Emrat e terminologjise mjekësore të cilat mbarojne më ‘**grafia**’, janë të gjinisë femërore dhe tregojnë një teknikë regjistrimi ose një metodë hetimi që lejon diagnozën e disa sëmundjeve:

*Ecocardiografia:* teknikë kontrolli i zemrës përmes ultratingujve.

- ❖ Në gjuhën mjekësore sikurse edhe në gjuhët e tjera të specialitetit, për të mbajtur një nivel të caktuar abstraksioni, shpesh në vend të një fjalis kryesore dhe të një fjalis të nënrenditur përdoret vetëm një fjali kryesore në të cilën pjesa e nënrenditur zëvendësohet nga një emër.

Shembuj:

- *E' necessario **che si producano varie sostanze** – E' necessaria **la produzione di varie sostanze.***
- *La cellula muore **perche' cessa di produrre ATP**- La cellula muore perche' cessa **la produzione di ATP.***

- ❖ Mbizotërimi i formës pësore kundrejt asaj veprare, sikurse rezulton në tekstin e mëposhtëm:

*Le ossa sono fatte di diversi strati. Le ossa sono ricoperte da un sottile rivestimento che si chiama periostio. Lo strato al di sotto del periostio è fatto di una sostanza dura e resistente e si chiama tessuto compatto. Le ossa sono unite dai legamenti, una specie di filo che tiene le ossa vicine e soprattutto le lascia muovere.*

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- ❖ Në disa specialitete të mjekësisë, sikurse në Biokimi, përdoren shpesh siglat dhe simbolet për të treguar substancat dhe përbërjet kimike të tyre. Për shembull, simboli kimik i ujit është H<sub>2</sub>O. Në gjuhën mjekësore këto simbole përdoren si të tilla dhe nuk shpjegohen me fjalë. Ajo që vërehet është se në gjuhën italiane, siglat paraprihen nga nyja shquese dhe nga parafjalët e përbëra.

Shembull:

*il GTP trasferisce il fosforo all'ADP, formando ATP.*

Ndërsa simbolet përgjithësisht nuk paraprihen nga nyja ose nga parafjalët e përbëra.

Shembull:

*Nei mitocondri entrano sostanze combustibili che vengono ossidate in Co<sub>2</sub> e H<sub>2</sub>O.*

Në përfundim të analizës së gjuhëve të specialitetit në përgjithësi, por edhe të gjuhës italiane italiane, ekonomike dhe mjekësore, në veçanti, mund të themi se ato dallohen kryesisht nga dimensionimi leksikor. Çdo gjuhë ka terminologjinë e vet specifike. Por kjo nuk është e ndarë me thikë. Në aspektin morfo-sintaksor vërtetohet se gjuhët e specialitetit kanë aspekte të përbashkëta morfo-sintaksore, të cilat përdoren me një frekuencë më të lartë kundrejt përdorimit të tyre në gjuhën e zakonshme.

Nga ana tjetër nga kjo analizë rezultoi i qartë komunikimi reciprok terminologjik midis vetë gjuhëve të specialitetit, edhe pse konteksti i përdorimit është i ndryshëm. Një element tjetër që i bashkon këto tre gjuhë është raporti i ndërsjellë me gjuhën e zakonshme.

Përdorimi i termave të huaja, kryesisht angleze, është një element bashkues për të tria gjuhët e analizuara.

Ndryshe nga gjuha ekonomike, ku fjalët janë me origjinë latine, në gjuhën juridike, por edhe më shumë në atë mjekësore termat latinë të papërshtatur zënë një vend të dukshëm.

Në gjuhën italiane mjekësore në krahasim me gjuhën italiane juridike dhe atë ekonomike janë më të shpeshta fjalët e prejardhura me parashtesa greko-latine.

Në përfundim, duke u nisur edhe nga analiza e mësipërme, nënvizojmë se ndryshimet më të mëdha mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit prekin me intensitet më të lartë rrafshin leksikor, kundrejt ndryshimeve në rrafshin morfologjiko-sintaksor apo tekstual.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## KREU III

### DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË SHOQËRINË E SOTME KOMPLEKSE DHE TË SEKTORIALIZUAR

#### III.1. Mësimi i gjuhëve të huaja të specialitetit sot në botë

Këtu do të përpiqemi të ofrojmë një bazë të dhënash, përmes një udhëtimi gjeo-informativ, mbi studimin e gjuhëve të huaja të specialitetit në botë, kryesisht në gjuhën angleze dhe frënge.

Qëllimi është të nxjerrim në pah filozofinë që fshihet pas kësaj dege të glotodidaktikës, përhapjen e interesit gjithnjë e në rritje të mësimit dhe përvetësimit të gjuhëve të huaja të specialitetit. Nga ana tjetër, synohet të ofrohet një bazë të dhënash, e rëndësishme, e plotësuar me të gjitha institucionet e specializuara në mbarë botën, ç'ka mund t'u vijë në ndihmë studentëve, por kryesisht mësuesëve e pedagogëve të gjuhëve të huaja të specialitetit për forcimin e mëtejshëm të kompetencave të tyre në këtë fushë të mësimdhënies. Informacionet e mbledhura lidhur me mësimdhënien e gjuhëve të specialitetit në vendet anglofone apo frankofone përbëjnë një pikë referimi të dobishme, jo vetëm përsa i përket kurseve dhe kërkimeve mbi gjuhët e disiplinave të specialitetit, por veçanërisht për të vlerësuar impostimet e ndryshme didaktike, që synojnë të plotësojnë një shumëllojshmëri kërkesash lidhur me përdorimet e shumëfishta të gjuhëve sektoriale.

**NË MBRETËRINË E BASHKUAR** janë të shumta institucionet ku mësohet për qëllime akademike apo profesionale gjuha angleze dhe gjuhë të tjera si frengjishtja, spanjishtja e gjermanishtja. Gjuha e huaj, kryesisht është veikolare, pra përdoret si mjet i vetëm për lendën specifike, ose mbështetëse, pra e studiuar për të integruar argumentin specifik dhe në të njëjtën kohë për të zgjeruar njohuritë specifike në një gjuhë të dytë.

Në *City of London Polytechnic*, kurset e gjuhëve të specialitetit zhvillohen në gjuhën frënge, gjermane, spanjolle dhe angleze. Theksi vendoset mbi komunikimin në sektorin **tregtar dhe ekonomik**. Objektivi i kursit është pajisja e studentëve me aftësi praktike të nevojshme për aktivitetin e tyre në gjuhë të dytë. Frengjishtja, gjermanishtja dhe spanjishtja mësohen si gjuhë mbështetëse, ndërsa anglishtja si gjuhë e huaj është veikolare.

Në *Shkollën e Gjuhëve Moderne të Newcastle Polytechnic* kryhen studime dhe kërkime në spanjisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe rusisht në **specialitetin e financës** ku gjuha ka funksion veikolar.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Në *Ulcester Polytecnic të Belfastit* mësohet frengjishtja **ekonomiko-tregtare** si gjuhë vekolare.

Në *Universitetin e Astonit* kryhen studime dhe kërkime mbi gjuhët e specialitetit dhe në veçanti mbi programimin e kurseve të karakterit **legjislativ dhe administrativ**. Ky institucion universitar ofron një shërbim për specializimin dhe trajnimin e mësuesëve lidhur me metodat dhe teknikat e mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit.

*Departamenti i Gjuhësisë së Universitetit Essex* organizon kurse në gjuhën angleze për qëllime akademike dhe, në varësi të fushës specifike, gjuha është vekolare ose mbështetëse. Edhe pranë këtij Universiteti mund të ndiqen kurse tremujore formimi dhe trajnimi në mësimdhënien e gjuhës angleze për qëllime të veçanta.

Në *qendrën gjuhësore të Universitetit të Exeter-it* zhvillohen kurse gjuhe në fushën e **së drejtës, të politikës, të administratës shoqërore** si dhe në specialitetet e **dijes teknike dhe shkencore**. Kurset bazohen kryesisht në kuptimin e leximit, si mjet për të studiuar një disiplinë specifike në gjuhë të dytë. Materialet dhe teknikat variojnë në bazë të nevojës së grupeve të studentëve.

*Instituti për mësimdhënien e gjuhës angleze të Universitetit të Lancasterit* zhvillon studime dhe kërkime lidhur me gjuhët e specialitetit në fushën **ekonomiko-administrative dhe të drejtimit të ndërmarrjeve**. Kurset janë në gjuhën angleze për studentë të huaj që u nevojitet një përgatitje për gjuhën specifike (ESP) apo për mësues që duhet të përgatiten për mësimdhënien specifike.

*Qendra e studimeve të aplikuara (CALS – Centre for Applied Languages Studies) të Universitetit të Readigut*, zhvillon studime mbi analizën e tekstit dhe programimin. Universiteti organizon kurse intensive të gjuhës angleze për mësues të huaj që dëshirojnë të perfeksionojnë metoda dhe teknika.

Mjaft i rëndësishëm është edhe publikimi i përmbledhjes voluminoze të *Pauline Robinson*, e cila u vjen në ndihmë mësuesëve të gjuhëve të huaja të specialitetit, ku ofrohet një vizion i qartë lidhur me metodat, didaktikën dhe prodhimin e materialeve nga vitet Gjashtëdhjetë deri në vitet Tetëdhjetë, pra në periudhën ku mësimdhënia e gjuhëve sektoriale ka marrë format zbatuese, paralelisht me teorinë gjuhësore dhe didaktike. Trajtohen çështje lidhur me motivimin, analizën e nevojave, ndërtimin e programeve dhe përgatitjen e materialeve, sipas një pëqasjeje komunikative. Analizohen gjithashtu librat kryesore të teksteve për qëllime specifike, si për shembull seria *‘English in focus’*, *‘English for Career’*, *‘Nucleus’* e të ngjashme me to, si dhe materiale të cilat ndihmojnë zhvillimin e aftësive të leximit, si një ndër aftësitë më të privileguara për mësimdhënien e gjuhëve të huaja të specialitetit.

*Departamenti i gjuhës frënge të Universitetit të Stirling (Skoci)*, njihet për kurset e frengjishtes për **shkencat administrative**, ku gjuha e dytë është vekolare. Në këto kurse zhvillohen të katërta aftësitë e gjuhës si dhe teknikat e interpretimit.

*British Council*, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për përhapjen e studimeve dhe kërkimeve mbi anglishten për qëllime specifike.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Le të shohim tani se si studiohen gjuhët e huaja të specialitetit përtej Atlantikut, në **SHTETE E BASHKUARA TË AMERIKËS**.

Në *American Language Academy (ALA) të Rockville*, kryhen studime mbi mësimdhënien e GJS-it, të asistuar nga kompiuteri (CAI- Computer Assisted Instruction). Programet e gjuhës angleze për qëllime akademike, të përgatitura në këtë qendër kërkimi, përdoren në më shumë se 11 universitete publike dhe private, në shumë shtete. Gjuha angleze është veicolare dhe kurset të cilat trajtojnë një gamë të gjerë gjuhësh sektoriale, u drejtohen studentëve të huaj.

Në *Qendrën e Gjuhësisë së Aplikuar të Washingtonit* kryhen studime mbi gjuhën angleze për qëllime profesionale, mbi përkthimin dhe analizohet raporti mes gjuhës dhe punës.

*Instituti i gjuhës angleze i Oregon State University*, kryen kurse të gjuhës angleze për qëllime akademike, si në sektorin teknik, ashtu edhe në atë tregtar. Për shembull, kurset 'English for Business' zgjasin nëntë muaj dhe bazohen mbi publikime specifike sikurse është *Business Concepts for English Practise*.

Në *Rutgers University të Camdenit (New Jersey)*, sektori lidhur me komunikimin gjuhësor është mjaft aktiv. Kurset janë ekskluzivisht për nxënës që njohin mirë gjuhën angleze e që duan të specializohen në gjuhën tregtare e të marketingut.

*Instituti i gjuhës angleze të Universitetit të Michiganit* inkurajon studime mbi analizën e gjuhës **ekonomiko-tregtare** dhe mbi gjuhën e **tregtisë ndërkombëtare**. Kryhen studime lidhur me ndërveprimin në raportin tekst/lexues dhe ligjëratën argumentative.

*American Language Institute i Universitetit të Southern California*, organizon kurse mbi anglishten e **administratës publike** dhe të **administrimit ekonomik të ndërmarrjeve**.

Edhe në **KANADA**, ndihet një rritje e interesit për mësimin e gjuhëve të specialitetit. *CALS (Center fo Applied Language Studies) i Universitetit Carleton te Ottaëas* zhvillon studime mbi analizën e nevojave, mbi modelet e programeve për Gjuhët e Specialitetit, mbi materialin didaktik të përdorur dhe testimet. Kurset interesojnë sektorë të ndryshëm, por janë të gjitha për studime akademike dhe aftësitë e zhvilluara u përgjigjen nevojave të specializimeve të ndryshme.

Në *Universitetin e Montrealit*, kryhen studime mbi përkthimin, terminologjinë dhe informatikën. Kurset janë në gjuhën angleze për studentët e gjuhës franceze dhe trajtojnë specialitete të ndryshme, mes të cilave, fusha specifike lidhur me të drejtën. Zhvillohet aftësia e të lexuarit, kërkimi terminologjik dhe përkthimi.

Në **AUSTRALI**, në *Departamentin e gjermanishtes, të Universitetit Monash të Clayton* zhvillohen studime të analizës krahasuese (anglisht-gjermanisht) mbi tekste për qëllime akademike, ndërsa në *Universitetin e Adelaides*, kryhen studime mbi analizën e teksteve dhe kërkime të karakterit sasior mbi termat teknike të gjuhës gjermane të shkencave njerëzore. Këto kurse përfshijnë edhe argumentë ekonomik-tregtarë dhe

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

zhvillohen aftësitë e leximit dhe përkthimit nga gjermanishtja në anglisht. Kurset ‘*German for Academic Purposes*’ janë intensive.

Në **ITALI** problematikat lidhur me Gjuhët e Specialitetit kanë qenë të pranishme që në vitet Tridhjetë, me revistën “*Lingua nostra*,” e cila trajtonte kryesisht aspektin leksikor të tyre. Në këndvështrimin didaktik ato kanë ngjallur jehonë, veçanërisht kur ish Ministri i Arsimit Publik, me Qarkoren nr. 639 te 30 korriut 1980, morri në shqyrtim kompleksitetin e problemeve lidhur me vendosjen e edukimit gjuhësor, në fakultetet e sistemit universitar të shtetit italian. “*Italishtja shkencore dhe teknike*”, “*Gjuha italiane veikolare*”, “*Gjuha italiane mjekësore*”, “*Italishtja për juristët*”, “*Italishtja për ekonomistët*”, janë disa nga tekstet mësimore që sot përdoren në universitete për mësimin e gjuhës së huaj, sipas profilit. Le të përshkruajmë këtë zhvillim të realizuar në këtë drejtim të ri të mësimdhënies së gjuhë italiane të specialitetit.

Në *Institutin e Gjuhëve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Tregtisë së Universitetit ‘La Sapienza’ të Romës* zhvillohen studime mbi përkthimin, mbi terminologjinë dhe modelet didaktike, me qëllim rritjen e kompetencës komunikuese. Në kurset për studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe të Ndërrmarjeve, gjuha angleze është mbështetëse dhe katër aftësitë zhvillohen përmes përqasjes komunikuese. Edhe në *Departamentin e Shkencave Ekonomike të Fakultetit të Ekonomisë dhe Tregtisë në Universitetin e Romës* kryhen studime dhe kërkime mbi gjuhën ekonomike dhe mbi përkthimin e teksteve ekonomike. Po në Universitetin e Romës, një grup studiuesish të çështjeve gjuhësore dhe glotodidaktike, ka publikuar një përmbledhje tekstesh, e cila ofron një panoramë të problematikave teorike dhe tendencat e realizimeve didaktike të realizuara në Francë, Britaninë e Madhe, Itali, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, midis viteve ‘89-90. Kjo përbën një bazë teorike mjaft të rëndësishme për studiuesit apo profesorët e këtyre gjuhëve.

Në *Universitetin katolik të Romës* është realizuar dhe publikuar një punim didaktik me titullin ‘*Anglishtja e Mjekësisë*’, i cili përbën një instrument të dobishëm studimi për studentë dhe pedagogë të këtij sektori specifik.

Në *Universitetin e Bolonjës*, Giuseppe Ragazzini, një ndër ekspertët më prestigjioz të leksikografisë dhe G. Gagliardelli, specialist i gjuhëve sektoriale kanë kryer studime dhe kërkime mbi gjuhën e ekonomisë, tregtisë dhe disiplinave të ngjashme me to, duke realizuar një fjalor, i cili ndihmon për të plotësuar kërkesat e operatorëve në fushën e ekonomisë<sup>38</sup>.

Në *Universitetin e Camerino-s*, është kompiuterizuar një përmbledhje sasiore mbi termat e anglishtes politike; në *Universitetin e Bergamo-s*, zhvillohen studime dhe kërkime mbi anglishten shkencore dhe teknike. Disa kontribute janë publikuar në revistën ‘*Shkolla dhe Gjuhët e Huaja*’, botuar nga ANILS (Shoqata kombëtare e Mësuesëve të gjuhëve të Huaja), ku referohet edhe për mësimdhënien e gjuhëve të specialitetit. Për t’u

---

<sup>38</sup> G.Ragazzini- G. Gagliardelli, *Dizionario Commerciale Inglese-Italiano/ Italiano-Inglese*, Mursia, Milano 1986. Eksperienca dhe profesionalizimi i Giuseppe Ragazzini-t shfaqen edhe në Fjalorin Anglisht-italisht/ Italisht-Anglisht, ku janë sjellë kalimet nga kuptimet e përdorimit të zakonshëm në atë të karakterit sektorial.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

përmendur, kontributet e Maurizio Gottit ‘*Mësimdhënia e gjuhëve të specialitetit*’, të R. Guerrini-t ‘*Gjuha dhe mikrogjuhët në mësimdhënie*, të Balbonit ‘*Mikrogjuhët dhe komunikimi në klasë*’ të cilat përbëjnë një bazë teorike, e pasur me propozime metodologjike mjaft të vlefshme.

*Universiteti ‘Ca Foscari’ i Venecias* është djepi i glotodidaktikës italiane, me kontribute të Giovanni Freddi, Paolo Balbonit dhe me shumë botime në fushën e gjuhëve të specialitetit të cilat sjellin kontribute teorike dhe metodologjike si dhe modele didaktike, shkencërisht të orientuara, të cilat u përgjigjen nevojave praktike të studimit të gjuhëve të specialitetit për qëllime akademike.

Në **FRANCË**, në Paris, *Qendra e Studimeve të Aplikuara në Komunikim të Gjuhëve të Specialitetit* zhvillon studime dhe kërkime për ndërtimin e modeleve didaktikë, përkthimin, mësimdhënien e asistuar nga kompiuteri etj. Kurset e organizuara nga kjo qendër mbahen në universitetin e Parisit, ku mësohet frengjishtja dhe anglishtja, si gjuhë të dyta, gjuhë mbështetëse apo vekolare për 17 fusha të ndryshme specialitetit. *Francais scientifique et technique*, ‘*francais vehiculaire*’, *francais instrumental*, ‘*langue de specialite*’, *francais fonctionnel* etj; një shumëllojshëmri terminologjie që shpesh mund të duket shenjë konfuzioni, në një fushë ku çdo term është dëshmia e etapave kronologjike të mësimt të gjuhës frënge për një qëllim të caktuar.

Që në vitet ’50, një organizëm i quajtur CREDIF<sup>39</sup> ka publikuar një vepër kapital për mësimdhënien e gjuhës frënge: *Il Francais Fondamental*<sup>40</sup>. Kjo vepër është rezultat i sondazheve sasiore të realizuara nën drejtimin e G. Gougnjheim, mbi fjalorin dhe gramatikën e frengjishtes së folur, si gjuhë e huaj për fillestarë. Nuk bëhet fjalë për një analizë të strukturave gramatikore të frengjishtes së folur, por për një listë fjalësh (1445 fjalë për nivelin e parë), të konsideruara prioritare, listë e cila mund të zgjerohet më vonë në faza të mëtejshme. Ky libër, ka shërbyer si bazë për hartimin e metodave të shumta të mësimdhënies së frengjishtes, si gjuhë e huaj. Më vonë, ëshë përpunuar faza e dytë ‘*Francais Fondamental 2*,’ me afro 1800 fjalë. Në këtë kontekst, është nisur të flitet për ‘*Frengjishten shkencore dhe teknike*’ dhe/ose *Gjuhë të specialitetit*. Ka dallime mes frengjishtes teknike dhe frengjishtes shkencore, një dallim deri diku i nevojshëm meqënëse këto dy koncepte shpesh njësoheshin. Në fakt, shkenca dhe frengjishtja shkencore lidhen me koncepte epistemologjike, ndërsa teknika dhe frengjishtja teknike me praktikën. Të njëjtët autorë të ‘*Francoise Fondamental*’, kanë nënvizuar të parët rolin shumë të rëndësishëm të një fjalori të gjuhës shkencore. Sipas hipotezave të tyre studentët pasi të kenë arritur nivelin e dytë, që në termat e sotëm do të përcaktohej si niveli B1, duhej të zotëronin një leksik shkencor, të përfshirë në fjalorin e përgjithshëm.

Në vazhdim të këtyre refleksioneve, ka lindur ‘*Vocabuliere General d’Orientation Scientifique*’ ose *V.G.O.S.*<sup>41</sup>, i përpunuar nga CREDIF dhe që përbën padyshim një ndër instrumentat themelore për përvetësimin e gjuhës shkencore. Numri total i termave të V.G.O.S është 1160, të paraqitura sipas rendit alfabetik. Leksikologët kanë krijuar një korpus duke u nisur nga tekset shkencore, dhe kanë nxjerrë në pah numrin e pranisë së

<sup>39</sup> CREDIF, Qendra e Kërkimeve dhe Studimeve për përhapjen e gjuhës frënge.

<sup>40</sup> Gougnenheim G. *L’elaboraion du francaise fondamentale*, Didier, Paris, 1964

<sup>41</sup> CREDIF, *Vocabuliere General d’Orientation Scientifique*, Didier, Paris, 1971



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

çdo termi (kriteri i frekuencës) dhe numrin e konteksteve të ndryshme, në të cilat çdo term shfaqet (kriteri i shpërndarjes). Është krijuar kështu një korpus sipas tre niveleve:

- ❖ Nivel më i ulët teknikiteti (manualet e matematikës, fizikës, shkencave të shkollave të mesme);
- ❖ Nivel mesatar teknikiteti (manualet e dy viteve të fundit të mësimdhënies universitare);
- ❖ Nivel më i lartë teknikiteti (librat shkencorë, enciklopeditë teknike dhe revistat e specializuara).

Hartimi i këtij fjalori lindi nga vëzhgimi i vështirësive të hasura nga studentët e huaj që në Francë ndërmerrnin studime shkencore. Këto vështirësi nuk lidheshin as me gjuhën e jetës së përditshme, as me gjuhën e specialitetit të fituar me vazhdimin e studimeve, por shfaqeshin në hapësirën e ndërmjetme mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhëve të specialitetit, ku mjete të shprehjes që i përkisnin gjuhës së zakonshme, përdoreheshin me qëllime të shprehjes shkencore. Eseja e njohur e Vigner dhe Martin<sup>42</sup> sjell elementë përshkruar të gjuhës teknike, duke dhënë edhe sugjerime për mësuesit në mënyrë që të tejkalojnë vështirësitë.

Frengjishtja funksionale ka pasur meritën e rinovimit të didaktikës së gjuhëve, pasi me të nuk është përsëritur gabimi për të propozuar të njëjtat metodologji gjuhësore dhe pedagogjike të frengjishtes së zakonshme; nuk bëhet fjalë për një frengjishte funksionale, por për një mësimdhënie funksionale të aspekteve gjuhësorë, në situata të caktuara<sup>43</sup>. Është pra funksionale çdo mësimdhënie që promovon praktika të përshtatshme për objektivat e caktuara. Më poshtë, po rendisim institucionet aktuale në Francë ku zhvillohen mësimet dhe kurset në gjuhë specialiteti.

*Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë së Parisit* ka një sektor që merret me mësimdhënien e gjuhës franceze të **tregtisë**. Në *Conseil International de la Langue Francaise (CILF)*, me seli në Paris, kryhen studime mbi terminologjitë shkencore, mbi gjuhësinë dhe pedagogjinë. Mësohet gjuha franceze lidhur me lloje të ndryshme të **komunikimit shkencor**. EIEC (Echange Internationaux et Culturels), merret me mësimdhënien e gjuhës ruse, spanjolle, portugeze, italiane dhe kineze të specialiteteve. *Federata Ndërkombëtare e Profesorëve të gjuhës Frënge (PIPF)*, e cila bashkëpunon me Këshillin e Europës dhe Unesco-n, interesohet për mësimdhënien e gjuhës frënge të specialitetit lidhur me të gjitha kontekstet shoqërore dhe kulturore të anëtarëve të saj. *Instituti Superior i Interpretariatit dhe i Përkthimit (ISIT)*, i cili bashkëpunon me departamentin e terminologjisë së Unesco-s, zhvillon kërkime pedagogjike mbi terminologjinë dhe përkthimin të asistuar nga kompiuteri. Kurset janë për qëllime profesionale dhe u drejtohen studentëve të ciklit të dytë universitar. Mësohet gjithashtu edhe anglishtja, gjermanishtja dhe spanjishtja e së **drejtës** dhe **tregtisë**, me theks të veçantë në gjuhën e shkruar. Në *Institutin Universitar të Teknologjisë*, kryhen studime mbi terminologjinë e **gjuhës së tregtisë** dhe mbi **gjuhën shkencore informatike**. Kurset synojnë përvetësimin e anglishtes **ekonomiko-tregtare, të marketingut**.

<sup>42</sup> Vigner G, Martin A. *Le Francais technique*, Belc/Hachette/Laurosse, Paris. 1976

<sup>43</sup> Porcher L in *Etudes de Linguistique Appliquee*, nr 23.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

*Universiteti i Shkencave sociale* ka një institut gjuhësor që bashkëpunon me GERAS (Groupe d' études et de Recherche en Anglais de Spécialité'), i cili zhvillon studime mbi terminologjinë, mbi analizën e tekstit dhe mbi përdorimin e kompiuterit në lidhje me klasifikimin e **teksteve të së drejtës dhe të shkencave politike**. Kurset fokusohen në mësimdhënien e anglishtes **të së drejtës dhe të ekonomisë** dhe zhvillojnë aftësitë e leximit dhe të gjuhës së shkruar.

Edhe në **BELGJIKËN** frankofone, studimet terminologjike dhe leksikografike janë mjaft të zhvillura në kontekstin e gjuhëve për qëllime të veçanta, kryesisht në gjuhën e **ekonomisë, të së drejtës dhe të shkencave administrative**.

Në **VENDET E ULTA**, vërehet një interes i veçantë për mësimin e gjuhës së **ekonomisë, të tregtisë dhe të së drejtës**. Qendrat universitare dhe parauniversitare, të cilat organizojnë këto lloje kursesh kryejnë edhe kërkime mbi analizën e tekstit dhe mbi informatizimin e kërkimeve sasiore.

Në **GJERMANI**, një numër i madh institucionesh publike dhe private organizojnë dhe zhvillojnë kërkime mbi gjuhët e specialiteteve. Kurset mbi gjuhën shkencore dhe teknike janë të shumta, por nuk mungojnë edhe ato lidhur me komunikimin në **sektorët ekonomikë, të së drejtës e tregtisë**. Kërkimet lidhur me këto sektorë fokusohen në argumente të tilla si: terminologjia, analiza e tekstit, përkthimi, interpretariati, modele didaktike dhe pedagogjike për gjuhët për qëllime specifike.

Në **AUSTRI** zhvillohen kurse mbi **shkencat administrative, ekonomike, të së drejtës dhe të tregtisë** në gjuhën angleze, franceze, italiane, ruse, spanjolle dhe gjermane për studentë të huaj.

Në **SUEDI** zhvillohen kurse mbi gjuhën e specialitetit **të ekonomisë, të së drejtës dhe të shkencave administrative**, por mbizotërojnë ato mbi **gjuhët tekniko-shkencore**.

Në **ZVICËR** studiohen nevojat e përdorimit të gjuhës së huaj në lidhje me aktivitetin **tregtar dhe industrial**.

Në **DANIMARKË**, *Departamenti i Gjuhëve të Kopenhagenit, School of Economics* është mjaft aktiv në fushën e gjuhëve për qëllime të caktuara. Mbahen kurse të gjuhës angleze, frënge, gjermane, italiane, ruse dhe spanjolle në fushën **tregtare dhe të së drejtës**, por edhe në fusha të tjera **tekniko-shkencore**. Kryhen kërkime metodologjike mbi komunikimin profesional, mbi gjuhësinë e tekstit, mbi terminologjinë dhe leksikografinë, teorinë e përkthimit dhe stilistikës.

Në **FINLANDË**, institucionet finlandeze kryejnë studime mbi gjuhët e specialiteteve **të tregtisë, të shkencave politike, të ekonomisë dhe të së drejtës**. Kërkimi i referohet terminologjisë, analizave sasiore dhe të kompiuterizuara, sintaksës së gjuhëve të specialitetit, modeleve didaktike dhe komunikimit ndërkombëtar.

Në **POLONI**, Instituti i Gjuhësisë së Aplikuar të Universitetit të Varshavës, kryhen kërkime mbi frekuencat sintaksore të gjuhëve të specialitetit, sipas përjasjes së analizës sasiore, analizën e krahasuar të teksteve, ndërsa studimet mbi tekstet juridike nxjerrin në pah raportet mes formës dhe përmatjes. Kurset e Gjuhëve të specialitetit zhvillohen në

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

gjuhën frënge, angleze, gjermane, ruse, në **specialitetin e politikës, ekonomisë, të së drejtës**.

Në **HUNGARI** interesi për gjuhët e specialitetit është i madh dhe shfaqet përmes llojeve të ndryshme studimesh dhe kërkimesh: përmbledhje terminologjike në kompiuter, studime mbi përkthimin, modele didaktike. Në qendrat universitare ku këto gjuhë mësohen, janë të shumta kurset mbi **ligjërimin politik, mbi gjuhën ekonomike dhe tregtare** në gjuhë të ndryshme. Zhvillohen të katërta aftësitë, por prioritet ka leximi apo shkrimi në bazë të qëllimit specifik të kursit.

Në **IZRAEL** mësohet kryesisht anglishtja e specialitetit. Kurset mbi gjuhën e **ekonomisë, të së drejtës dhe të shkencave politike** përqëndrohen në aftësitë e leximit dhe kërkimet e kryera pranë *Qendrës për Kërkimin e Gjuhësisë së Aplikuar të Hebrew University të Jeruzalemit*, lidhen me aktet e ligjeratës së shkruar të gjuhëve të Specialitetit.

Edhe në **JORDANI**, anglishtja e **së drejtës** mësohet kryesisht përmes leximit. Në **KUWAIT** dhe në **ARABINË SAUDITE** studiohet analiza e tekstit, përgatiten modele didaktike për gjuhët e specialitetit dhe zhvillohen kërkime terminologjike. Kurset janë mbi gjuhën e **jurisprudencës, të administratës publike dhe të ekonomisë**.

Në **TAILAND, SINGAPOR, dhe FILIPINE** zhvillohen kurse të gjuhëve të specialitetit mbi **tregtinë, shkencat politike, dhe drejtësinë**. Aftësia e privileguar është leximi, por nuk anashkalohen edhe aftësitë e tjera. Leximi është i orientuar drejt ndërtimit të modeleve didaktike dhe materialeve të përshtatshëm për nevojën e studentëve dhe në përgatitjen profesionale të mësuesëve.

Në shumë vende **AFRIKANE**, gjuha e huaj (anglishtja apo frengjishtja) është veikolare, si për edukimin gjuhësor të përgjithshëm, ashtu edhe për atë specifik.

E mbyllim këtë udhëtim, me kontinentin e **AMERIKËS LATINE**, ku anglishtja apo frengjishtja e **ekonomisë dhe e së drejtës** mësohen në institucione apo universitete të ndryshme. Në Amerikën latine, operatorët didaktikë janë përpjekur të trajtojnë me prioritet mësimdhënien gjuhësore për mësimin e frengjishtes, si mjet për të pasur akses për një **informim shkencor, tekniko-profesional**. Për të mos qënë përsëritës, po evitojmë përmbledhjen e metodave dhe teknikave, por mund të përmendim *Institutin Superior Teknologjik të Huancayo (Peru)*, ku studimet mbi mësimdhënien-nxënien e gjuhëve të huaja të specialitetit kanë një përjasje sociolinguistike.

Në **SHQIPËRI**, gjuha e huaj e specialitetit është pjesë e kurrikulës universitare, në kontekstin universitar publik dhe jo publik. Edhe pse kjo praktikë mësimdhënieje ka vite që ka filluar të zhvillohet, përsëri problematikat e saj mbeten ende komplekse, duke qënë e vështirë vendosja e një kufiri mes mësimin të gjuhës së huaj me karakter të përgjithshëm dhe atij sektorial. Edhe pse studimi i gjuhëve të specialitetit është në fillimit e tij, nuk mungon tradita e përkthimit të literaturës shkencore profesionale.

Ky udhëtim historiko-geografik, në botën e Gjuhëve të Specialitetit, ofron paraprakisht njohuri dhe informacione për cilindo, studiues apo kërkues shkencor duke dhënë specifika për çdo vend.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## III.2. Problematikat që verifikohen gjatë procesit të mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit

Në këtë çështje synohet të jepet një panoramë e problematikave lidhur me mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhëve të huaja të specialitetit, një fushë kjo studimi dhe realizimesh didaktike, të përhapura, sikurse trajtuar edhe më lart, në vende të ndryshme, por edhe në Shqipëri, duke sjellë propozime dhe sugjerime specifike, të përshtatshme me kontekstin shqiptar të mësimdhënies.

Janë kryer shumë studime në këtë fushë të glotodidaktikës, si nga pikëpamja teorike, ashtu edhe nga orientimet e ndjekura në prodhimin e materialeve didaktike apo të lidhura ngushtësisht me ‘analizën e nevojave’. Gjithësesi kjo lloj mësimdhënie, paraqet problematika dhe vështirësi.

Le të fillojmë me zgjedhjen e momentit **kur duhet të fillojë kursi i gjuhës së huaj të specialitetit**, pra nëse ai duhet të presupozojë një kompetencë të mëparshme të karakterit disiplinor, e fituar nga nxënësi përmes disiplinës të specialitetit në gjuhën shqipe, apo nëse ty dyja kurset e formimit (ai gjuhësor dhe ai disiplinor), mund të zhvillohen paralelisht, me përvetësimin gradual të të dy njohurive.

Mendojmë, në lidhje me këtë tezë të debatuar, se gjuha e huaj e specialitetit duhet të paraprihet nga njohuritë bazë të lëndës së specialitetit. Kjo i vjen në ndihmë nxënësit, i cili pasi njih konceptet themelore të disiplinës, e ka më të lehtë për t’i kuptuar e për t’i përdorur në gjuhë të huaj, por edhe mësuesit në kontekstin e didaktikës bashkëpunuese, për të cilën do flasim në çështjen në vijim.

Një diskutim i ngjashëm është zhvilluar edhe në lidhje me **nivelin e njohjes së gjuhës së huaj**. Pra, nëse nxënësit duhet të kenë marrë një kompetencë – edhe fillestare (niveli A1-A2) – në gjuhën e huaj bazë, para se të fillojë mësimin e gjuhës së huaj të specialitetit, apo nëse mund t’i përvetësojnë strukturat bazë të gjuhës së zakonshme së bashku me veçoritë e ndryshme të gjuhës së specialitetit, objekt i studimit.

Duke sjellë përvojën vetjake në këtë drejtim, mbështesim tezën e parë, pra që studentët duhet të kenë përfunduar nivelin A1 dhe A2 (40 orë për secilin modul), për të fituar kompetencat gjuhësore, por kryesisht gramatikore bazë, dhe pas kësaj, të zhvillojnë gjuhën e huaj të specialitetit. Kjo ndihmon komunikimin, i cili nuk mund të jetë thjesht një bashkësi fjalësh, por të lidhura mes tyre nga rregulla të caktuara morfo-sintaksore. Edhe rezultatet e pyetësorit, drejtuar pedagogëve të gjuhës së huaj të specialitetit bashkangjitur këtij punimi, (Pyetja 8 e shtojcës nr. 2) ‘*Në cilin nivel gjuhësor janë studentët të cilët nisin për herë të parë mësimin e gjuhës së huaj të specialitetit?*’ japin të njëjtin vlerësim.

**Së treti** kriteret lidhur me **përzgjedhjen e materialeve didaktike** kanë grupuar mendime të ndryshme: përdorimi i materialeve **autentike** versus përdorimit të materialeve **të përshtatura**, pra të ndërhuara posaçërisht. Të parët kanë avantazhin të jenë

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

më përfaqësuese, por paraqesin edhe vështirësi të dukshme nga pikëpamja gjuhësore dhe konceptuale; të dytët janë gjykuar si më të thjeshtë dhe të aftë të japin avantazhe të llojit pedagogjik. Të dyja rastet mbartin problemin sesi studenti mund t'i përballojë ato, ndërsa njohuritë e tij nuk janë zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme. Për të tejkaluar këtë *empasse*, propozohet nga njëra anë një përjasje nga e përgjithshmja tek e veçanta, ç'ka i lejon studentit të perceptojë fillimisht kuptimin e përgjithshëm, duke u bazuar tek indiciet gjuhësore dhe ikonike dhe mbi njohuri tashmë të zotëruara, për të vazhduar në një moment të dytë, në kuptimin e elementëve specifikë. Nga ana tjetër, propozohet edhe një hyrje propedeutike e elementëve të veçantë leksikorë, sintaksore, tekstualë, të pranishme në tekst e të njohura si pika të vështira. Mund të zbatohet në këtë rast një përjasje nga e veçanta tek e përgjithshmja dhe një afrim gradual me tekstin.

Autenticiteti dhe thjeshtësia përbëjnë një ndër temat më të debatuar në prodhimin e materialeve didaktikë, të përdorura për mësimdhënien e gjuhëve të specialitetit.

Çfarë kuptohet me autenticitet? Mountford<sup>44</sup> bën dallimin mes përshtatjes së tekstit dhe krijimit *ex novo*, duke mbrojtur tezën se një tekst i përshtatur, pasi dekontekstualizohet humbet autenticitetin e vet. Ndërsa tekstet e krijuara *ex novo* përfaqësojnë një komunikim të vërtetë.

Përveç dallimit mes teksit autentik dhe tekstit të krijuar *ex novo*, nga pikëpamja e autorëve ose të mësuesit i cili e përshtat atë, duhet të pyesim sesi nxënësi e sheh këtë dallim. Disa studiues mendojnë se nxënësi nuk është në gjendje të përballojë një tekst autentik dhe ai duhet udhëhequr gradualisht, edhe duke e thjeshtuar tekstin. Por ndodh që gjatë thjeshtëzimit, teksti humbet tiparet thelbësore për dy arsye:

*në radhë të parë*, teksti humbet autenticitetin e tij në momentin e zgjedhjes nga ana e mësuesit apo të autorit të materialit, i cili e parapëlqen kundrejt të tjerëve, pasi është më sqaurues për një element të caktuar, që ai kërkon të shprehë apo sepse konsiderohet më i thjeshtë dhe interesant;

*në radhë të dytë*, teksti humbet autenticitetin e vet për të njëjtin qëllim për të cilin ai është inkorporuar në një program mësimdhënieje. I shkëputur nga konteksti natyror, teksti humbet autenticitetin e qëllimit. Për shembull, në një kurs inxhinierie, një pjesë e tekstit, e lexuar në një moment të caktuar, ka një kuptim të tijin, të saktë në sekuencën ku përdoret kundrejt veprimtarive të tjera didaktike dhe rezulton pak a shumë i kuptueshëm në funksion të njohurive të marra nga nxënësi më parë, apo në funksion të njohurive që nxënësi duhet të mësojë. Për këto arsye, është e rëndësishme që një program gjuhësor të tentojë të riprodhojë kushtet e kuptimit 'real'.

Në lidhje me sa më lart, mendojmë se tekstet e gjuhëve të specialitetit duhet të hartohen dhe të përshtaten sipas nevojave reale të nxënësve. Ato duhet të jenë të thjeshta, të sjellin situata të ndryshme, të cilat nxisin komunikimin dhe krahas përmbajtjes së specializuar duhet të sjellin elementë të kulturës së vendit në gjuhën e së cilit zhvillohet lënda. Kjo do të ndikonte mjaftueshëm në forcimin e kompetencës së komunikimit ndërkulturor.

---

<sup>44</sup> Mountford, *English for Academic Purposes*. British Council, Londra, 1980

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Edhe **niveli i specialitetit të materialeve didaktikë** të përdorur ka qënë dhe mbetet objekt debati në fushën e didaktikës: në disa raste është propozuar përdorimi i teksteve tepër të specializuara, në raste të tjera është synuar mbi seleksionimin e materialeve të karakterit më pak sektorial dhe të ngjashëm me më shumë disiplina, duke pasur si qëllim në këtë mënyrë të jepet një përgatitje gjuhësore bazë, e vlefshme për t'u përdorur në fusha të ndryshme specialiteti.

Në lidhje me këtë pikë, mendojmë se materialet didaktikë, të përdorura në mësimin e gjuhëve të huaja të specialitetit, duhet të karakterizohen nga thjeshtësia dhe të evitojnë mbingarkesën me terma apo tekste, ç'ka do të ndikonte negativisht te nxënësit në përvetësimin, kryesisht leksikor. Ato duhet të jenë të pasura me fotografi apo imazhe, të cilat ndihmojnë në kuptimin dhe kuptimin më të plotë të një teksti në gjuhë të huaj specialiteti. Materialet e përdorura gjatë mësimin duhet të jenë të tilla që të formojnë një *continuum* informacionesh, në mënyrë që tekstet e mëvonshme të presupozojnë njohjen e koncepteve të paraqitura në materialet e shqyrtuara më parë.

Vitet e fundit ka marrë një rëndësi të veçantë **niveli i autonomisë të nxënësve**. Në përgjithësi, ata janë të motivuar dhe kanë pjekuri të mjaftueshme për të përballuar aktivitete të ndryshme didaktike në mënyrë të pavarur. Në këtë rast, duke shfrytëzuar këtë mundësi, mësuesi duhet të vendosi theksin në përgatitjen e materialeve dhe skedave të autokorrigjimit dhe koordinimin e tyre.

**Vlerësimi** është një ndër etapat që karakterizojnë metodologjinë e mësimdhënies në gjuhë të huaja specialiteti. Procesi i vlerësimit përfshin në përgjithësi dy momente të ndara, por mes tyre të ndërlidhura: momenti i parë i vëzhgimit dhe ai i matjes së rezultateve të nxënësit, që japin të dhëna të karakterit objektiv (psh. regjistrimi i përgjigjeve të dhëna në një pyetësor përmes parametrave të caktuar, përllogaritja e fjalëve të vendosura saktësisht në një *cloze test* apo të përgjigjeve të sakta në një ushtrim me zgjedhje të shumëfishta etj dhe momenti i dytë, pauses i vlerësimit. Këtu lind nevoja nga ana e mësuesit (ose e vlerësuesit) që të përcaktojë në cilin nivel një rezultat i caktuar duhet gjykuar i pranueshëm apo jo, dhe të caktojë një shkallëzim të notës së pranueshmërisë apo papranueshmërisë.

Në procesin e testimit dhe vlerësimit, një aspekt i debatur dhe delikat, është ai që lidhet me një ekuilibër të drejtë në hartimin e tezave të provimit përfundimtar: pra ekuilibri mes aspektit gjuhësor dhe atij disiplinor apo të përmbajtjes. Bashkohemi me mendimin e sjellë në pyetësin përkatës (pika 10), se njohuritë disiplinore të zotëruara nga nxënësit nuk duhet të kenë peshë të rëndësishme në vlerësimin e testit kundrejt atyre gjuhësore. Kështu gjatë vlerësimit duhet të gjykohet mbi nivelin e përdorimit të termave në gjuhë specialiteti, saktësinë e përdorimit të tyre në kontekste komunikuese, përdorimin e saktë gramatikor në funksion të komunikimit dhe përvetësimin e gjuhës së shkruar.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## III.3. Mësuesi i gjuhëve të specialitetit, gjuhëtar apo specialist i fushës?

Në radhë të parë është e rëndësishme të sqarojmë figurën e mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit: pra nëse ai duhet të jetë një ekspert i lëndës së specialitetit – e të nisë kështu një mësimdhënie më ‘teknike’ dhe, nga pikëpamja shkencore më të vlefshme, apo nëse duhet të jetë një mësues i gjuhës së huaj, me një përgatitje të lartë në çështjet e karakterit gjuhësor dhe metodologjik. Në këtë rast të fundit, shtrohet shpesh pyetja nëse mësuesi i gjuhës së huaj duhet të ketë një përgatitje efektive në fushën e specialitetit, pra nëse atij duhet t’i kërkohet një kompetencë më e gjërë në fushën e studiuar, apo një kompetencë e kufizuar në koncepte të trajtuara në tekstet e paraqitura në klasë. Le të arsyetojmë në lidhje me këtë çështje...

Marrja e bagazhit minimal të informacioneve disiplinare, kërkuar për të mësuar në mënyrën e duhur një gjuhë specialiteti, nuk është një proces i pamundur dhe as tepër i vështirë. Njohja e disiplinës së studiuar është pikënisje për një shqyrtim më të thellë të materialeve ekzistuese dhe i lejon mësuesit një përzgjedhje më efikase të pjesëve që do të paraqiten apo analizohen në klasë, duke ndërhyrë me kompetencë e në mënyrën e duhur në analizimin e koncepteve. Realiteti i mësimdhënies ka sjellë shembuj të shumë mësuesëve, të cilët para domosdoshmërisë për të përvetësuar një gjuhë specialiteti, kanë arritur të fitojnë një zotërim të koncepteve përkatëse edhe brenda një periudhe kohore të shkurtër, nëpërmjet kërkimeve, leximeve personale apo kurseve të përditësimit për këtë qëllim. Njohuritë e tyre nuk kanë mbetur statike, por janë pasuruar me kohë gjatë mësimdhënies.

Çështja e raportit të mësuesit të gjuhës së huaj me disiplinën referuese është mjaft komplekse. Ferguson<sup>45</sup> sintetizon një model duke dalluar mes njohurive specifike të lëndës dhe njohjes së specializuar dhe më saktësisht:

- ❖ Njohje të vlerave dhe kulturave në fushën sociologjike ose antropologjike;
- ❖ Njohje të bazave epistemologjike të disiplinave, e cila mund të konsiderohet si njohje e natyrës filozofike;
- ❖ Njohje të diskursit shkencor dhe tipologjive, e lidhur me karakterin gjuhësor.

Mendojmë se një mësues i mirë i gjuhëve të specialitetit duhet të ketë njohuri, të paktën të përgjithshme të koncepteve kryesore të disiplinës. Ai duhet t’i përqaset tekstit të specializuar, duke u ndalur tek nivelet e ndryshme të komunikimit në gjuhën e specialitetit, nga ai i përmbajtjes në atë leksikor, nga ai morfo-sintaksor në atë tekstual. Duke u orientuar nga propozimet teorike dhe praktike të autorëve të teksteve ai duhet të përcaktojë saktësisht qëllimet pragmatike. Ky lloj qëndrimi është thelbësor, nëse duhet që mësuesi, nga ana e tij t’i ofrojë nxënësit përqasjen e duhur ndaj tekstit.

Mësuesi i një gjuhe specialiteti mund të jetë pra i diplomuar në gjuhë të huaj, me njohuri në një sektor të caktuar ose një specialist në një disiplinë të caktuar, me njohuri gjuhësore dhe didaktike.

E shprehur në terma matematikore paraqesim formulën e mëposhtme<sup>46</sup>:

<sup>45</sup> Ferguson G, *Teacher education and LSP*, fq 85.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## AS + GJ2 + GJHS + MDGJH + MDMGJH

ku shenja (+) tregon praninë e kompetencave të ndryshme, **AS** shpreh një *“argument specifik”*, **GJ2** shpreh *‘Njohuri për gjuhën e studiuar’*, **GJHS** për të treguar *‘Njohuri të gjuhës së huaj të specialitetit’*, **MDGJ** për të treguar një *‘përgatitje dhe përditësim në metodologjinë didaktike të gjuhëve të huaja’*, **MDMGJHS** për të shprehur *‘Përgatitje dhe përditësim në metodologjinë didaktike të gjuhëve të huaja të specialitetit’*.

Sigurisht ideale do të ishte që një figurë e tillë t’i përfshinte të dyja kompetencat, pra një mësues i diplomuar në gjuhë të huaj dhe në një disiplinë specialiteti, por kjo nuk është gjithmonë e mundur, edhe pse vitet e fundit regjistrohet një rritje e numrit të të diplomuarëve në më shumë se një fakultet. Zgjedhja me e pranueshme, mendojmë se do të ishte një mësues i diplomuar në gjuhë të huaj, me kompetenca të cilat për shkak edhe të një eksperience dhe pjekurie didaktike në këtë drejtim do të jenë më të konsolidura.

Në kontekstin shqiptar të mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit, të gjithë mësuesit janë të diplomuar në gjuhë të huaj. Kjo rezulton edhe nga pika e dytë e pyetësorit (Shtojca 2, bashkangjitur këtij punimi).

Në këtë kuptim, mësuesi i gjuhës së huaj, duke mos iu kërkuar të ketë një njohje tërësore të lëndës, nuk duhet të ndihet keq nëse nuk do të jetë në gjendje t’i përgjigjet pyetjeve të nxënësve mbi një detaj të caktuar të natyrës së specialitetit. Përkundrazi, me përgatitjen e tij metodologjike dhe eksperiencën e mësimdhënies, do të dijë të transformojë këtë situatë në një aktivitet didaktik të karakterit komunikues, ku nxënësit do të nxiten të gjejnë përgjigje për pyetjet e tyre, përmes analizës së teksteve dhe shkëmbimit të informacionit në gjuhë të huaj.

Nga analiza e përjasjes metodologjike të përvijëzuar më lart, del në pah një figurë e re e mësuesit të gjuhës së huaj, i cili shkëputet nga funksioni tradicional i dhënies së njohurive duke marrë edhe funksionin e nxënies së motivuar, për të mësuar nga nxënësit dhe së bashku me ta, kuptimin e koncepteve të ndryshme specifike dhe funksionimin e procedurave teknike, të cilat zakonisht përdoren në disiplinën e specialitetit. Marrja e këtij roli të ri, nuk sjell për mësuesin një reduktim të figurës tipike të profesionit të tij, pra atë të ekspertit të mësimin të gjuhës së huaj. Përkundrazi, kjo situatë ndikon në forcimin e komunikimit didaktik mësues-nxënës. Merr në këtë mënyrë jetë ajo që quhet didaktika bashkëpunuese.

### III.3.1. Roli dhe kompetencat e mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit

Figura e mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit përbën shtyllen ku bazohet glotodidaktika e gjuhëve të huaja të specialitetit. Roli i tij është më delikat, nëse e

---

<sup>46</sup> Balboni P. *Il professore di microlingue*, fq. 320-325.



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

krahasojmë me atë të mësuesit të gjuhës së huaj. Ky i fundi i referohet kurrikulave standarde dhe zotëron instrumenta të mjaftueshëm (manualë, ushtrime, software, përmbledhje dokumentash autentike të didaktizuara, etj).

Kur përballet me mësimdhënien e një gjuhe të huaj specialiteti, mësuesi ndeshet kryesisht me pesë lloje problemesh të karakterit<sup>47</sup>:

1. **Psikologjik**, të përcaktuara nga vështirësia për të mësuar një gjuhë të veçantë dhe për të trajtuar argumente specifike, jo gjuhësorë, për të cilat nuk ndihet i përgatitur mjaftueshëm;
2. **Konceptual**, që burojnë nga vështirësia për të kuptuar koncepte të teksteve që do të paraqiten në klasë;
3. **Gjuhësor**, përcaktuar nga leksiku i specializuar, i cili duhet të shpjegohet gjatë kursit;
4. **Metodologjik**, për të realizuar përshtatjen e teknikave glotodidaktike përgjithësisht të përdorura për mësimdhënien e gjuhës së huaj të zakonshme me didaktikën e gjuhëve të specialitetit.
5. **Organizues**, lindur nga kërkesa për të përgatitur një program, i cili synon kryesisht nevojat e komunikimit në klasë dhe nevojat e ardhshme të nxënësve.

Nga këndvështrimi personal, do të veçoja si më kryesore, vështirësitë e llojit të dytë dhe të pestë (pra ato konceptuale dhe organizuese), pasi i konsideroj si shumë të rëndësishme edhe në mbështetje të pikës së parë (vështirësi të natyrës psikologjike), por edhe në lidhje më aspektin gjuhësor apo metodologjik (pika 3, 4).

Vështirësitë e mësipërme, në fakt kthehen në pika të forta, të cilat inkurajojnë mësimdhënien dhe i japin figurës së mësuesit një rol të ri, multidimensional me kompetenca të cilat për shkak edhe të një eksperience dhe pjekurie didaktike në këtë drejtim do të jenë më të konsolidura, ku theksi vendoset në krijimin e situatave të një komunikimit real, bazuar mbi shkëmbimin e informacioneve dhe të opinionëve midis tyre dhe nxënësve.

Cuencia<sup>48</sup> përmbledh rolet që duhet të marrë një mësues në organizimin dhe në zhvillimin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit.

---

<sup>47</sup> Ewer, J.R. Teacher training for EST: problems and methods, EST?ESP Chile newsletter, Special Issue, 1, fq. 9-31, 1979

<sup>48</sup> Quencia, cituar në **Balboni P.E.** *Le microlingue scientifico-professionali, Natura e insegnamento*, UTET Libreria Srl, Torino 2004. Fq. 16

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

### 1. Roli eksplorues



### 2. Roli lehtësues



### 3. Roli motivues



### 4. Roli këshillues, konsultues



### 5. Roli bashkëpunues



### 6. Roli koordinues

Roli i parë është ai ‘*i eksplorimit*’, në kuptimin që mësuesi duhet të zbulojë fushat e ndryshme të disiplinës specifike për t’u njohur me tematikat, kompleksitetin dhe veçoritë e tyre, duke zgjedhur si rrjedhojë ato argumenta dhe ato materiale që vlerësohen si më të mira e më të përshtatshme për mësim.

Në një moment të dytë, roli i tij është ai i lehtësuesit, pra i atij, i cili zotëron dhe përgatit materiale ndihmëse dhe veprimtari didaktike, të përshtatshme për të thjeshtuar punën e nxënësve në kuptimin e teksteve të përzgjedhura.

Së treti, ai ka rolin e shpjegimit dhe dekodifikimit të këtyre teksteve, në kontekstin e një sërë veprimtarish didaktike, të cilat sjellin tek nxënësit motivim në procesin e analizës dhe diskutimit të përmbajtjes, formës së tyre gjuhësore, rol i cili përcakton edhe funksionin këshillues të nxënësit dhe të koordinatorit të veprimtarive didaktike, pa u shkëputur nga roli i tij tradicional, ai i vëzhgimit dhe i vlerësimit të studentëve.

Shumatorja e këtyre roleve, nënvizon bashkimin e eksperiencave që lidh në këtë lloj mësimdhënieje mësuesin me nxënësin, pasi, sikurse e shpjeguam edhe më lart, gjatë procesit mësimor, mësuesi i gjuhës së huaj vihet në mënyrë të vazhdueshme në kontakt me koncepte dhe teknika specifike.

Të gjitha rolet e mësipërme, janë të rëndësishme dhe plotësojnë njëri-tjetrin, por, për shkak të specifikës së mësimdhënies së gjuhës së huaj të specialitetit mendojmë se roli bashkëpunues është çelësi i suksesit.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Këtë mendim e japim, duke u mbështetur edhe tek përgjigjet e sjella në pyetësorin bashkangjitur, këtij punimi (Shtojca nr. 2) dhe konkretisht pyetjes nr.7 *‘Cili nga rolet e mëposhtme mendoni se është më i rëndësishëm për mësuesin gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj të specialitetit? a) Roli eksplorues, b) motivues, d) Roli këshillues, f) Roli bashkëpunues, g) Roli koordinues, për të cilën 70% e të anketuarëve janë përgjigjur se roli më i rëndësishëm është rolin bashkëpunues.*

Për të kryer sa më mirë rolet e tij, mësuesi i gjuhës së specialitetit duhet të përvetësojë kompetencat e tij, të cilat i kemi përmbledhur në listën e mëposhtme:

- a. Të njohë dhe të analizojë një gjuhë specialiteti;
- b. Të krijojë një korpus tekstual mbi të cilin të zhvillojë analizën, të përditësojë rezultatet e mëparshme, të krijojë një kurrikul;
- c. Të zbatojë një didaktikë bashkëvepruese;
- d. Të ndjekë ndryshimet e botës shkencore-profesionale, si në rrafshin epistemologjik, ashtu edhe në atë kulturor;
- e. Të lexojë libra apo revista në gjuhën përkatëse të specialitetit;
- f. Të studiojë komunikimin shkencor e profesional sipas modeleve të analizës;
- g. Të kuptojë ndryshimet e shpejta në stilet mikrogjuhësore, prodhuar nga globalizimi i mjeteve të komunikimit (interneti, mediat e shkruara apo vizive, bisedat radiofonike, komunikimi on-line me pedagogë të huaj).
- h. Të kryejë *analizën e nevojave* produktive dhe të besueshme, ku të përfshihen, jo vetëm aktet komunikuese, terminologjia, por edhe dimensionin e përdorimit ndërkulturor i gjuhëve të specialitetit.
- i. Të përdorë me efikasitet teknologjitë e reja, të cilat shërbejnë si burim për materiale mikrogjuhësore mbi të cilat drejtohet mësimdhënia apo integrohen materialet e disponueshëm, si dhe instrumenta glotodidaktike.
- j. Të bashkëpunojë në mënyrë konstante me kolegë dhe me specialistë të fushës

### **III.4 Ndërveprimi mësues-nxënës, një proces i rëndësishëm për mësimdhënien-mësimnxënien e gjuhëve të huaja të specialitetit**

Në mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhëve të huaja të specialitetit, një vend të rëndësishëm zë përqsja bashkëpunuese, e cila paraqet dy anë: bashkëpunimin mes mësuesit dhe nxënësit dhe bashkëpunimin mes vetë nxënësve. Pra, krijohet *një komunikim didaktik*, ku theksi vendoset në krijimin e situatave të një komunikimit real, bazuar mbi shkëmbimin e informacioneve dhe të opinionëve midis tyre dhe nxënësve. Ky komunikim didaktik sheh bashkëpunimin e dy ekspertëve: nxënësin, ekspert i disiplinës specifike dhe mësuesin, ekspert i gjuhës dhe i glotodidaktikës, një bashkëpunim i cili duhet të jetë i pranishëm në tërë procesin didaktik, që nga programimi deri në përfundim të tij.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Sikurse folëm në çështjen lidhur me figurën e mësuesit të gjuhëve të specialitetit, një ndër pengesat dhe vështirësitë me të cilat ai ndeshet më shpesh, lidhet me nivelin e njohurive mbi një disiplinë të caktuar. Është një shqetësim i justifikuar, nëse vendoset në perspektivën e një mësimdhënieje mono-drejtuese, ku ka vetëm një komponent të situatës didaktike, mësuesi, i cili ‘di’ dhe duhet të transmetojë dijen e tij një klase, të përbërë nga nxënës që ‘nuk dinë’. Një situatë e tillë ka qenë objekt i kritikave të vazhdueshme përgjatë shekullit të kaluar, ku mësimdhënien e njëjës si një ‘*problem solving*’. Modeli “*mësuesi mëson - ç’ka di një nxënës që nuk di*” përshtatet me përditshmërinë e mësimdhënies në klasë, por nuk mund të zbatohet në mësimdhënien e gjuhëve të huaja të specialitetit. Mendojmë kështu për të paktën tre arsye:

1. Mësimdhënien e gjuhëve të huaja të specialitetit, për nga vetë natyra, konsiderohet si etero-referenciale: qëllimet, objektivat, metodat dhe materialet nuk gjenden ekskluzivisht në shkollë, por duhet domosdoshmërisht që kurrikulat të përpunohen në raport me botën jashtë shkollës, pra aty ku gjuhët e specialitetit përdoren, jetojnë, zhvillohen çdo ditë;
2. Mësuesi nuk e njeh dhe as nuk e kupton thellësisht përmbajtjen e disiplinës së specialitetit. Modeli *mësuesi i mëson ato që di një nxënës që nuk i di* është i pavërtetë, në pjesën e parë, pasi mësuesi mund të njohë argumentet e gjuhës së specialitetit në mënyrë sipërfaqësore.
3. Mësimdhënien e gjuhëve të huaja të specialitetit, i drejtohet nxënësve, të cilët e njohin në mënyrë të kufizuar varietetin e përditshëm të gjuhës së huaj, por që njohin mirë argumentet specifike të disiplinës: Modeli ‘*mësuesi mëson ato që di një nxënës që di*’, është i pavërtetë në pjesën e dytë.

Duke marrë në konsideratë këto pohime, e duke iu larguar modelit të didaktikës tradicionale, qartësohet më mirë modeli i didaktikës bashkëpunuese.

Sipas këtij modeli, në mësimdhënien e gjuhëve të huaja të specialitetit, akti didaktik i sheh të dy subjektet: nxënës – mësues, në një pozicion më një dinjitet të barabartë, me përgjegjësi të barabara, me detyra dhe kompetenca që plotësojnë njëra-tjetrën. Dhe, nëse është e vërtetë se asnjë mësues nuk mund të jetë i detyruar të njohë gjuhët e ndryshme të specialitetit, në të cilat angazhohet në mësimdhënie, është po aq e vërtetë se asnjë mësues nuk mund të lërë pas dore metodologjinë e analizës gjuhësore dhe glotodidaktikën.

Nga ana tjetër, duhet verifikuar hipoteza nëse njohuritë e disiplinës së specialitetit të mësuesit duhet të jenë në përpjestim të drejtë me nivelin e përgatitjes së nxënësve në fushën e specialitetit. Kjo, pasi nxënësit, të cilët u nënshtrohen mësimin të një gjuhe specialiteti, mund t’i përkasin dy kategorive:

1. Disa ndjekin një modul, në një gjuhë të caktuar specialiteti, pa zotëruar kompetencat kryesore konceptuale të disiplinës së specialitetit.
2. Të tjerë, zotërojnë njohuri të mjaftueshme të argumentit disiplinor dhe ndjekin modulën, me qëllimin kryesor që të fitojnë apo të përmisojnë kompetencën e tyre në gjuhë të huaj.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Në rastin e parë, nënkuptohet që mësuesi duhet të ketë njohuri të argumentit ose të paktën të koncepteve të pranishme në tekst. Edhe nëse njohuritë e mësuesit për çështjet specifike të disiplinës mund të jenë fillestare, ai do të gjendej në një pozicion më të mirë kundrejt pozicionit të nxënësve, pasi zotëron kompetenca gjuhësore dhe aftësi të leximit dhe të dëgjimit, që i lejojnë të deduktojnë konceptet, ende të panjohura nga tekstet që do të analizohen. Përgjithësisht, tekstet e përdorura në gjuhët e huaja të specialitetit, janë konceptuar në mënyrë që t'i vijnë në ndihmë mësuesit të gjuhës së huaj, i cili nuk është specialist i fushës, përmes figurave, diagrameve, perifrazimeve, shpjegimeve dhe shembujve.

Një zgjidhje tjetër pedagogjike që propozojmë është dhe kjo që vijon. Në një orë mësimi, nxënësi mund t'i kërkojë mësuesit për t'i shpjeguar një koncept të caktuar. Në këtë rast, mësuesi mund ta drejtojë pyetjen tek nxënësit e tjerë, të cilët do të përpiqen të japin informacionin e kërkuar në gjuhë të huaj. Në rast se jepen dy apo tri versione të ndryshme, mësuesi mund të shfrytëzojë këtë situatë në drejtimin pedagogjik, duke nxitur një diskutim në gjuhë të huaj, apo duke i dhënë klasës një tekst për ta lexuar me shpjegimin e kërkuar.

Nëpërmjet teknikave të këtij lloji, mësuesi ndikon në ndërveprimin, jo vetëm mes tij dhe nxënësve, por edhe mes vetë nxënësve, apo mes tyre dhe tekstit, duke rritur motivimin dhe pjesëmarrjen dhe në të njëjtën kohë duke zgjeruar njohuritë e tij në lëndën e specialitetit.

Është e rëndësishme që të dy aktorët e veprimit didaktik (mësuesi dhe nxënësi) të veprojnë në mënyrë aktive, të bashkuar nga shkëmbimi i mesazheve komunikuese, në një proces ndërveprues, në të cilin kthimi i informacioneve nga nxënësi tek mësuesi nuk duhet domosdoshmërisht të interpretohet si dobësi e mësuesit, por si një pasurim i njohurive, ku edhe mësuesi vendoset në rolin e një nxënësi të mundshëm.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj është pra një aktivitet pedagogjik dhe didaktik i cili përfshin mësuesin në mënyrë totale, me qëllim që të arrihet një ekuilibër mes faktorëve të tillë si: motivimi i nxënësit, raporti mes mësuesit dhe nxënësit, interesi i argumenteve dhe i veprimtarive didaktike, metodat e mësimdhënies. Ai duhet të hyjë në komunikim më botën e tij të brendshme, të kuptojë prirjet dhe ndjeshmërinë, derisa mësimi i gjuhës së huaj të specialitetit të kthehet në një përgjigje ndaj një nevoje, jo thjesht njohëse, por edhe socio-afektive. Në këtë mënyrë, plotësohen si nevojat e mësuesit edhe ato të nxënësit, me një përgjigje konkrete, ku pasqyrohet nocioni diktonomik mësimdhënie-mësimnxënie, në të cilën integrohet procesi edukativ.

Ndryshe nga modeli kanonik i zbatuar për mësimdhënien-mësimnxënien e gjuhës së zakonshme, ku raporti midis mësuesit (*që e njeh gjuhën*) dhe nxënësit (*që duhet ta mësojë*) është asimetrik, në didaktikën e gjuhëve të huaja të specialitetit, perspektiva dhe raporti ndryshojnë. Raporti nuk është më asimetrik, por i bilanciuar, plotësues e bashkëpunues. Kjo ndarje rolesh shtynjë si mësuesin, ashtu edhe nxënësin drejt formave të asaj që quhet didaktikë bashkëpunuese.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

### III.5. Analiza e nevojave gjuhësore, pikënisje e kurrikulës së gjuhëve të huaja të specialitetit

Analiza e nevojave gjuhësore, qëndron në bazë të kurrikulës së gjuhëve të huaja të specialitetit. Krahas programit, përcaktohen edhe qëllimet formative dhe glotodidaktike, objektivat gjuhësorë, komunikativë dhe ndërkulturorë, si dhe teknikat që duhen përdorur për arritjen e tyre.

Analiza e nevojave, si një fushë e re kërkimore, ka lindur në kuadrin e kërkimeve të mbështetura nga Këshilli i Europës. Në vitin 1971, nën siglën e *Commiète for Out of School Education and Cultural Development*, nisi një projekt i gjerë lidhur me mësimin e gjuhëve kryesore europiane<sup>49</sup>. Qëllimi i këtij projekti ishte prodhimi i instrumentave të nevojshëm për ndërtimin e një sistemi unitetesh të kapitalizueshëm (*Unit/credi system*), i nënkuptuar si një kuadër referimi i përgjithshëm, i qendërsuar mbi nxënësin dhe i bazuar mbi nevojat, motivimet dhe prirjet e tij. Fusha të tjera kërkimore mbulonin përpunimin e kriterëve të reja të seleksionimit të materialit gjuhësor, si dhe përcaktimin e niveleve të gjuhës.

Nevojat gjuhësore mund të jenë të dy llojeve. Nga njëra anë mund t'i referohen kërkesave të një grupi shoqëror ose profesional, apo një popullate të tërë, për të njohur një gjuhë të caktuar. Nga ana tjetër, mund të tregojnë atë ç'ka i mungon një individ për të përballuar, përmes gjuhës, një situatë komunikimi. Pas këtij dallimi të parë, Richterich,<sup>50</sup> përcakton dy kategori të nevojave:

- a) **nevojat objektive**, të cilat mund të përcaktohen, duke analizuar përmbajtjet gjuhësore, tipike të situatave të jetës profesionale, sociale dhe private;
- b) **nevojat subjektive**, të cilat janë disi të vështira për t'u përcaktuar, pasi varen nga ndodhia e paparashikueshme, nga një situatë e cila nuk mund të prezantohet asnjëherë në të njëjtën mënyrë.

Për të përcaktuar nevojat gjuhësore Richterich propozon tri shkallë:

- ❖ **Shkalla e parashikimit**, e cila lejon të tregohet se në cilën masë nevojat mund të jenë të parashikuara.
- ❖ **Shkalla e analizës** që lejon të përcaktojë tre nivele:
  - *nevojat e përgjithshme*, të cilat rezultojnë nga një analizë empirike dhe intuitive e funksionimit dhe përdorimit të gjuhës në funksionin e saj të përgjithshëm të komunikimit;
  - *nevojat specifike* për një grup të caktuar personash, të cilat mund të zbulohen duke vërtetuar përdorimin e gjuhës në një situatë specifike;
  - *nevojat e veçanta*, të cilat korrespondojnë me zotërimin e një situatë komunikimi, jo përgjithësuere.

<sup>49</sup> Sistem Development in Adult Language Learning (1973).

<sup>50</sup> Richterich R. *Besoins Langagiers ed objectifs d'apprentissage* (1985)

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

❖ **Shkalla e përshtatshmërisë** e cila lejon të përcaktojë në ç'masë fakti i prodhimit të një fjalie gjatë procesit të nxënies përbën një akt komunikativ.

Mendojmë, se nga të tria shkallët e propozuara nga Richterich, kjo e fundit është më origjinalja dhe në linjë me një përjasje komunikuese të mësimdhënies, pasi nxjerr në pah nevojën që të korrispondojë sa më shumë akti i nxënies me një akt komunikues.

Modeli i zbatuar nga Richterich, i bazuar mbi analizën e akteve të komunikimit dhe të procesit të nxënies, për përcaktimin e nevojave gjuhësore objektive, nuk është thjesht një instrument për të mbledhur informacione të llojit statistikor, por ka edhe një vlerë pedagogjike të dukshme, pasi shërben për të përdorur teknika të përshtatshme për nxënësit.

Një ndër momentet thelbësore të punës së mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit është **analiza e nevojave gjuhësore**, një kërkesë me një rëndësi të madhe në përcaktimin e objektivave të nxënies gjuhësore. Nevojat lejojnë të përcaktohet qartësisht një hapësirë e veçantë studimi. Duke u nisur nga fakti se nxënësit nxiten të mësojnë një gjuhë të huaj për nevoja komunikimi mjaft të qarta, kjo analizë synon të përcaktojë këto nevoja specifike. Për të arritur këtë, duhet një punë e kujdeshme paraprake, për qartësimin e objektivave didaktikë, ndërtimin e programit dhe për zgjedhjen e strategjive pedagogjike.

Këtu mendoj se është i nevojshëm një saktësim. Mësimi i gjuhëve të huaja nis që në sistemin parauniversitar, ku qëllimi kryesor është, sikurse edhe në disiplina të tjera, dhënia e njohurive të përgjithshme të konsideruara si një bazë e domosdoshme për një formim të mëtijshëm, më të specializuar, ku nxënësit, teksa gjenden në një stad të ndërmjetëm formimi, e duke mos qenë ende në prag të futjes në tregun e punës, nuk kanë nevoja specifike; këto të fundit përcaktohen në momentin kur ata nisin mësimin e gjuhës së huaj të specialitetit, ku procesi i mësimdhënies modelohet sipas nevojave të nxënësve, ku prioritet ka përvetësimi i kompetencës komunikuese.

Mësimdhënia gjuhësore në funksion të rritjes së kompetencës komunikuese është bërë më e theksuar vitet e fundit, sidomos aty ku nevojat e nxënësve janë qartësisht të përcaktuara në një fushë të caktuar akademike. Përkufizimi i 'nevojës' duhet të jetë i një natyre reale dhe dinamike, pra nevojat komunikative nuk mund të jenë të izoluara nga ato operative. Studenti duhet të mësojë "*saper fare in lingua*" (pra të dijë të veprojë në gjuhë). Pasi përcaktohen qëllimet edukative dhe glotodidaktike, objektivat gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, nevojiten të planifikohen strategji dhe teknika didaktike efikase për realizimin e tyre.

Hutchinos T. dhe Waters A.<sup>51</sup> e nisin reflektimin e tyre mbi kurrikulën dhe analizën e nevojave gjuhësore në didaktikën e gjuhëve të specialitetit me një thënie të Karl Marksit "*Nga seicili sipas aftësive të tij, çdokujt sipas nevojave të tij*".

Në didaktikën e gjuhëve të huaja të specialitetit **analiza e nevojave** i referohet protagonistëve të procesit didaktik:

❖ nxënësit (studentit),

---

<sup>51</sup> Hutchinos T, Waters A. *English for specific purposes. A learner-centred approach*, Cambridge press, Cambridge 1987. Fq. 53

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- ❖ mësuesit,
- ❖ gjuhës së specialitetit.

- **Analiza e nevojave të nxënësit.**

Në të kaluarën, jo shumë të largët, nevojat e nxënësit përcaktoheshin ekskluzivisht nga mësuesi, pika e referimit të të cilit ishte programi, një tekst i shenjtë që përcaktonte gjithshka lidhur me procesin e mësimdhënies. Sigurisht që programi, përmbajtja e tij, kurrikula janë thelbësorë në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, por theksi duhet të vendoset më shumë mbi ndërtimin e programeve didaktikë, të individualizuar, në bazë të të cilit qëndron analiza e nevojës së nxënësit. Ai është një protagonist i padiskutueshëm i procesit mësimor, e për më shumë një protagonist modern dhe teknologjik, i aftë për të përdorur instrumenta informatikë në mënyrë efikase dhe të bashkëpunojë me përgjegjësi në procesin e formimit të tij. Për analizën e nevojave duhet të merren në konsideratë elementë lidhur me prirjet e tij, personalitetin, nevojat, pritshmëritë, metodat e nxënies, raportet psiko-shoqërore të pranishme në klasë, por edhe nevoja e të mësuarit si të mësohet, ç'ka rrit edhe pavarësinë gjatë rrugëtimit të nxënies.

Analiza e nevojave gjuhësore dhe e objektivave prioritarë të nxënësve kërkon të konsiderohet një situatë didaktike krejtësisht specifike, që nënkupton qartësisht nevojën e propozimeve të reja metodologjike. Në këto rrethana të reja, problemi i vjetër i motivimit spostohet në plan të dytë. Në fakt, këta nxënës e dinë me saktësi se çfarë duhet të mësojnë, sa kohë duhen t'i kushtojnë mësimin të gjuhës së specialitetit, dhe kompetencat që ata duhet të përvetësojnë. Në këtë mënyrë tipologjia e nxënies kërkon një përgjigje metodologjike të posaçme dhe zbatimin e strategjive të mësimdhënies të drejtëpërdrejta si dhe metodologji, në sintoni të plotë me objektivat që duhen arritur.

Për të kuptuar më mirë nevojat e nxënësve që studiojnë një gjuhë të huaj specialiteti, i jemi referuar modelit teknik të analizës së nevojave, përpunuar nga Hutchinson dhe Waters<sup>52</sup> të cilët dallojnë:

- ❖ **Nevojat (Necessities)**: nevojat e përcaktuara nga kërkesat e kontekstit në të cilin do të veprohet;
- ❖ **Mungesat (Lacks)**: ajo që i mungon kompetencës fillestare të nxënësit për të plotësuar nevojat e tij;
- ❖ **Dëshirat (Wants)**: nevojat e perceptuara nga vetë nxënësi të indentifikuara edhe nga mësuesi.

Duke u nisur nga kjo analizë, nevojat e nxënësit nuk duhen parë si nevoja të botës abstrakte të së nesërme, por si nevoja të realitetit të secilit nxënës dhe perceptimit të tij për këtë realitet. Nuk është e mundur të organizojmë një kurrikul mbi analizën e nevojave të ardhshme të nxënësit, pa konsideruar nevojat e së tashmes, ato që janë të domosdoshme për përvetësimin gjuhësor. Nga ana tjetër, nevojat e nxënësve nuk janë të

---

<sup>52</sup> Hutchinson T. Waters A. *English for Specific Purpose A. Learner*, University Press, Cambridge, 1987 fq 55-60



## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

përhershme dhe të pandryshuara, por janë dinamike dhe kanë nevojë për një rishikim të vazhdueshëm. Një mënyrë për të plotësuar dhe për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve mund të jetë edhe shpërndarja e një pyetësoi lidhur me veprimtari didaktike, duke vëzhguar dhe veçuar ato që preferohen më shumë nga nxënësit, teknikat ushtrimore që ata i konsiderojnë më të nevojshme, metodologjitë që i konsiderojnë si më të vlefshme, sugjerime mbi vlerësimin e mësuesit e të tjera si këto.

### **• Nevojat e mësuesit**

Studimet e deritanishme janë përqëndruar kryesisht mbi nevojat e nxënësve, por sikurse e trajtuam më lart, gjatë analizës së figurës dhe rolit të mësuesit të gjuhës së huaj të specialitetit, duhen marrë në konsideratë edhe nevojat e vetë mësuesit. Ai nuk zotëron plotësisht njohjen specifike të disiplinës, e si rrjedhojë ka nevojë të punojë mbi bazën e një kurrikule që të tregojë edhe njohuritë shkencore-profesionale. Në perspektivën e një didaktike bashkëpunuese, trajtuar më lart, mësuesi ka nevojë të bashkëpunojë me nxënësit për të interpretuar dhe analizuar në detaje tekstin e specialitetit. Në radhë të parë, mësuesi duhet të mbledhë materiale të cilat zgjojnë interesin e nxënësve, duke përzgjedhur një liste argumentesh, lidhur me disiplina specifike dhe fusha të interesit.

Mësuesi nuk duhet të fitojë dijen shkencore, por duhet të jetë në gjendje të dallojë në testin shkencor, vlerën shkencore nga ajo pedagogjike. Nga pikëpamja didaktike kërkohen metodologji që të jenë në sintoni me objektivat që duhen arritur. Për këtë mendojmë se:

- së pari, nevojitet të evitohet mësimi i një gjuhë 'të përgjithshme', pra të programohet një mësimdhënie identike për të gjithë, pasi nuk ekziston një metodë universale që mund të vlejë për të gjithë.
- Së dyti, propozohet një mësimdhënie e individualizuar dhe respektim të ritmeve individuale të nxënies.

### **• Nevojat e gjuhëve të specialitetit**

Edhe pse nga pikëpamja semantike mund të duket e çuditshme të zbatojmë kategorinë e nevojës, në një objekt jo frymor, është fakt se një kurrikul nuk mund të mos llogarisë 'nevojat' e veta specifike, ato të gjuhës së specialitetit dhe të veçorive specifike të saj (të analizuar në kreun e dytë të këtij punimi). Çdo gjuhë specialiteti karakterizohet nga një leksik, nga një sintaksë e nga tipologji të ndryshme tekstuale. Vetë gjuha e specialitetit ka nevojë që këto kategori të futen në kurrikul dhe të kthehen në objektiva qartësisht të përcaktuara. Por cilat janë karakteristikat e një kurrikule të gjuhëve të specialitetit?

Sikurse e analizuam më lart, një kurrikul e gjuhës së specialitetit duhet të harmonizojë nevojat e nxënësit me ato të mësuesit dhe me nevojat e vetë gjuhës së specialitetit.

Në projektimin e një kurrikule në gjuhë të huaja të specialitetit, krahas analizë së nevojave, përcakohen edhe qëllimet edukative dhe qëllimet glotodidaktike, të cilat, të marra së bashku, janë të nevojshme për të ndihmuar qëllimin final: përvetësimin e kompetencës komunikuese në gjuhët e huaja të specialitetit dhe, meqënëse bëhet fjalë për

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

kontakte dhe raporte ndërkombëtare në gjuhë të huaja specialiteti, përvetësimin të kompetencës komunikuese i shtojmë edhe kompetencën ndërkulturore.

**Qëllimet glotodidaktike** prezantohen në çdo njësi didaktike. Ato janë:

- ❖ **Njohja e gjuhës së specialitetit:** përdorimi i aftësive parësore dhe të integruara për të kuptuar, përdorur e riprodhuar tekste mikrogjuhësore duke u ndihmuar nga veprimtari të tilla si: dialogu, monologu, përmbledhja, dëgjimi, leximi, komunikimi, perifraximi, marrja e shënimeve, përkthimi, interpretimi.

Sugjerojmë që veprimtaritë mbi leksikon *polisemantik* të zakonshëm t'i paraprijnë atyre të leksikut *monosemantik*, specifikisht sektorial. Në bazë të nevojave profesionale të ardhshme, mësuesi duhet të përzgjedhë afësitë më të rëndësishme për t'i integruar në një kurrikul.

- ❖ **Përdorimi i gjuhëve të specialitetit:** pra studentët duhet të zotërojnë aktet komunikuese (duke iu referuar terminologjisë së Këshillit të Europës: '*funksionet*' komunikuese), të nevojshme për të komunikuar në situata shkencore profesionale, por edhe socio-kulturore ku ato duhet të përdoren.

Ndryshe nga një kurrikul e zakonshme e gjuhëve, kurrikula e gjuhëve të huaja të specialitetit, kërkon të vendosë pranë akteve komunikuese, njësitë bazë të ndërveprimit, mjaft delikate në rrafshin e marrëdhënieve midis profesionistëve.

- ❖ **Njohja e gjuhës:** nxënësit duhet të njohin rregullat që shoqërojnë gjuhën, e veçanërisht veçoritë leksiko-morfo-sintaksore, aspektet jashtëgjuhësore si dhe veçoritë e tekstit, të trajtuara në Kreun e II-rë të këtij punimi. Sipas llojit të inputit të paraqitur këto aktivitete ndihmojnë në kupimin e tekstit.

Në përfundim mund të themi se projektimi i një kurrikule të gjuhëve të huaja të specialitetit duhet të hartohet mbi bazën e analizës së nevojave të nxënësve, të mësuesëve, por edhe të vetë gjuhës së specialitetit.

Kjo analizë nevojash gjuhësore e mikrogjuhësore duhet kryer duke përdorur teknika të ndryshme sipas niveli të saktësisë që dëshirohet të arrihet. Edhe pse nevojat e një grupi të caktuar nuk mund të përcaktohen përfundimisht, pasi nuk janë konstante, ato mund të përditësohen dhe plotësohen gjatë procesit të mësimdhënies/mësimnxënies.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

### III.6. Formimi i vazhdueshëm profesional i mësuesit të gjuhëve të huaja të specialitetit, domosdoshmëri në realitetin e sotëm të mësimdhënies

Cili është formimi që duhet të zotërojë një mësues i gjuhëve të huaja të specialitetit në mënyrë që të jëtë në gjendje të marrë pjesë në projektimin kurrikular, të analizojë një gjuhë specialiteti, të përgatisë së paku një pjesë të materialit didaktik që përdor? Mbi këto argumente është kryer një debat njëzetvjeçar dhe do përpiqemi në këtë çështje, duke u bazuar edhe në literaturën përkatëse referuese, të sjellim propozime apo mendime lidhur me formimin dhe trajnimin profesional të mësuesëve të gjuhëve të huaja të specialitetit.

Formimi i mësuesëve të gjuhëve të huaja ka nisur që në vitet Gjashtëdhjetë, në Francë, në Besançon dhe St Cloud si dhe në Britaninë e Madhe në Edinburg. Ndodhi ai revolucion kopernikan glotodidaktik, që nuk përfshinte vetëm ‘*çfarë mësohet*’ por edhe ‘*kush mëson*’. Dhe është pikërisht nga këto qendra kërkimi, ku ka lindur përkufizimi i një mësuesi me profil të ri, i formuar, jo vetëm nga pikëpamja e njohurisë së gjuhës, por edhe nga ajo glotodidaktike.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj për qëllime specifike ka qenë në qendër të vëmendjes së studiuesëve, pedagogëve dhe specialistëve të ndryshëm, të cilët përmes shkrimesh dhe artikujsh shkencorë kanë shprehur mendime, sugjerime në funksion të përmisimit të këtij procesi. Pavarësisht këtyre studimeve vërehet mungesa e një modeli dominues ose e disa modeleve bashkëvepruese për formimin dhe kualifikimin e mësuesëve të angazhuar në gjuhët e huaja të specialitetit.

Ç farë ndodh në realitet? Studimet e kryera, lidhur me domosdoshmërinë e formimit profesional të mësuesëve, janë individuale dhe nuk janë në gjendje të ofrojnë një kuadër referimi mbi të cilin mund të pranohen, refuzohen apo integrohen ide të reja. Mungon pra një vizion unitar dhe specifik apo strategji për formimin e këtyre mësuesëve.

Gjithësesi disa përpjekje janë kryer. Përmendim këtu një program të quajtur *MATESOL*<sup>53</sup>, i zbatuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili është krijuar specifikisht për formimin e mësuesëve të gjuhëve të huaja të specialitetit si dhe Institutin prestigjioz për studimin e Gjuhëve të Aplikuara i Edinburgut, i cili ka kryer një eksperimentim tërësisht origjinal: mësuesit marrin pjesë në kurse të gjuhëve të specialitetit, të mbajtura në mbarë botën nga profesionistë të po këtij instituti.

Por, propozimet e mësipërme nuk janë të tilla që të krijojnë një sistem, duke u integruar në një rrjet kërkimesh më të gjera dhe më të harmonizuara.

Edhe pse dikush mund të tregohet skeptik lidhur me mundësinë e të mësuarit për të mësuar të tjerët, duhet të vlerësojmë se efikasiteti didaktik i një mësuesi përmisohet ndjeshëm përmes formimit dhe trajnimit profesional.

Këto trajnime mund të kryhen:

---

<sup>53</sup> Master of Arts in Teaching English to Speakers of other Languages

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

- a. para se mësuesi të jetë efektiv në punë. Kjo zhvillon përgatitjen dhe organizimin e aktivitetit didaktik dhe shkurton kohën e provave dhe gabimeve që çdo mësues mund të eksperimentojë në kurriz të nxënësve të tij.
- b. gjatë shërbimit. Në këtë rast, parimet metodologjike dhe praktikat e ndryshme didaktike vihen vazhdimisht në diskutim dhe përquesen me teknika të reja metodologjike.

Në të dyja rastet, seminarët e trajnimit të mësuesëve të gjuhëve të huaja të specialitetit mund të jenë të tipologjive të ndryshme:

1. **Seminar formimi i llojit të përgjithshëm.** Trajnimi mund të ketë një karakter të hapur dhe të kuorueshëm, e të fokusohet në situatat e ndryshme, në kërkesat dhe nevojat e nxënësve, në aftësitë e mësuesëve për të dalluar veçoritë psikologjike dhe sociale të tyre. Interesi për nxënësin dhe nevojave të tij është një ndër faktorët kryesorë të suksesit. Në këtë lloj formimi duhet të enfatizohet personaliteti i mësuesit, aq i rëndësishëm për aktivitetin didaktik, si dhe motivimi ndaj mësimdhënies.
2. **Seminar formimi i llojit specifik.** Theksi vendoset mbi kompetencën gjuhësore, kompetencën komunikuese dhe kompetencën ndërkulturore. Është në fakt e pamundur që një mësues të mësojë mirë diçka që ai nuk e zotëron. Trajnimi parashikon kështu një plotësim të përgatitjes gjuhësore të mësuesëve të ardhshëm. Nëse seminari është i ideuar për mësuesit në shërbim, elementi gjuhësor mund të ritrajtohet përmes seksioneve të përsëritjes, përforcimit, apo duke u zhvilluar tërësisht në gjuhë të huaj, në mënyrë që materialet e paraqitura dhe mbi të cilat punohet të shërbejnë për përforcimin gjuhësor të tyre.
3. **Seminar i formimit metodologjik.** Ndryshe nga seminarët e formimit paraprak në ndihmë të koncepteve bazë të gjuhësisë, kurset dhe trajnimet e mësuesëve në detyrë duhet të synojnë në sjelljen e kërkimeve më të fundit shkencore në fushën e didaktikës. Mësuesi duhet të njohë në veçanti orientimet e ndryshme metodologjike dhe të ketë eksperimentuar para se të hyjë në klasë, teknikat e materialeve, ushtrimeve gjuhësore dhe ato lidhur me testimin dhe vlerësimin e nxënësve. Ai duhet t'i zbatojë këto teknika në mënyrë fleksibël, sipas nevojave të nxënësve dhe mundësive të burimeve. Mendojmë se formimi i llojit metodologjik duhet të jetë, jo thjesht i orientuar në teori, por edhe në praktikë.

Në Shqipëri, në Universitetet si publike, ashtu edhe private, mësuesi i gjuhëve të huaja të specialitetit, është një mësues i gjuhës së huaj, i kualifikuar në aspektin glotodidaktik dhe i thirrur të japë gjuhën e specialitetit, pasi ka studiuar veçoritë e gjuhës, objektit të studimit.

Edhe në Shqipëri ndihet nevoja për zhvillimin e seminareve trajnuese. Problemi i motivimit nuk i përket vetëm nxënësve, por edhe mësuesëve të gjuhës së huaj të specialitetit. Sa më shumë mësuesi të jetë i motivuar, aq më shumë do të arrijë të nxisë pjesëmarrjen e nxënësve.

Nëse formimi fillestar dhe përditësimi i vazhdueshëm janë të rëndësishëm për të gjithë mësuesit, detyrat specifike e të ndryshme që u kërkohen mësuesëve të gjuhëve të huaja të specialitetit e bëjnë të domosdoshme pjesëmarrjen dhe aktivizimin në këto

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

seminare të përgatitjes dhe rritjes profesionale. Në mënyrë që këto trajnime të jenë efikase është shumë e rëndësishme që objektivat e përcaktuata të jenë ngushtësisht të lidhura me nevojat reale të mësuesëve. Sigurisht, jo vetëm këto kurse mund të garantojnë një përgatitje të kompletuar të mësuesëve, pasi shumë nga aftësitë didaktike fitohen me eskperiencën dhe me punën në klasë.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## KREU IV

### AFTËSITË E STUDIMIT DREJT PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NË GJUHË SPECIALITETI

Në këtë çështje do të analizojmë aftësitë e studimit, pra ato kompetenca që u kërkohen nxënësve, jo vetëm për studimin e gjuhëve të huaja të specialitetit, por edhe për përvetësimin e kompetencës komunikuese, si një objektiv kryesor i mësimdhënies/mësimnxënies.

#### IV.1. Vështirësitë e nxënësve gjatë përvetësimit të aftësive të studimit

Përveç katër aftësive të llojit gjuhësor, të njohura si makroaftësi (*leximi, dëgjimi, shprehja me gojë dhe me shkrim*), nxënësit, të cilët studiojnë një gjuhë të huaj specialiteti, duhet të përvetësojnë edhe aftësi të tjera, të cilat mund t'i përkufizojmë me termin mikroaftësi, të tilla si: *leximi dhe kuptimi i një teksti në gjuhë specialiteti, përdorimi i fjalorit, përvetësimi i leksikut të ri specifik, puna në bibliotekë, përgatitja për një provim, organizimi i një metode studimi, mbajtja e strukturuar e shënimeve, përmbledhja e një teksti, përmisimi i aftësive të memorizimit, pajisja me teknikat e reja të kërkimit, përgatitja e një relacioni dhe prezantimi i tij, formulimi i hipotezave mbi kuptimin e një termi* etj. Në mësimdhënien e gjuhëve të huaja të specialitetit, mësuesi duhet të punojë, përmes veprimtarive didaktike, për një përdorim të integruar të makroaftësive dhe të mikroaftësive. Rezultati final është një mësimdhënie, e cila synon rritjen e kompetencës së komunikimit, në situata të ndryshme të natyrës shkencore-profesionale.

Aftësitë gjuhësore, janë përgjithësisht të llojit transversal, pasi nuk janë specifike në një gjuhë specialiteti të caktuar, por pasi fitohen në njërin prej tyre mund të transferohen në gjuhë të tjera. Në përdorimin e këtyre aftësive, vëmendja duhet të përqëndrohet mbi ato veprimtari, që përgjithësisht kryhen në klasë, për të ndihmuar nxënësit që të fitojnë pavarësi në përvetësimin e kompetencës së komunikimit.

Nevojat gjuhësore të identifikuar duhet të kthehen në objektiva didaktikë sipas të cilave nxënësi duhet të kuptojë dialogje, në të cilat përdoret një gjuhë specifike e teknike, të kuptojë tekste të shkruara, lidhur me lëndën, objekt i studimit, të jetë në gjendje të sintetizojë një argument e të dijë ta riprodhojë atë, të diskutojë për një argument të caktuar e të tjera si këto.

Por cilat janë vështirësitë më të mëdha me të cilat ndeshen nxënësit gjatë përvetësimit të një gjuhe të huaj specialiteti?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, po sjellim rezultatet e nxjerra përmes metodës së vëzhgimit lidhur me vështirësitë e nxënësve.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## IV.1.1. Metoda e vëzhgimit të vështirësive mbi aftësitë e studimit

Për të njohur nga afër dhe analizuar vështirësitë e studentëve në përvetësimin e aftësive të studimit të gjuhës së huaj të specialitetit kemi përzgjedhur metodën e vëzhgimit.

**Fokus grupi** janë studentë të kursit të parë të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin Zoja e Këshillit të Mirë, në Tiranë.

**Niveli gjuhësor** i tyre është B1.

**Teskta i përdorur:** *‘L’italiano per i medici’*.

**Kohëzgjatja e vëzhgimit:** 50 orë mësimore.

**Numri i nxënësve:** 40 (20 për secilin grup të të njëjtit nivel).

**Qëllimi i përdorimit të metodës:** Për të njohur nga afër vështirësitë e studentëve në përvetësimin e aftësive të studimit të gjuhës së huaj të specialitetit. Më konkretisht, objekti i këtij vëzhgimi është nxjerrja në pah e vështirësive gjatë procesit të nxënies.

### **Metodologjia e vëzhgimit:**

Përgatitëm një skedë më aftësitë e studimit, të cilat janë të nevojshme për përvetësimin e gjuhës italiane mjekësore.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

**Tabela IV.1.**

## SKEDË VËZHIMI MBI EVIDENTIMIN E VËSHIRËSIVE GJATË PROCESIT TË NXËNIES



<b>Leximi dhe kuptimi i tekstit</b>			
Leximi i rrjedhshëm	<i>Është prezent</i>	<i>Nuk është prezent</i>	
Kuptimi i tekstit	<i>Kupton dhe i shpreh konceptet në gjuhën italiane</i>	<i>Kupton, por ka vështirësi në shprehjen e koncepteve</i>	<i>Nuk kupton konceptet</i>
<b>Aftësia e përmbledhjes se tekstit</b>			
Dallimi i informacioneve parësore nga ato dytësore	<i>Aftësi për të përmbledhur tekstin</i>		<i>Vështirësi për të përmbledhur tekstin</i>
<b>Aftësia e komunikimit ndërveprues</b>			
Përdorimi i termave mjekësore në komunikimin ndërveprues	<i>Nuk i përdorin fare</i>	<i>I përdorin me vështirësi</i>	<i>I përdorin me lehtësi</i>
Dhënia e argumentave për të mbështetur/kundërshtuar një tezë të caktuar	<i>Nuk japin fare argumenta</i>	<i>Vështirësi në paraqitjen e argumentave</i>	<i>Paraqitja e argumentave me lehtësi</i>
<b>Aftësia për të përgatitur një relacion me shkrim</b>			
Ortografia e fjalës	<i>E saktë</i>	<i>E gabuar</i>	
Struktura	<i>E saktë</i>	<i>E gabuar</i>	
Forma e foljeve pësore/veprore	<i>E saktë</i>	<i>E gabuar</i>	
<b>Aftësitë për të prezantuar një relacion</b>			
Format e prezantimit	<i>Cilësore &amp; mendimi i pavarur prezent</i>	<i>E thjeshte/mekanike/ pa praninë e mendimit të pavarur</i>	
Metodat e prezantimit	<i>Me Power Point</i>	<i>Pa Power Point</i>	



# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## ❖ Leximi dhe kuptimi i tekstit.


Nga vëzhgimi, ka rezultuar se më shumë se 50% e studentëve kishin vështirësi në leximin dhe kuptimin e një teksti të ri. 30% e tyre i kuptonin konceptet e tekstit, por kishin vështirësi për t'i shprehur ato në gjuhën italiane; 20% e studentëve nuk ishin në gjendje të jepnin përgjigjen e saktë rreth pyetjeve lidhur me kuptimin e tekstit.



## ❖ Aftësia e sintezës


## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Gjatë vëzhgimit, rezultoi se vetëm 40% e nxënësve kishin aftësi të mira për të sjellë sintezën e një teksti, relativisht të gjatë. 60% e tyre kishin vështirësi kryesisht në përcaktimin e shkallës së prioriteteve të informacioneve.



### ❖ Aftësia e komunikimi ndërveprues.


Nga vëzhgimi, ka rezultuar se 40% e nxënësve, edhe pse e kishin përvetësuar terminologjinë mjekësore, ç'ka u verifikua përmes kryerjes saktësisht të veprimtarive të natyrës leksikore, kishin vështirësi në përdorimin e termave mjekësorë, në kontekstin e komunikimit ndërveprues. 50% e nxënësve vështirësi në dhënien e argumentave për të kundërshtuar apo për të mbrojtur një tezë të caktuar.



### ❖ Aftësia për të përgatitur një relacion me shkrim


## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

50% e studentëve gabonin në ortografinë e fjalëve dhe termave. 20% e tyre nuk respektonin strukturën sipas modelit: hyrje-zhvillimi i argumentave-përfundime. 30% e studentëve përdornin formën veprorë të foljes kundrejt formës pësore.



### ❖ Aftësia për të prezantuar një relacion

Gjatë vëzhgimit, rezultoi se 60% e studentëve prezantuan punimet e tyre, thjesht duke i lexuar ato dhe kishin vështirësi në dhënien e mendimit të pavarur, kryesisht në pjesën përmbyllëse. Prezantimet në Power Point rezultuan më cilësore kundrejt prezantimeve të thjeshta.



## IV.2. Aftësitë e studimit për përvetësimin e Gjuhëve të Huaja të Specialitetit

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Duke marr shkas nga rezultatet e marra përmes metodës së vëzhgimit, mbi vështirësitë që hasin nxënësit gjatë studimit dhe përvetësimit të një gjuhe të huaj specialiteti, menduam të analizojmë në mënyrë më të hollësishme këto aftësi studimi, si të rëndësishme për studimin e gjuhëve të huaja të specialitetit, duke sjellë krahas sugjerimeve teorike, edhe veprimtari didaktike konkrete në funksion të përvetësimit të tyre.

### ➤ **Procesi konstruktiv i leximit në gjuhën e huaj të specialitetit**

Didaktika e gjuhëve të huaja të specialitetit vendos në plan të parë aftësinë e leximit ose të kuptimit të tekstit, sepse lexim do të thotë edhe kuptim. Detyrë e mësuesit të gjuhës së huaj është prezantimi i një teksti në mënyrë të tillë që *ai të flasë, të lexohet e të rilexohet*, duke e drejtuar nxënësin në zbulimin tërësor të tij. Duke fituar strategjitë e leximit, për nxënësin bëhet më i lehtë aksesimi edhe në tekste tepër të vështira, në fusha të ndryshme specialiteti. Nuk bëhet më fjalë për të deshifruar tekste në mënyrë lineare, por për të perceptuar kuptimin e tyre, duke u bazuar edhe në tregues gjuhësorë (*tituj, përmbledhje*) ose në tregues jashtëgjuhësorë (*imazhe, tabela, diagrame*), tipike për gjuhët e specialitetit.

Leximi nuk konsiston në një perceptim të thjeshtë dhe në një kuptim të të gjitha fjalëve të një teksti, por është një aktivitet racional, përmes së cilit, lexuesi kërkon përgjigje. Ndryshe nga e kaluara, ku procesi i leximit konsiderohej si një shprehje për të dalluar shkronja dhe fjalë, të cilat çonin në lidhjen e fjalëve në fjali, të fjalive në paragrafë dhe të paragrafëve në diskutime të gjata, sot ai vlerësohet si një proces i gjallë mendor e intelektual, gjithnjë në veprim, ku lexuesi ndërton kuptimin e tekstit më shumë sesa realizon riprodhimin e fjalëve të tij. Nuk bëhet fjalë për një funksion mendor, por për një rezultante të shumë faktorëve, të përcaktuara më saktësisht, si aftësi<sup>54</sup>. Duke qënë një aftësi e rëndësishme e studimit del si domosdoshmeri reale mësimi i teknikave të leximit. Por cilët janë dhe si përftohen treguesit që mundësojnë leximin e suksesshëm? Cilat strategji, metoda apo teknika të mësimdhënies duhet të përdorim që të përftojme lexues të cilët marrin në mënyrë të plotë informacionin nga tekstet me të cilët janë vazhdimisht në ndërveprim? Më poshtë po përpiqemi të sjellim në mënyrë të hollësishme teknikat, të cilat mundësojnë aftësinë e leximit, duke e konsideruar atë si një proces konstruktiv dhe frytdhënës për arritjen e objektivave gjuhësorë të paracaktuara.


### **Teknikat e leximit të teksteve në gjuhë të huaj specialiteti**

Për të studiuar një tekst është i nevojshëm përdorimi i teknikave të veçanta, përmes së cilave bëhet i mundur përcaktimi ideve kryesore, të renditura në mënyrë kritike dhe organike. Ç do marrje e re e informacionit, nuk i shtohet thjesht atyre që tashmë zotërojmë, por ofron instrumenta të rinj të kuptimit, duke krijuar një aset të ri në dijen individuale.

<sup>54</sup> B.M. Brazon, *Il processo del leggere*. Liviana, Padova 1974. Fq 137

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Diagrama e mëposhtme sjell veprimet e njëpasnjëshme që duhen kryer gjatë lexim-studimit :



Në vijim po analizojmë teknika të ndryshme leximi.

- **Leximi intensiv/Leximi ekstensiv**

Në literaturën tradicionale glotodidaktike, vendoset një dallim, tashmë klasik, mes leximit *intensiv* dhe leximit *ekstensiv*, duke nënkuptuar me lexim intensiv, leximin e kryer në klasë, mbi një numër të caktuar rreshtash, nën drejtimin e mësuesit, dhe me lexim ekstensiv, atë të zhvilluar në shtëpi, nga çdo nxënës, i lirë të zgjedhë një material mbi të cilin të ushtrohet sipas interesave të veta dhe nevojave individuale. Është e qartë se e dyta përfshin të parën dhe se ka një ndërveprim të vazhdueshëm mes tyre. Ndërsa në leximin intensiv, nxënësi është gjysëm pasiv, e gjithësesi drejtohet nga mësuesi, nga grupi dhe mbi të gjitha nga teksti, në leximin ekstensiv ai është më aktiv, i përzgjedh informacionet sipas interesave dhe nevojave të veta, duke çmontuar skemat semantike, të propozuara nga autori i tekstit, për t'i përshtatur me të vetat. Në këtë mënyrë, leximi ekstensiv kthehet në një lexim-studim ose lexim-kërkim. Në kontekstin e gjuhëve të specialitetit, ky lexim është edhe më i natyrshëm, pasi pritshmëria e lexuesit është më e saktë, duke konsideruar faktin se ai njeh të paktën pjesërisht, përmbajtjen nocionale dhe faktike të asaj që lexon. Leximi intensiv, përgatit nxënësin për leximin ekstensiv, përmes së cilës ai arrin të komunikojë me tekstin, duke aktivizuar ato mekanizma kompleksë që rregullojnë kuptimin tërësor të tij. Gjatë leximit ekstensiv nuk merret vetëm kuptimi i frazave të veçanta, por kryhet edhe një veprim sinteze. Në një moment të parë është e mundur të vendoset një paralelizëm mes leximit '*me zë të lartë*' dhe leximit '*intensiv*', të praktikuar në klasë, nën kujdesin e mësuesit dhe leximit '*në heshtje*' dhe atij '*ekstensiv*' që praktikohet në shtëpi, me më shumë liri dhe autonomi, i cili ka si qëllim kuptimin e tekstit. Leximi me zë të lartë dhe intensiv është i rëndësishëm, jo vetëm për diksionin, shqiptimin dhe intonacionin, por ndihmon edhe për leximin ekstensiv të heshtur.

- **Leximi sintetik dhe leximi analitik**

Një leximi sintetik i përqaset leximi linear ose analitik. I pari synon një informacion të përgjithshëm mbi përmbajtjen e tekstit, i dyti synon të thellojë çdo pjesë të argumentit logjik të paraqitur.

- **Leximi onomaziologjik dhe semaziologjik<sup>55</sup>**

<sup>55</sup> Cambiaghi B. *Didattica delle ricezione del testo microlinguistico*. Vita e Pensiero, Milano, 1985. fq. 104-111.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Një tjetër përjasje diktonomike ndaj leximit është edhe ajo që shkon nga kuptimi tek shenja (*leximi onomaziologjik*) dhe nga shenja tek kuptimi (*leximi semaziologjik*).

Në kurset e gjuhëve të huaja të specialitetit, grupi i nxënësve është shpesh heterogjen, si në lidhje me njohuritë ndaj gjuhës së huaj, ashtu edhe me përmbajtjet shkencore të fushës specifike të disiplinës. Në rastin e nxënësve më të përgatitur në disiplinën specifike, por më të dobët në nivel gjuhësor, (psh. niveli A1), këshillohet një lexim onomaziologjik, i cili nisët nga kuptimi tek shenja, ku kuptimi është parcialisht i njohur, dhe vëmendja përqëndrohet mbi shenjën gjuhësore. Ndërsa nxënësve që nisen nga një nivel i avancuar i gjuhës së huaj të dytë, por jo në disiplinën e specialitetit, mund t'u këshillohet një lexim semaziologjik, ku vëmendja përqëndrohet mbi aspektin formal dhe lexuesi përqëndrohet mbi komponentët tekstualë dhe gjuhësorë të komunikimit. Në këtë mënyrë ata arrijnë të krijojnë një kompetencë referenciale, pra një kuptim më të saktë, vetëm në një moment të dytë. Këto dy teknika plotësojnë njëra tjetrën dhe integrohen reciprokisht. Si për leximin onomaziologjik, (lexues i përgatitur mirë për argumentin, por i dobët nga pikëpamja gjuhësore), ashtu edhe për atë semaziologjik, (lexues i fortë gjuhësisht, por i dobët në argument), kuptimi global i tekstit kalon përmes proceseve qasëse të cilat sjellin në fokus ekuilibrin gramatikor dhe semantik, kusht ky i padiskutueshëm për një lexim konstruktiv të tekstit.

Duke thelluar diktonominë mes onomaziologjisë dhe semaziologjisë shkohet në zemër të problemit të gjuhës, pra në nocionin e shenjës gjuhësore, bashkim i pandashëm mes shenjës dhe shënjesit, dhe si rrjedhojë, në zemër të procesit të komunikimit njerëzor, ku ka një ndërveprim të vazhdueshëm mes folësit dhe dëgjuesit të aktit komunikues.

- **Teknika 'Skimming' dhe 'Skanning'**<sup>56</sup>

Dy teknika të tjera për leximin dhe kuptimin e tekstit të specialitetit janë edhe teknikat **'Skimming' dhe 'Skanning'**. Bëhet fjalë për strategji leximi që rregullohen nga qëllime të ndryshme që lexuesi i vë vehtes.

*Skimming* (nga anglishtja: *to skim*) është leximi i shpejtë.

Kjo teknikë lidhet me aftësinë për të kuptuar esencën e tekstit, duke gjetur informacionin kryesor e duke anashkaluar ato dytësoret. *Skanning* (nga anglishtja: *to scan*) që do të thotë të eksplorosh, është një lloj leximi orientues, që synon gjetjen e një informacioni të veçantë, i cili dihet apo mendohet të jetë i pranishëm në tekst. Pra, leximi kryhet në funksion të gjetjes së një informacioni specifik. Është një lexim i orientuar në një drejtim të caktuar. Të dyja janë mjaft të dobishme, pasi ndërveprojnë në kuptimin e tekstit të specialitetit.

Duke alternuar leximin *skimming* dhe leximin *scanning* nxënësit lexojnë tekstin, duke zbuluar të dhënat thelbësore për zhvillimin e argumentit. Këto dy teknika janë ngushtësisht të lidhura mes tyre dhe nuk paraqiten nga pikëpamja didaktike të

---

<sup>56</sup>Cambiaghi B. *Didattica delle ricezione del testo microlinguistico*. Vita e Pensiero, Milano, 1985. fq. 102-104.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

hierarkizuara, sikurse leximi me zë të lartë dhe intensiv dhe ai me zë të ulët dhe ekstensiv. Bëhet fjalë në fakt, për dy teknika absolutisht të barabarta, që ushtrohen njëkohësisht dhe në mënyrë alternative në klasë dhe që të dyja kontribuojnë për një kuptim më të mirë të tekstit.

### **➤ Aftësia e sintezës në gjuhët e huaja të specialiteti**

Sinteza e një teksti të dhënë në gjuhë specialiteti përfshin aftësi, jo thjesht të karakterit gjuhësor, por edhe të natyrës logjike. Ky aktivitet, kërkon reduktimin e tekstit në terma sasiore, por duke mbajtur të pandryshuar funksionin komunikues dhe pa përcaktuar humbje përsa i përket përmbajtjes semantike të tekstit.

Mësuesi i gjuhëve të huaja të specialitetit duhet të drejtojë nxënësit, duke u dhënë atyre sugjerime mbi teknikat e duhura për të përmbledhur një tekst. Për këtë, nxënësit duhet të praktikohen në aftësitë e mëposhtme:

- ❖ Të lexojnë tekstin duke u nisur nga elementët e përgjithshëm në ato më specifike, ose në mënyrë figurative, nga makroskopi në mikroskop;
- ❖ Të kuptojnë pjesët e ndryshme të një teksti;
- ❖ Të kuptojnë lidhjet logjiko-pragmatike që ekzistojnë mes pjesëve të ndryshme;
- ❖ Të kuptojnë qëllimin kryesor të tij;
- ❖ Të përcaktojnë një shkallë prioriteti mes informacioneve të dhëna në tekst, duke dalluar parësoret nga dytësoret, në funksion të qëllimit prioritar: atë të kuptimit të thellë të tekstit;
- ❖ Të riformulojnë tekstin, duke përcaktuar lidhjet mes pjesëve të ndryshme dhe duke e ndryshuar atë herë pas here;

Në vijim, po sjellim një tekst në gjuhën italiane mjekësore, duke paraqitur disa veprimtari didaktike, nën drejtimin e mësuesit, lidhur me leximin, kuptimin dhe sintezën e një teksti.


### **Veprimtari praktike mbi leximin, kuptimin dhe sintezën e një teksti në gjuhën italiane mjekësore.**

Për të përqsaur pjesën teorike të shpjeguar më lart, me zbatimin e drejtëpërdrejtë në klasë, është menduar të sillen në këtë punim, një tekst në gjuhën mjekësore italiane, për të cilin janë formuluar disa ushtrime, të lidhura me teknikat e mësipërme e që ndihmojnë për leximin dhe kuptimin e tekstit.

---

<sup>57</sup> Material i marrë nga teksti i Balbonit G. C. et alii "Anatomia Umana"; Edi-Ermes Milano, 2000.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR



*Le ossa che si trovano all'interno del nostro corpo sono vive. Le ossa si formano durante la vita intrauterina e proseguono il loro accrescimento dopo la nascita fino all'età di circa 20 anni.*

*Le ossa sono fatte di diversi strati. Le ossa sono ricoperte da un sottile rivestimento che si chiama periostio. Lo strato al di sotto del periostio è fatto di una sostanza dura e resistente e si chiama tessuto compatto. Sotto al tessuto compatto troviamo una sostanza spugnosa molto flessibile detta tessuto spugnoso. Nella parte più interna delle ossa c'è il midollo. Nel midollo si producono i globuli rossi che abbiamo nel sangue e che servono per trasportare l'ossigeno nelle varie cellule. Le ossa lunghe presentano un corpo allungato o*

*diafisi con due estremità ingrossate o epifisi. Per quanto attiene alla conformazione interna, le ossa lunghe presentano all'interno della diafisi, costituita da tessuto osseo lamellare compatto. Le ossa piatte risultano costituite da uno strato di tessuto spugnoso rivestito da due strati di tessuto osseo compatto. Le ossa brevi presentano un nucleo di tessuto osseo spugnoso avvolto da tessuto osseo compatto. E' importante sapere che il tessuto osseo, anche nell'adulto è estremamente dinamico, in quanto continuamente soggetto a fenomeni di rimodellamento strutturale che rispondono a mutate esigenze metaboliche e di carico. Questo processo, anche se aritmo variabile secondo l'età, continua per tutta la vita.*

### **Veprimtaria 1:**

Lexoni titullin dhe bëni hipoteza mbi kuptimin e përgjithshëm të tekstit.

### **Veprimtaria 2**

Pasi të keni lexuar tekstin, vendosni në dy kolona fjalitë që nxjerrin në pah pjesën argumentuese dhe ato që nxjerrin në pah pjesën shpjeguese.

### **Veprimtaria 3**

Lexoni tekstin dhe pas kësaj, nënvizoni informacionet specifike që gjenden në të.

### **Veprimtaria 4**

Përcaktoni një shkallë prioriteti mes informacioneve të dhëna në tekst, duke dalluar parësoret nga dytësoret, në funksion të qëllimit prioritar të identifikuar më parë;

### **Veprimtaria 5**

Lexoni pjesën dhe nënvizoni fjalët – kyçe të çdo paragrafi.

### **Veprimtaria 6**

Nënvizoni lidhjet logjiko-pragmatike që ekzistojnë mes pjesëve të ndryshme të tekstit.

### **Veprimtaria 7**



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Lexoni pjesën për 2 minuta dhe përmbliidheni në formën e sintezës.

### ➤ Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Mbajtja e shënimeve është një ndër metodat e përdorura për të studiuar me efikasitet. Shpesh shënimet mbahen nga ana e nxënësve në mënyrë jo të organizuar. Ato nuk përfshijnë informacione të rëndësishme. Seleksionimi i përmbajteve dhe sintetizimi i formave të përdorura për mbajtjen e shënimeve lidhen me faktin se koha e shkrimit është shumë më e ngadaltë se ajo e të folurit. Përgjithësisht flitet me një shpejtësi prej afro 150 fjalë në minutë, ndërkohë që nuk arrihet të shkruhen më shumë se tridhjetë fjalë për të njëjtin interval kohe. Meqënëse gjithshka ndodh ndërsa mësuesi vazhdon të flasë, nxënësi duhet të jetë i pajisur me cilësi të mira për qëndrimi dhe vëmendjeje.

Ekzistojnë teknika të ndryshme për t'u mësuar nxënësve se si të marrin shënime në mënyrë sa më strukturuar. Njëra prej tyre është familiarizimi i klasës me sisteme konvencionale, përgjithësisht të përdorura dhe të propozuara në manuale të ndryshme. Kështu, nxënësve u mësohet se gjatë marrjes së shënimeve nuk duhet shkruar gjithshka, mund të evitohen foljet ndihmëse, nyjet, përemrat, parafjalët dhe të gjithë elementët të cilët mund të kuptohen lehtësisht nga konteksti.

Kundrejt përdorimit të një teksti të shkruar, marrja e shënimeve gjatë procesit të shpjegimit është një aktivitet më i vështirë, për vetë faktin se, ndërsa teksti i shkruar është në dispozicion të nxënësit dhe mund të përdoret disa herë, ai i prezantuar me gojë perceptohet një herë të vetme. Gjithashtu, ndërsa në hedhjen e shënimeve përmes dëgjimit qëndron kriteri i simultaneitetit, mes dëgjimit të tekstit dhe mbajtjes së shënimeve mbi elementët thelbësorë të tij, në rastin e tekstit të shkruar ndiqet kriteri konsektiv, pra nxënësi merr shënime pasi të ketë plotësuar leximin e një paragrafi dhe para se të lexojë ate pasues.

Këto vështirësi në mbajtjen e shënimeve mund të vijnë edhe si rezultat i metodave të ndryshme të shpjegimit nga ana e mësuesit. Dudley-Evans e Johns,<sup>58</sup> pasi kanë analizuar një korpus leksionesh në gjuhë të huaja specialiteti, kanë identifikuar stilet e mëposhtme të shpjegimit:

- A. **Stili i leximit** (*Reading style*). Mësuesi lexon nga shënimet e tij ose flet sikurse të ishte duke lexuar prej tyre. Grupet e tingujve janë të shkurtër dhe gama intonative është kryesisht e kufizuar. Diksioni përgjithësisht është i rregullt dhe jo i shpejtë.
- B. **Stili bashkëbisedues** (*Conversational style*). Mësuesi flet në mënyrë informale, me ose pa shënime. Grupet e tingujve janë më të gjata dhe gama intonative është më e gjerë. Herë pas herë ka rritje të shpejtësisë, me reduktimin e zanoreve të ndërmjetme dhe fundore.
- C. **Stili retorik** (*Rehtorical style*). Mësuesi sillet si aktor, duke përdorur një gamë të gjerë skemash intonative, nga nivelet më të ulta në ato më të larta. Bën shpesh komente, ndryshon shpejtësinë e zërit dhe vendos një theks të veçantë mbi elementë të caktuar.

<sup>58</sup> Dudley-Evans e Johns në Gotti M. *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*. Fq. 174

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Një mënyrë tjetër e vlefshme gjatë mbajtjes së shënimeve, konsiston në përdorimin e simboleve, disa prej të cilave, po i listojmë në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë:

= *e barabartë, ekuivalente, është sinonim me, konsiston në, përfaqëson;*

→ *shkakton, rezulton konvertohet në, buron nga;*

← *bazohet në, rezulton nga, zhvillohet nga, prodhohet nga, krijohet nga, bazohet në;*

> *më shumë (më i lartë, i rritur, i theksuar);*

≈ *(i mundshëm, afro, në rast se).*

Gjatë mbajtjes së shënimeve, nxënësit mund të përdorin elementë grafikë për të paraqitur ide dhe informacione të ndryshme. Këto elementë, të cilat ndryshe mund t'i quajmë edhe organizues grafikë, u sigurojnë nxënësve një strukturë pamore, e cila mund të shërbejë si referencë në të ardhmen, duke ndihmuar në të njëjtën kohë në shprehitë e studimit të pavarur. Në këtë mënyrë, nxënësit janë të aftë të shohin lidhje ndërmjet ideve, duke marrë informacione, të cilat janë koherene dhe të lehta për tu përdorur.

Por, ekonomizimi i shkrimit nuk duhet të shkojë deri në shmangie të lexueshmërisë dhe kuptueshmërisë. Për këtë arsye, për të evituar, që pas një periudhe të caktuar kohore, shënimet e mbajtura të mos mund të kuptohen, është mjaft e rëndësishme organizimi i sistemit të mbajtjes së strukturuar të shënimeve.

### ➤ Aftësia e përdorimit të fjalorit

Shumë veprimtari didaktike, në gjuhët e huaja të specialitetit, kërkojnë përdorimin e fjalorit. Kështu, mësuesit mund t'i orientojnë nxënësit e tyre se si ta përdorin atë me efikasitet, duke konsideruar faktin se dobishmëria e tij nuk kufizohet thjesht në kontekstin shkollor, por përgjatë gjithë jetës profesionale. Nxënësit duhet të fitojnë aftësinë, jo vetëm për të gjetur me shpejtësi vendodhjen e fjalës së kërkuar, sipas rendit alfabetik, por përmes përdorimit të shpeshtë të fjalorit, ata mësojnë gradualisht teknikat e përkufizimeve të termave. Në këtë mënyrë, fjalori përdoret si një instrument për të përvetësuar shprehitë komunikuese. Sikurse pohon edhe Baxter<sup>59</sup>, kjo teknikë mund të jetë e dobishme për zhvillimin e kompetencës strategjike të nxënësve, përmes së cilës ata aftësohen për përdorimin e perifrastimeve apo përkufizimeve, në vend të një fjale të vetme.

Në vijim, po sjellim disa shembuj veprimtarish didaktike, në gjuhën italiane ekonomike, të cilat aftësojnë nxënësin për përdorimin me kompetencë të fjalorit.

### Veprimtaria 1

---

<sup>59</sup> Baxter, J 'The Dictionar and Vocabular Behaviour' në Gotti M. *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*. Fq. 189.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

*Me ndihmën e fjalorit, shkruani përkufizimet e termave të mëposhtëm dhe disiplinat e ndryshme në të cilat ato përdoren.*

*Inflazione* \_\_\_\_\_

*Valore* \_\_\_\_\_

*Estinguere* \_\_\_\_\_

*Costituire* \_\_\_\_\_

*Tutela* \_\_\_\_\_

*Assumere* \_\_\_\_\_

### **Veprimtaria 2**

*Për përkufizimet e termave të mëposhtëm (ku jo të gjitha janë të sakta), përmes fjalorit verifikoni përkatësinë e tyre, duke lidhur termat me përkufizimet e sakta.*

*Appalto:        eccessivo aumento del denaro in circolazione in un paese.*

*Asta:            conteggio delle entrate e delle uscite relative a un dato periodo della gestione amministrativa di un'azienda.*

*Bilancio:       contratto con cui un'impresa si impegna a fare un lavoro pagato.*

*Inflazione:     vendita pubblica al miglior offerente.*

### **Veprimtaria 3**

*Me ndihmën e fjalorit shkruani kuptimet e fjalëve të mëposhtme: inflazione, assumere, valore.*

### **Veprimtaria 4**

*Krijoni, duke konsultuar fjalorin, një familje fjalësh me termat: produrre, prestito, reddito.*

#### **➤ Aftësia për të shkruajtur një tekst në gjuhë specialiteti**

Veprimtaritë me shkrim janë të rëndësishme, mes veprimtarive të tjera didaktike të zhvilluara gjatë mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialiteti. Këto veprimtari sugjerohen të kryhen në fund të çdo njësie didaktike, pasi mendohet se janë përvetësuar,

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

si kompetenca gjuhësore (përdorimi i rregullave morfo-sintaksore, leksikore dhe tekstuale), ashtu edhe ato lidhur me përmbajtjen.

Mendojmë, se mësuesit duhet të drejtojnë nxënësit, duke u dhënë atyre fillimisht sugjerimet përkatëse dhe modele standarde, tipike për gjuhën e një specialiteti të caktuar dhe, pas kësaj, ata mund të fitojnë pavarësi në kryerjen e këtyre veprimtarive.

Në mënyrë të përmbledhur po sjellim disa sugjerime drejtuar nxënësve.

Pas reflektimit dhe planifikimit, nxënësit duhet të mbajnë shënim argumentet që mendojnë të trajtojnë dhe idetë që duhet të shpalosin. Ata, nuk mund të shkruajnë në mënyrë të qartë, nëse i idetë e tyre janë konfuzo apo kanë njohuri të pamjaftueshme për argumentet e përzgjedhur. Pas kësaj, strukturohen shënimet e mbajtura dhe përgatitet skema e punimit. Nis hartimi dhe, gjatë rishikimit të parë, nxënësit duhet të vërejnë se sa është respektuar koherenca dhe kohezioni i teksti, të kontrollojnë zgjedhjet leksikore, duke përzgjedhur termat më të përshtatshëm dhe të verifikojnë ortografinë e tyre, edhe me ndihmën e fjalorit. Sugjerohet përdorimi i termave specifike të disiplinës, objekt i studimit. Nxënësit duhet t'u japin një peshë të barabartë pjesëve të ndryshme të tekstit dhe mund të përdorin shprehje apo elementë lidhorë, të cilat nxjerrin në pah vlerën pragmatike të paragrafeve, duke i renditur në mënyrë koherente dhe duke evituar përsëritjet.

Në didaktikën e gjuhëve të specialitetit është pra e rëndësishme që idetë jo vetëm të jenë të sakta dhe të shprehura me një korrektesë gjuhësore, por teksti duhet të respektojë një strukturë, e cila mund të konsiderohet konvencionale me një disiplinë të caktuar.

Përveç sugjerimeve, mësuesit nëpërmjet veprimtarive didaktike mund t'u ofrojnë nxënësve, modele standarde tekstesh specialiteti, (*relacion, letër, korrespondencë, proces-verbale, përshkrim eksperimentesh etj*), ku të nënvizohen aspektet lidhur me organizimin e tekstit dhe përdorimin e elementëve formalë, tipikë për një gjuhë të caktuar specialiteti.

Në vijim, po sjellim disa shembuj veprimtarish didaktike, të cilat synojnë përvetësimin e aftësive për të hartuar dhe shkruajtur një tekst në gjuhë të ndryshme specialiteti.

### **• Sugjerime për kryerjen e veprimtarive didaktike**

Duke iu referuar mësimdhënies së gjuhës ekonomike, mësuesi u jep si detyrë nxënësve të hartojnë me shkrim një shkresë, e cila ka si objekt blerjen e një produkti të caktuar. Në ndihmë të tyre ai paraqet skemën e mëposhtme të korrespondencës tregtare:

- Referimi i ofertës së mëparshme;
- Porosia për mallrat që nevojiten;
- Udhëzime mbi amballazhimin, dorëzimin e mallit, sigurimin etj;
- Mënyra e pagesës së zgjedhur.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR


Mbi bazë të kësaj skeme, nxënësit hartojnë shkresën. Kjo veprimtari mund të zhvillohet edhe nëpërmjet teknikave të tjera didaktike: kështu, shkresa e përgatitur mund të zgjerohet, duke shtuar detaje të reja, informacione dytësore, të cilat nxënësit i kanë përvetësuar gjatë studimit. Një variant tjetër i kësaj veprimtarie është komunikimi me gojë nga ana e mësuesit i një liste të zgjeruar të dhënash, për të cilat nxënësit duhet të mbajnë shënimet përkatëse, dhe të përgatisin një letër tregtare më të zgjeruar. Në këtë mënyrë, alternohet aftësia e dëgjimit me aftësinë për të shkruajtur. Po kështu, mund të jepet teksti i një telegrami apo teleteksti dhe t'u këkohet nxënësve ta shkruajnë në trajtën e letrës tregtare.

Për të pasur një nivel më të lartë pavarësie, mund t'u jepen nxënësve të dhëna të mjaftueshme informative mbi përmbajtjen dhe qëllimin e letrës që ata duhet të shkruajnë. Pasi nxënësit kanë përfunduar aftësinë e hartimit të teksteve të tilla, ata fitojnë autonomi në hartimin me shkrim të tipologjive të tjera tekstuale në gjuhën ekonomike.

Një lloj tjetër veprimtarie didaktike është hartimi me shkrim i relacioneve të karakterit shkencor-profesional. Teknikat metodologjike për aftësimin e nxënësve në këtë lloj veprimtarie janë të shumëllojshme. Po sjellim disa prej tyre:

Nxënësve u shpërndahen tekste të ndryshme (mund të jenë të natyrës shkencore, sociale, juridike apo ekonomike), ku mungojnë elementët lidhorë (lidhësa, shprehje). U kërkohet nxënësve të bashkojnë fjalitë duke vendosur fjalët që mungojnë në vendin e duhur, ose, pasi janë dhënë fjali të ndryshme që sjellin të njëjtin koncept, u kërkohet nxënësve t'i bashkojnë ato duke krijuar fjali të përbëra ose paragrafë. Me këtë teknikë, nxënësit aftësohet të krijojnë tekste, duke respektuar kriterin e koherencës dhe kohezionit, si dy veçori themelore të një teksti të shkruar.

Duke iu referuar mësimdhënies së gjuhës mjekësore, po sjellim një shembull veprimtarie lidhur me përgatitjen e një relacioni. Mund të sugjerohet skema e përgatitjes së një relacioni shkencor mbi kolesterolin, duke skematizuar radhën e paragrafëve me informacionet kryesore.



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Ky model, i përdorur në gjuhën mjekësore, mund të zbatohet edhe në mësimdhënien e gjuhëve të tjera të specialitetit. Në përmbushje të sugjerimeve dhe modeleve të sjella, nxënësit gradualisht fitojnë pavarësi të plotë dhe aftësohen të hartojnë dhe të shkruajnë në mënyrë profesionale.

### ➤ Aftësia për të prezantuar një relacion

Edhe prezantimi i një relacioni apo detyre të caktuar kërkon zotërimin e aftësive të veçanta, të cilat mund të fitohen nëpërmjet udhëzimeve didaktike të posaçme.

Kështu, si **hap të parë** nxënësit duhet të strukturojnë argumentin. Mund të shtrohen pyetjet: **Cfarë duhet apo çfarë duhet** një dëgjuesit për argumentin e zgjedhur? Sa informacione të reja duhet të marrin ata?

**Së dyti**, përcaktohet qëllimi i prezantimit. (*Cila është pika më e fortë dhe më e rëndësishme që duhet të kuptohet?*)

**Së treti**, është e nevojshme përgatitja e një skalete sintetike, e cila të përfshijë çështjet kryesore dhe ato mbështetëse të saj. Për këtë, duhet të përzgjidhen informacione të vlefshme mbështetëse. (*Cilat informacione mbështesin më mirë çështjen kryesore? Cilat informacione mund të tërheqin më shumë vëmendjen e dëgjuesëve?...*)

**Së katërti**, duhet zgjedhur një strukturë e përshtatshme për prezantimin. Për shembull, në rastin kur duhet të përshkruhet një eksperiment, mund të zgjidhet skema e mëposhtme: hyrja, materialet, procedurat, rezultatet, diskutimet.

**Së pesti**, zgjedhja e instrumentave ndihmës audiovizivë të përshtatshëm, të cilat ndikojnë në tërheqjen e vëmendjes të dëgjuesëve, pasqyrojnë më lehtësisht argumentet e paraqitur dhe lehtësojnë kuptimin e tyre.

Përgatitja e pjesës hyrëse është mjaft e rëndësishme, pasi dëgjuesit kanë mundësinë të njihen që në fillim me informacionet thelbësore, për të kuptuar argumentin, i cili do të trajtohet. E duke qënë se gjuhët e specialitetit karakterizohen nga përkufizime të shumta, është i rëndësishëm shpjegimi i tyre që në hyrje të prezantimit.

Pjesa përmblyëse, duhet të risjellë në mënyrë të përmbledhur elementët kryesorë për të arritur në përfundime, duke lënë një argument për t'u trajtuar në një moment të dytë, ose e thënë në mënyrë figurative, duhet të mbyllet një derë, por të hapet një dritare.

Pasi jepen këto udhëzime, lidhur me përvetësimin e aftësive, në përfundim të tyre mësuesi në klasë mund të zhvillojë veprimtari, të cilat nxisin përdorimin e disa shprehjeve të tilla të përdorura zakonisht gjatë prezantimeve si: *Diskutimi im lidhet me ....., Fillimisht kam trajtuar.....; Në lidhje me pikën e pare..... etj.*

Përvetësimi i aftësive të mësipërme, për studimin e gjuhëve të huaja të specialitetit është i domosdoshëm për të arritur qëllimin final: përvetësimin e kompetencës në komunikimin e specializuar, të cilën do ta analizojmë në çështjen në vijim.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## IV.3. Studime teorike mbi komunikimin e specializuar: përqsasja pragmatike dhe sociolinguistike

Komunikimi është një ndër termat me të cilën përcaktohet shoqëria aktuale. Shpejtësia e komunikimit vë bashkë gjithë botën, në kohë reale, me pasoja të rëndësishme në të gjithë sektorët: nga informacioni tek argëtimi, nga turizmi tek kultura, nga politika tek financa. Sigurisht një risi e tillë e mjeteve dhe mundësive nuk mund të mos krijojë ndryshime në mënyrën e të jetuarit dhe të të menduarit. Dhe këtu çështja zgjerohet në territorë të pakufijshëm.....

Komunikimi konsiderohet si një formë veprimi që zbatohet përmes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar. Në kreun e parë të këtij punimi, përcaktoam komunikimin e specializuar, si një ndër kriteret për të diferencuar gjuhën e zakonshme nga gjuhët e specialitetit. Si rrjedhojë, dhe komunikimi i zakonshëm ndryshon ndjeshëm nga komunikimi i specializuar. Le të mendojmë, për shembull, përdorimin e termit *laringit* dhe shprehjes *dhimbje fyti*, në gjuhën mjekësore Që të dyja presupozojnë të njëjtin kuptim, por përdorimi i termit të parë, ngrre nivelin e komunikimit, ndërsa fjala e dytë është tipike e gjuhës së folur. Komunikimi i specializuar përforcon në këtë mënyrë statusin shoqëror të një personi në një situatë të caktuar.

Shtrojmë pyetjen: Cilët janë kriteret për një komunikim të specializuar?

**Saager**<sup>60</sup> kur i referohet komunikimit të specializuar përmbledh tre kriteret:

- Qëllimi komunikues i folësit për të ndërhyrë mbi njohuritë e dëgjuesit;
- Kompetenca në një disiplinë të caktuar e folësit;
- Përdorimi i përbashkët i një kodi komunikues të specializuar.

Në këtë listë, kompetenca më e madhe e folësit është e pranishme në një situatë vertikale (eksperti që flet me jo ekspertin), por edhe në një situatë horizontale, (mes dy ekspertëve, në të cilët, njëri prej të dyve, mund të ketë kompetencë dhe njohuri më të gjera kundrejt tjerit lidhur me një tematikë të veçantë).

Komunikimi në gjuhë specialiteti duhet të karakterizohet nga parimet e **saktësisë**, (të cilat sjellin përdorimin e termave të saktë, në koherencë logjike, me mungesë emocioni), **të ekonomisë** (përmes përdorimit efikas të komunikimit dhe të strukturave të tij, optimizimit të aspekteve gjuhësore kundrejt densitetit të informacionit) dhe të **përshtatshmërisë** (pra përshtatje me kontekstin komunikues dhe me traditat disiplinore dhe socio-kulturore). Ndodh që jo gjithmonë këto parime funksionojnë paralelisht.

**Scarpa F.**<sup>61</sup> propozon katër parime themelore për një komunikim të specializuar efikas:

- Sasia (të kufizohet numri i informacioneve);

<sup>60</sup> Saager, Dungworth, McDonald, 1989, fq 52

<sup>61</sup> Scarpa F. *La traduzione specializzata. Lingue speciali e mediazione linguistica*. Fq. 20, Hoepli, Milano

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

- Relativiteti (të komunikohen informacione lidhur me situatën dhe qëllimin e dhënë);
- Modalitetet (qartësi dhe konkretësi për të mbrritur menjëherë në argumentin e trajtuar);
- Cilësi (të komunikohen informacione që i përkasin të vërtetës).

**Altieri Biagi**,<sup>62</sup> (1988), sjell një skemë të thjeshtë të komunikimit të specializuar, i cili nis me hipotezat, qëllimet, situatën e komunikimit (e përbërë nga rrethanat e vendit, kohës, nga statusi social, roli i aktorëve të komunikimit), kodin dhe kanalin e komunikimit mes dërguesit të mesazhit dhe marrësit të tij.

---


<sup>62</sup> Biagi A. (1988) në Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 58



**DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

**Tab. IV.2.**

Skema e komunikimit të specializuar sipas Altieri Biagi-it



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Vitet e fundit, studimet mbi komunikimin e specializuar, kanë ndryshuar drejtim, duke mbrojtur tezën se ka vend edhe për shprehje emocionale. Sipas Cortese G.<sup>63</sup> ndihet gjithnjë e më shumë tendenca për të argumentuar dhe për të bindur dëgjuesin, edhe në tekstet e specialitetit, pavarësisht se veçoria e tyre është objektiviteti. Ky fakt, vërtetohet edhe përmes një elementi gjuhësor në komunikimin e specializuar, sikurse janë metaforat, të cilat gjejnë përdorim në tipologji tekstuale të specialitetit, jo vetëm në shkencat humane, por edhe në ato të natyrës shkencore. Metafora është e pranishme në radhë të parë në nivelin leksikor, për t'i dhënë fjalës së gjuhës së zakonshme një kuptim të ri. Aspekti metaforik, dalëngadalë e humbet konotacionin e tij dhe termi fiton me kalimin e kohës një pozicion të vetin në disiplinën referuese. Për shembull: fjala e zakonshme *ponte (urë)* është shndërruar në term në gjuhën odontoiatrike, duke humbur cilësinë e metaforës, apo termi fjala '*navigare*', i përdorur në fushën e informatikës.<sup>64</sup>

Ky fakt, vërtetohet edhe nga teoritë e Lokoff G. dhe Jonson M.<sup>65</sup> (1982), sipas të cilëve, "*metafora nuk është thjesht një similitudë, një instrument i thjeshtë krahasimi, por lidhet me një proces konjitiv, gjatë së cilit vihen në lëvizje kuptime të reja mes koncepteve*".

Studimet mbi komunikimin e specializuar bazohen kryesisht mbi *pragmatikën gjuhësore*, pjesë e semiotikës, e cila studion raportet mes gjuhës dhe përdoruesit të saj, si dhe mbi *sociolinguistikën*, e cila studion raportet mes kushteve shoqërore dhe përdorimeve gjuhësore të folësve. Këto disiplina kanë krijuar kushtet për analizën e aspekteve thelbësore të komunikimit.

**Pragmatika gjuhësore** përcaktohet nga Carnap R. (1938),<sup>66</sup> si studimi i gjuhës kundrejt përdoruesëve të saj: studion analizën e veprimit gjuhësor mes aktorëve të komunikimit. Flitet për kompetencë pragmatike, atëherë kur folësi merr parasysh dimensionin e veprimit gjuhësor. Aspekti pragmatik është i lidhur pjesërisht me dimensionin e kuptimit, pra folësi është në gjendje të kuptojë dhe të përdorë shprehjet metaforike të gjuhës, duke ofruar një kontribut të qartë e të saktë, në mënyrë që komunikimi të jetë sa më konstruktiv dhe i kuptueshëm. Theksojmë se aspekti i kuptueshmërisë është i rëndësishëm në komunikimin e specializuar, kryesisht kur raportet janë jo të barabarta, pra mes ekspertëve dhe jo ekspertëve. Ndërsa, Andorno C. (2003) e shikon aktin gjuhësor si '*një shkëmbim marrëdhëniesh, në të cilin gjuha luan një rol përcaktues, së bashku me aspekte të tjera kulturore, sociologjike, dhe ky fakt lejon një përjasje ndërgjuhësore, ndërkulturore dhe ndërdisiplinare*'<sup>67</sup>.

Nga këndvështrimi **sociolinguistik**, të analizosh komunikimin e specializuar do të thotë të studiosh dimensionet, të cilat marrin në konsideratë, jo vetëm aktorët e komunikimit, por edhe kontekstin dhe funksionet komunikuese që e shoqërojnë atë.

<sup>63</sup> Cortese G. The imperfect Mediator. Sociocultural Awareness in Translating Specialist texts in "Textus. English studies in Italy" XXII 2 fq 341-143)

<sup>64</sup> Shembuj të tjerë gjenden në Shtojcën nr. 1, bashkangjitur këtij punimi.

<sup>65</sup> Lokoff G, Jonson M. në Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 76.

<sup>66</sup> Carnap R. *Foundation of logic and mathematics*, në O. Neurath, R.Carnap, C.W.Morris, *International encyclopedia of Unifield Science*, Vëll.1, Universiteti i Cikagos. Fq. 139.

<sup>67</sup> Andorno C. *Linguistica testuale, un'introduzione*, Carocci, Roma, 2003. Fq. 132.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Në analizën e komunikimit të specializuar, sipas përfaqjes sociolinguistike, dallohen dy boshte<sup>68</sup>:

- A. **Boshti horizontal** mbi të cilin pozicionohen disiplinat e ndryshme. Është e vështitë të thuhet sa është numri i tyre, pasi ato janë në zgjerim të vazhdueshëm, si përsa i përket rritjes së numrit të gjuhëve të specialitetit, ashtu edhe një specializimi gjithnjë e më të madh të disiplinës shkencore së cilës i referohen. Nga ana tjetër, lindja e gjuhëve të reja të specialitetit, sjell edhe mospërdorimin e gjuhëve të tjera, të cilat nuk janë më aktuale.
- B. **Boshti vertikal**, edhe më kompleks, pasi interpretimet e kërkimeve të kryera sjellim modele të ndryshme. Në boshtin vertikal 'lëvizin' aktorët e komunikimit.

Tabela e mëposhtme sjell analizën e komunikimit të specializuar sipas përfaqjes socio-linguistike:

**Tab. IV.2**

### Përfaqja socio-linguistike<sup>69</sup>

Aktorët e komunikimit	Tipologjitë tekstuale	Lloji i gjuhës
Ekspertë të një disipline	Monografi, artikuj revistash të specializuara	Nivel i lartë specializimi
Ekspertë – pak ekspertë	Manuale	Nivel i mesëm specializimi
Ekspertë-jo ekspertë	Tekste udhëzuese	Nivel i ulët specializimi

Pra, sipas përfaqjes socio-linguistike që të quhet komunikim i specializuar një ndër aktorët e komunikimit duhet të jetë eksperti i një fushe të caktuar.

Autorë të tjerë, teksa analizojnë komunikimin, në gjuhët e specialitetit bazohen mbi nivelin e specifikës së komunikimit. Kështu Freddi G.<sup>70</sup>, në vitet Shtatëdhjetë, flet

<sup>68</sup> Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 65

<sup>69</sup> Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 69

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

për katër nivele të komunikimit në gjuhë të specialitetit (*niveli i përshkrimit të përgjithshëm, niveli i përshkrimit specifik, niveli i formulimeve dhe niveli i formalizimit*).

Widdowson H.G (1979) dhe Gotti M. (1991)<sup>71</sup> propozojnë tre nivele: ekspozim shkencor (specialistë dhe jo specialistë), edukim shkencor (specialistë dhe ende jo specialistë), gazetari shkencor (specialistë dhe jo specialistë, me mbizotërimin e gjuhës së zakonshme).

Altieri Biagi<sup>72</sup> shton edhe një nivel më të lartë, i cili lidhet me formalizimin (prania e formulave matematikore, grafikëve), i konsideruar si më pak i afërt me gjuhën e zakonshme, por në të njëjtën kohë, më i qartë më i kuptueshëm, dhe pa keqkuptime. Ai sqaron se komunikimi në gjuhë specialiteti duhet të mbajë parasysh dy kërkesa themelore: atë didaktike, e cila siguron transmetimin e dijes dhe atë të kuptueshmërisë ndërdisiplinare, e cila bën të mundur transmetimin e njohurive në nivel zbatimesh teknike. Të dyja bashkë, sjellin domosdoshmërinë e përvetësimit të kompetencës së komunikimit të specializuar.

### IV.4. Përvetësimi i kompetencës së komunikimit në GJHS-it

Kompetenca është niveli më i lartë i njohurive: në të kombinohen aftësitë dhe njohuritë për të kryer një aktivitet. Zhvillohet ngadalësisht, por pasi formohet, është e qëndrueshme. Chomsky, ka futur në vitet Pesëdhjetë, në teorinë e tij, ndryshimin mes *kompetencës* dhe *performancës*. Sipas tij, kompetenca është sistemi i njohurive, rregullave, pra mekanizmave të funksionimit, të cilat bëjnë të mundur kuptimin ose prodhimin e frazave, edhe të padëgjuaara më parë, ndërsa realizimi i këtyre frazave të bazuara mbi kompetencën, quhet performancë. Këto dy koncepte duken se thërresin diktonominë saussuriana *langue versus parole*, por bëhet fjalë për një ngjashmëri sipërfaqësore: konceptet chomskyiane janë koncepte të psikolinguistikës, të cilat aplikohen tek folësi, individi, ndërsa ato saussuriane janë semiotiko-linguistike, të cilat i referohen mbarë komunitetit.

Termi “**kompetencë komunikuese**” është përdorur për herë të parë nga Dell Hymes, një antropolog amerikan, në vitin 1966. Në vazhdim janë kryer studime mbi fushën e komunikimit dhe të kompetencës së komunikimit.

---

<sup>70</sup> Freddi G. *Linee per una didattica delle microlingue nella scuola secondaria e nell'universita*, Aktet e Kongresit mbi “Le lingue di specializzazione e il loro insegnamento nella scuola secondaria e nell'Universita”, La Scuola, Brescia. Brescia 2-4 prill 1988.

<sup>71</sup> Cavagnoli, S. *La comunicazione specialistica*. Carocci, Roma, 2007. fq. 68

<sup>72</sup> Altieri Biagi M.L. *Aspetti e tendenze della lingua della scienza në AA.VV., Italiano di oggi. Lingua non letteraria e Lingue Speciali*. APE Mursia, Milano.1974. fq. 369

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Sipas Canale M. e Swain M.<sup>73</sup> kompetenca komunikuese konsiston në këto katër komponentë:

1. Kompetenca gramatikore: *fjalë dhe rregulla*;
2. Kompetenca socio-linguistike: *përshtatshmëria*;
3. Kompetenca ligjëruese: *kohezioni dhe koherenca*;
4. Kompetenca strategjike: *përdorimi i saktë i komunikimeve strategjike*.


Një studim i kohëve më të fundit, mbi kompetencën komunikuese, i kryer nga Bachman L. (1990), e grupon këtë të fundit në titullin e gjërë "*Kompetenca e organizimit*" e cila përfshin si kompetencën gramatikore dhe diskursive (ose tekstuale), ashtu edhe kompetencën pragmatike.

Balboni,<sup>74</sup> e sheh kompetencën komunikuese si një hapësirë brenda një piramide trefaqëshe të cilat konsistojnë në tre nivele:

1. Të njohësh gjuhën (*të kuptosh, të lexosh, të shkruash, të dialogosh*), pra të zotërosh kompetencat e duhura gjuhësore (kompetencën fonologjike, grafike, morfo-sintaksore, leksikore dhe tekstuale).
2. Të dish të veprosh me gjuhën (*përfshihet dimensionin social, pragmatik dhe kulturor*).
3. Të njohësh aspektet formale të kodit të gjuhës (*elementët jashtëgjuhësorë*)

Fig. IV.1

### Piramida si metaforë e kompetencës komunikuese



<sup>73</sup> Canale M, Swain M. *Theoretical bases of communicative approaches on second language teaching and testing*. Aookied Linguistics 1, 1980. Fq.45-46,

<sup>74</sup> Balboni P. *Le microlingue scientifico-professionali, Natura e Insegnamento*. Fq. 18

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Përtej studimeve teorike, në kontekstin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit, komunikimi është mjaft i rëndësishëm. Mësimdhënia gjuhësore në funksion të rritjes së kompetencës komunikuese është bërë më e theksuar vitet e fundit, sidomos aty ku nevojat e nxënësve janë qartësisht të përcaktuara në një fushë të caktuar akademike. Sot, përvetësimi i gjuhës së huaj është i orientuar drejt aftësive komunikative dhe ndërvepruese, që do të thotë të mësuarit e gjuhës ashtu sikurse flitet dhe përdoret në vendet e origjinës. Komunikimi dhe mësimdhënia përbëjnë një binom të pazgjidhshëm.

Në vijim po analizojmë më specifikisht mënyrat se si përvetësimi i aftësive gjuhësore të nxënësve, për të cilat folëm në çështjen e parë të këtij kapitulli, zbatohet në situata komunikuese, referuar disiplinave të ndryshme shkencore-profesionale, duke realizuar përvetësimin e kompetencës së komunikimit.

Në kontekstin e mësimdhënies, komunikimi është esenca e veprimit didaktik. Nëse do t'i referoheshim termit në gjuhën italiane, '*comunicare*' do të thotë '*të vendosësh bashkë*', pra të vendosësh së bashku për ide të përbashkëta, mendime, njohuri apo koncepte. Duke u zhvendosur në auditorë, gjatë veprimtarive didaktike, ky komunikim përdor emocionet, marrëdhëniet, mënyrat e ndryshme të të reflektuarit dhe të të komunikuarit, si nga ana e mësuesit, ashtu edhe nga ana e nxënësve. Alternativa e vetme është pikërisht mungesa e komunikimit.

Ç do komunikim lind nga qëllime e nevoja të qarta dhe shfaq funksione specifike. Ç do mësimdhënie gjuhësore e finalizuar me përdorimin komunikues të gjuhës është dhe duhet të jetë një mësimdhënie '*për qëllime të veçanta*', ku në qëndër të procesit të mësimdhënies-mësimnxënies vendoset nxënësi, nevojat dhe motivimet e tij.

Në kontekstin e mësimdhënies të gjuhëve të specialitetit flasim për komunikim juridik, komunikim mjekësor, komunikim turistik, komunikim tekniko-shkencor, komunikim ambiental, komunikim didaktik, komunikim politik, komunikim ndër-institucional, e të tjera të lidhura me fusha të caktuara të interesit. Kuptimi i komunikimit në gjuhët e specialitetit duhet të jetë ai i transmetimit të një mesazhi në mënyrën sa më të qartë të mundshme. Shpesh, në ndihmë të saktësisë, dhe kjo vlen më shumë për gjuhët e disiplinave ekzakte, janë edhe simbolet, prezantimet grafike, diagramat, figurat, të gjithë elementët jashtëgjuhësorë, të cilat lehtësojnë organizimin e mendimit. Disiplina e specialitetit prodhon një përfaqje thelbësore në formimin e kompetencës gjuhësore, përmes veçorive që mbartin këto gjuhë të specialitetit (të trajtuara në kreun e dytë), por edhe përmes një ballafaqimi të pare, mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhës së specialitetit, ku nxënësit i kërkohet jo thjesht zbatimi i rregullave gramatikore, dhe i një leksiku të specializuar, por edhe aftësia për t'i përdorur këto mekanizma në komunikim. Ndodh që gjatë mësimdhënies, theksi vendoset tek ato elementë që shënojnë ndryshimet me gjuhën e zakonshme. Këto aspekte, sigurisht janë të rëndësishme, por ato nuk duhet të përdoren si qëllim në vetvete. Rreziku i përdorimit të kësaj metode, mund të jetë prezantimi i listave të termave, apo frazeologjive që u përkasin fushave leksikore të ndryshme. Nxënësit duhet të ndërgegjegjësohen se komunikimi është një proces i cili realizohet jo përmes një bashkim termash të veçanta. T'u japësh nxënësve repertorë të ngurtësuar, qofshin ato të përbëra nga rregulla gramatikore apo nga akte komunikative, nuk është e mjaftueshme dhe as e përshtatshme për të nxitur zhvillimin e strategjive dinamike, të

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

nevojshme për procesin e komunikimit. Kjo i pengon nxënësit të fitojnë aftësinë e të shprehurit në mënyrë të pavarur. Është e rëndësishme pra, që nxënësit të mësojnë gjuhën e huaj të specialitetit, duke e përdorur atë në situata nga më të ndryshmet, ku të gjithë japin prurjet e tyre. Të mësosh të komunikosh do të thotë të mësosh të interpretosh, të negociosh, të zgjidhësh probleme konceptuale dhe komunikuese, më shumë sesa të fitosh një trup njohurish të shtjelluara dhe të përcaktuara.

Realizimi praktik i një mësimdhënieje, ku objektivat gjuhësorë luajnë rolin e mbështetësit të veprimtarive informuese e kulturore e vë gjuhën në pozicionin e saj të natyrshëm, atë të mjetit të komunikimit dhe krijimit të bashkësive gjuhësore dhe ndërgjuhësore që kanë se çfarë të shkëmbejnë ndërmjet tyre. Nga ana tjetër, kompetenca komunikuese nuk mund të përcaktohet si një njohje e thjeshtë e rregullave gjuhësore, por kërkon ndërgjegjësimin për zbatimin e tyre dhe zotërimin e kompetencave të caktuara të natyrës pragmatike. Këto kompetenca përvetësohen më lehtësisht nëse nxënësit përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në procese ndërveprimi mes tyre. Kur flasim për ndërveprimin në klasë, kemi parasysh raportet që vendosen dhe zhvillohen përmes përdorimit të fjalës.

Breen M.P. dhe Candlin C.N.,<sup>75</sup> në studimet e tyre lidhur me kompetencën komunikuese nënvizojnë rëndësinë e tri aftësive kryesore komunikuese: **interpretimi**, **shprehitë** dhe **negocimi**. Në fakt, me qëllim pjesëmarrjen në një proces komunikativ, aktorët e komunikimit, në rastin tonë nxënësit, duhet të jenë në gjendje të interpretojnë saktësisht mesazhet e të tjerëve dhe, të shprehin po aq qartësisht, mesazhet e tyre. Këto procese interpretuese dhe shprehëse duhet të përfshijnë edhe momente *negocimi* mes pjesëmarrësve në komunikim. Kjo, realizohet përmes veprimtarive didaktike, të cilat synojnë nxitjen e debateve, dhënien e pikëpamjeve të ndryshme, edhe në rrafshin krahasues. Këto veprimtari, kërkojnë përdorimin e disa aftësive të karakterit konjitiv dhe gjuhësor. Ajo që duam të nënvizojmë është se nxënësit duhet të mësohen të komunikojnë në mënyrë sa më të qartë, duke përbushur edhe kriterin kryesor të komunikimit në gjuhë specialitetit.

Balboni P.E.,<sup>76</sup> ofron disa mekanizma gjuhësorë të rëndësishëm për komunikimin e specializuar. Ai sjell një model, të cilin mësuesit mund ta përshtasin dhe t'i nxisin nxënësit e tyre për një përdorim gjatë akteve komunikuese. Siaps Balbonit, në një komunikim të specializuar, fjalitë duhet të shprehin njohuri deklaruese dhe njohuri procedurale. Le t'i shpjegojmë më hollësisht.

Njohuritë deklaruese realizohen në fjali, apo sekuenca fjalish të llojit:

*“Ky është një studim glotodidaktik”. “Glotodidaktika është shkencë që.....” ose “Një tekst shkencor ka veçori formale tipike”.*

Njohuri procedurale realizohen përmes bashkimit të disa fjalive deklaruese. Për shembull:

<sup>75</sup> Breen M.P.dhe Candlin,C.N. *The essentials of a Communicative Curriculum in language Teaching*. 1980. Fq. 80-112.

<sup>76</sup> Balboni P. *Le microlingue scientifico-professionali, Natura e Insegnamento*. Fq. 20

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

*“Nëse ky është një tekst glotodidaktik (fjali e parë) dhe nëse glotodidaktika është një shkencë (fjalja e dytë), atëherë ky është një tekst shkencor, (sinteza 1+2) dhe si ti tillë ka veçori formale tipike”.*

Sikurse rezulton nga shembulli i mësipërm, lloji i njohurive dhe i raporteve që përcaktohen mes koncepteve, identifikohen përmes formave gjuhësore.

Njohuritë deklaruese janë zakonisht fjali të thjeshta, ndërsa njohuritë proceduriale janë deklarata të bashkuara nga lidhëza nënrenditëse të llojit shkak-pasojë: *nëse....atëherë...*

Mbi bazën e këtij shembulli të sjellë nga Balboni, mund të zhvillohen disa veprimtari duke i orientuar nxënësit të përdorin modelin e mësipërm. Nëse është vendosur objektivi final i përvetësimit të kompetencës komunikuese, kjo kërkon zbatimin e veprimtarive didaktike dhe përdorimin e materialeve specifike që zhvillojnë këtë kompetencë.

Në radhë të parë, mësuesit duhet t’u mësojnë nxënësve të shprehën dhe të komunikojnë një një gjuhë që, edhe duke ruajtur spontaneitetin të plotë, të jetë e qartë dhe e saktë. Në veprimin e komunikimit, dëgjuesi duhet, jo vetëm të kuptojë partnerin folës, por edhe të zbulojë synimin parësor të bashkëfolësit, pra të kuptojë edhe të pashprehurën. Kjo mund të arrihet, për shembull gjatë veprimtarive të dialogut ku theksi vendoset tek intonacioni, koherenca tekstore, pauza, kohezioni, përsëritja funksionale. Kështu, në gjuhën e huaj të mjekësisë mund të përshtaten dialogje mes mjekut dhe pacientit, ku krahas termave mjekësorë vihet theksi edhe tek regjistri i komunikimit. Në gjuhën e huaj ekonomike mund të përshtaten dialogje mes klientit dhe punonjësit të një banke ku synohet të përforcohet kompetenca e komunikimit përmes përvetësimit të leksikut të specializuar. Po kështu edhe dialogjet mes një klienti dhe agjensie turistike e kështu me radhë. Nxitja e shkëmbimeve të opinioneve dhe mendimeve në klasë nga ana e mësuesit është një ndër parimet kryesore të metodës komunikuese. Kjo mund të realizohet duke shpërndarë në klasë materiale të përzgjedhura jashtë tekstit, ku nxënësit ftohen të diskutojnë dhe të komunikojnë në grupe mbi informacionet e marra.

Për forcimin e kompetencës komunikuese, me interes janë edhe orët laboratorike, ku nxënësve përmes videove apo audiove u prezantohen situata komunikuese apo argumentuese, gjatë të cilave ata marrin shënime dhe memorizojnë shprehjet e përdorura në dialogje, apo vënë në dukje elementë të një modeli të ri sjelljeje. Pas kësaj veprimtarie ata diskutojnë në klasë. Ky lloj aktiviteti, jo vetëm i lejon mësuesit të vlerësojë aftësinë gjuhësore të nxënësit, por i nxit këta të fundit për t’i vënë në përdorim këto aftësi, në funksion të kompetencës së komunikimit, duke përvetësuar njohurië të reja përmes komenteve dhe shpjegimeve.

Një metodë tjetër efektive, në funksion të kompetencës së komunikimit, është edhe përvetësimi i shprehjeve të ndryshme, të cilat përdoren përgjithësisht gjatë diskutimit të një argumenti në një disiplinë specialiteti të tilla si: ndërprerja e relatorit, të kërkuarit sqarime apo përsëritje, formulimi i dyshimeve apo kritikave, paraqitja e një argumenti kundërshtues etj. E rëndësishme është që këto shprehje të përdoren në mënyrë spontane, gjatë fazës kur nxënësit ftohen të diskutojnë mbi një tekst argumentues të dhënë. Më specifikisht, për rritjen e kompetencës së komunikimit në gjuhët e specialitetit, nxënësit



## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

duhet të aftësohen që në aktivitetin e tyre me shkrim apo me gojë të jenë të pranishme: krahas konceptit/përkufizimi, krahas problemit/zgjidhja, krahas krahasimit/dallimi, krahas shkakut/ pasoja, krahas propozimit/mbëshetja argumentuese, krahas qëllimit/veprimi dhe së fundmi nxjerrja e përfundimeve.

Këto veprimtari mund të zhvillohen sipas metodave të diferencuara punë: në nivel global (e tërë klasa), në grup, në çift apo individualisht. Ato duhet të përfshijnë aftësi të integruara (me shkrim, me gojë). Gjithashtu sugjerojmë, që duke u nisur nga veprimtari didaktike të ndryshme, elementë të caktuar komunikimi, të rimerren dhe të shërbejnë si shtysë për veprimtari të tjera në funksion të komunikimit.

Një veprimtari pedagogjike, e përshtatshme për nxitjen e komunikimit janë edhe ato lidhur me situata që kërkojnë zgjidhjen e problemit (*problem-solving*), në të cilat nxënësit nxitën nga mësuesit të përdorin gjuhën dhe njohuritë e zotëruara për zgjidhjen e situatave problematike. Në këtë mënyrë, nevojat komunikuese kërkojnë një përdorim të gjerë të burimeve gjuhësore dhe e shtyjnë nxënësin që të zhvillojë strategji për plotësimin e nevojave të komunikimit, pavarësisht burimeve të kufizuara. Mendojmë, se përveç këtij fakti, këto veprimtari kanë edhe një efekt socializues, pasi nxisin në klasë frymën e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke. Çdo grup mund të identifikohet duke analizuar situatat në të cilat përdororet gjuha.

Por, në mësimdhënien e gjuhëve të huja në përgjithësi, por edhe të gjuhëve të specialitetit në veçanti, aftësitë komunikuese të nxënësit, të shpjeguara në këtë kapitull, relacionohen me kulturën e gjuhës, objekt i studimit. Për këtë arsye, është mjaft e rëndësishme që kompetenca komunikuese të ndërthuret me kompetencën ndërkulturore në mënyrë që të menaxhohen ngjarje komunikuese, ku pjesëmarrësit kanë një aset kulturor të ndryshëm.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## KREU V

### DIMENSIONI NDËRKULTUROR NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT

#### V.1. Mësimdhënia ndërkulturore e gjuhëve të huaja

Në erën e globalizmit, komunikimi mes kulturave të ndryshme merr një rëndësi gjithnjë më të madhe: shfaqet në nivel lokal, me një shoqëri gjithnjë e më shumë multikulturore, në nivel rajonal, me institucionet dhe bashkëpunimet multinacionale, në fushën ndërkombëtare, me organizatat trans-kontinentale-botërore, por së fundmi edhe në cyberspaces. Pluralizmi kulturor është kthyer në një realitet të shoqërisë sonë bashkëkohore. Mënyrat tradicionale e të menduarit të kulturës, duke iu referuar grupeve specifike të një territori të caktuar, tashmë janë të tejkaluara. Kulturat konsiderohen të ndërlidhura mes tyre dhe u nënshtrohen një ndikimi reciprok, ku misioni i komunikimit ndërkulturor duhet të jetë pikërisht favorizimi i kohezioni social.

Të hysh në një perspektivë ndërkulturore, do të thotë të mos braktisësh vlerat e tua, por të njohësh të tjerët, të tolerosh ndryshimet, të respektosh diferencat: pra të ndërveprosh mes kulturave të ndryshme, duke zgjedhur me ndërgjegje modelet komunikuese dhe kulturore. Nëse do t'i referoheshim metaforës informatike të Hofstede G.<sup>77</sup> *“komunikimi ndërkulturor duhet të shoqërojë dhe favorizojë ndërtimin e një bote perfekte, ku jo të gjithë kanë Windows, Macintosh apo Unix, por ku secili ka sistemin e vet operativ, që preferon apo që ekziston në kompiuterin e tij dhe kjo, nuk i krijon asnjë vështirësi për t'u lidhur me të tjerët”*.

Komunikimi ndërkulturor, si sektor i kerkimit shkencor, nuk mund të vlerësohet për një traditë të gjatë, edhe pse në Teteqintën, antropologia, etnologia, filozofia historike dhe historia e artit përdornin termin *Kulturë*. Që në vitin 1880, diskutohej në fushën e antropologjisë mbi procesin e shpërjes së kulturës së minorancave sociale dhe përdorimi i saj në komunitete më të gjera. Në fillim të viteve Pesëdhjetë të Nëntëqintës, gjuhësia strukturaliste nisi studimin e faktorëve kulturorë, si komponentë të dukshëm në analizën gjuhësore të një idiomë, edhe pse kultura konsiderohej një element shtesë kundrejt konceptimit të gjuhës.

Një tematizim i qartë i komunikimit mes kulturave realizohet vetëm në fillim të viteve Gjashtëdhjetë. me modelin semiotik të etnologut Edward T. Hall mbi analizën e një kulture, sipas së cilës, ndërveprimi komunikues shoqërohet nga treguesë aluzivë (psh: toni i zërit, shprehja e fytyrës, veshjet, qëndrimi etj), të cilat nuk janë vetëm mbartës të informacioneve të karakterit formal apo teknik, por edhe të informacioneve të fshehura.

---

<sup>77</sup> Hofstede G. *Cultures and Organisations: Software of the mind*, McGraw-Hill. Fq. 230-231

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Sipas këtij autori, qëniet njerëzore udhëhiqen nga dy forma informacionesh tek të cilat mund të kenë akses në dy mënyra të ndryshme: ajo e kulturës së shfaqur, e cila kuptohet përmes fjalëve dhe numrave, dhe ajo e kulturës së fituar në heshtje, e cila nuk është verbale, por fortësisht situacionale. Gjuha jo verbale, apo siç e quan ndryshen Hall 'dimensioni i fshehur', ka një rëndësi të veçantë në komunikimin mes kulturave të ndryshme, dhe nëse interpretohet gabimisht ose jo plotësisht, mund të sjellë keqkuptime, madje të rënda.

Në konceptin e kulturës ndërveprojnë disa variable, të cilat e bëjnë atë një model multidimensional, të interpretueshëm nga pikëpamje dhe perspektiva të ndryshme. "Kultura konsiderohet si një softwar i mendjes njerëzore, një sistem i përpunimit të stimujve dhe e ndryshueshme me vlera, sjellje, ligje tipike të një sistemi të caktuar."<sup>78</sup>

Studimet mbi komunikimin ndërkulturor i referohen edhe njohjes të stileve të komunikimit dhe të rregullave të ndërveprimit. Komunikimi ndërkulturor ka në qendër një relacion "face-to-face" midis qënieve njerëzore por, njëkohësisht kërkon një njohje të thelluar të tipareve kulturore të grupeve të ndryshme të përkatësisë. Fitimi i aftësive dhe shprehive të komunikimit ndërkulturor kalon përmes tre fazave:<sup>79</sup>

- ndërgjegjësimi (të qënurit të ndërgjegjshëm se të tjerët kanë një softwar mendor të ndryshëm);
- Njohja (duhet të njihen kulturat e tjera për të ndërvepruar);
- Aftësitë (të fituara nga ndërgjegjësimi, së bashku me njohjen dhe përvojën personale).

Gjithshka nis pra me *ndërgjegjësimin* se seicili mban me vehte një veçori *softwar* mendore, e cila buron nga ambienti ku ai ëshë rritur dhe se ata të cilët kanë lindur në kushte të tjera, kanë për të njëjtat arsye, një *softwar* të ndryshëm mendor. Ndërgjegjshmëria është aftësia për të vendosur lidhje midis kulturës së origjinës dhe kulturës së huaj.

Vijon *njohja*: nëse duhet të ndërveprojmë me kultura të tjera, duhet të mësojmë se si janë këto këto kultura, cilat janë simbolet dhe rritoret e tyre, sa është e pranishme ndjeshmëria ndaj nocionit kulturë dhe cila është aftësia për të njohur dhe përdorur strategji të ndryshme në vendosjen e kontaktit me individë të kulturës tjetër.

Aftësia për të komunikuar mes kulturave buron nga ndërgjegjshmëria, nga njohja dhe nga *përvoja personale*.

Siç dihet, kultura dhe shoqëria ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm në jetën njerëzore. Halliday,<sup>80</sup> i cili u formua në shkollën e londineze të Firthit shprehet: "Ka dy perspektiva themelore lidhur me gjuhën: njëra intra-organike dhe tjetra inter-organike. Në perspektivën intra-organike konsiderohet gjuha si diçka që ndodh në mendjen e individit, në atë inter-organike gjuha është diçka që ndodh mes njerëzve".

<sup>79</sup> Hofseide G. *Cultures and Organisations: softwar of the mind* në Balboni P. *Le microlingue scientifico-professionali, Natura e Insegnamento*. Fq. 25

<sup>80</sup> Halliday M.A.K. *Il linguaggio come semiotica: un'interpretazione sociale del linguaggio*, Zanichelli, Bologna, 1983. Fq. 75.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Sot këto dy perspektiva plotësojnë njëra - jetrën, dhe mendojmë se gjuhësia është në gjendjen më të mirë të shëndetit të saj kur i konsideron seriozisht të dyja perspektivat.

Koncepti ndërkulturor kërkon që të njihet barazia e të drejtave dhe vlerave, në kuptimin e një të vepruari komunikues, përmes një dialogu larg dominimit dhe ndërvarjes mes interlokutorëve, dhe me mirëkuptim reciprok. Takimi me kulturën e huaj duhet të sjellë një afrim të ndërgjegjshëm me diversitetin. Gradualisht kalohet nga një ndërgjegjësim i ndryshimeve kulturore, në një pranim e një përshtatje gjithnjë e më të hapur ndaj sjelljeve dhe vlerave të ndryshme, duke u pozicionuar në botën e një kulture tjetër dhe, duke u shprehur në mënyrë koherente me kulturën e tyre. Giaccardi C. e konsideron kulturën si një “*terren i shumëllojshëm, mbi të cilin ndeshen edhe interesa e mendime të kundërta, një terren me procese negociatash të vazhdueshme.*”<sup>81</sup>

Njohja e elementëve teorikë të komunikimit ndërkulturor shërben si bazë mbi të cilën zhvillohet dhe zbatohet mësimdhënia ndërkulturore. Në vijim po analizojmë specifika të mësimdhënies në funksion të përvetësimit të kompetencës së komunikimit ndërkulturor.

Pasi kemi sjellë një panoramë të përgjithshme të natyrës teorike mbi komunikimin ndërkulturor dhe rëndësisë së tij, po e ngushtojmë analizën në kontekstin e mësimdhënies ndërkulturore të gjuhëve të huaja. Meqënëse procesi didaktik përbëhet nga dy aktorë: mësuesi dhe nxënësi, kjo analizë përfshin mësimdhënien ndërkulturore nga njëra anë dhe përvetësimin e kompetencës ndërkulturore nga ana tjetër, si dy pjesë të pandashme të së njëjtit proces.

Sikurse e kemi trajtuar në kapitujt paraardhës, didaktika e gjuhëve të huaja sot i nënshtrohet kërkesave, synimeve dhe perspektivave të reja. Konceptimi i gjuhës së huaj, i kuptuar si një sistem nocionesh leksikore, gramatikore dhe fonetike, është tashmë i zbehur. Shumë mësues, të cilët për vite e kanë konsideruar komunikimin në një gjuhë të dytë si një transmetim të mirëfilltë të koncepteve, kanë përqaftuar vizionin komunikues-kulturor të mësimdhënies. Përveç aftësive komunikuese që lejojnë të përmbushen aktet gjuhësore, fitohet gradualisht edhe kompetenca ndërkulturore, duke krijuar në këtë mënyrë atë që quhet kompetencë komunikuese ndërkulturore.

Sot, në politikën evropiane të gjuhëve, ndërgjegjësimi ndërkulturor dhe aftësitë ndërkulturore, përcaktohen si kompetenca themelore për mësimin dhe përvetësimin e gjuhëve të huaja, sikurse referohet në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët,<sup>82</sup> dhe mund të konsiderohet si aftësia e pestë, pas aftësisë të të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Në mësimdhënien gjuhësore, kjo mund të arrihet nëse në mënyrë të ndërgjegjshme kuptojmë se si aftësitë komunikuese të nxënësit duhet të relacionohen me kulturën e gjuhës, objekt i studimit.

Në fakt, ndërsa kompetenca komunikuese, sikurse e trajtuam më lart, konsiston në aftësitë për të realizuar në mënyrë spontane aktet gjuhësore, kompetenca ndërkulturore është aftësia për të manaxhuar ngjarje komunikuese, ku pjesëmarrësit kanë një aset

<sup>81</sup> Giaccardi C. *La comunicazione interculturale*, Il Mulino Bologna 2005. Fq. 22

<sup>82</sup> Këshilli i Evropës. *Kuadri i Përbashkët evropian i referencës për gjuhët*. Filara 2006 (varianti shqip).


## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

ekzistencial të ndryshëm, për të toleruar ambiguitetin dhe për të zhvilluar relativitetin kulturor. Në analizën e komunikimit nuk mund të lihet pas dore kultura, e cila përbën skeletin e ligjërimit shoqëror. Gjuhëve të huaja u takon pra një rol vendimtar në procesin e komunikimit, që synon mirëkuptimin reciprok mes kulturave të ndryshme, duke kaluar jo thjesht kufijtë gjuhësorë, por edhe barrierat kulturore. Përmes gjuhëve të huaja nxënësit duhet të mësojnë të shikojnë realitetin me sytë e të huajit dhe sipas modeleve kulturore së cilës gjuha e huaj i referohet.

Nga sa shpjeguar më lart, duket e qartë se njohja e gjuhës nuk është e mjaftueshme për të komunikuar, duke iu përshtatur situatës. Shpesh problemet dhe vështirësitë në komunikim burojnë nga një mosndarje kulturore të riteve, traditave, qëndrimeve. Në qendër të komunikimit ndërkulturor janë aktorët e komunikimit, njerëzit, të cilët interpretojnë dhe eventualisht ndryshojnë besimet dhe paragjykimet.

Weidenhiller U. sjell një model tridimensional të kompetencës ndërkulturore e cila përbëhet nga tre marrëdhënie të ndërvarura mes tyre e që mund të gjejnë zbatim në didaktikën ndërkulturore. Ai shpjegon më tej se *'Funksioni komunikues lidhet me aftësinë për një sjellje komunikuese të përshtatshme, jo vetëm me situatën, por edhe me pjesëmarrësit në një ngjarje të caktuar.'*<sup>83</sup>

**Figura V.1.**  
**KOMPETENCA NDËRKULTURORE**



Kompetenca ndërkulturore duhet të kuptohet pra, si aftësi për një përshtatje konjiktive, afektive dhe operative e një individi, kundrejt çdo situatë komunikuese ndërkulturore. Është e rëndësishme aktivizimi i të gjitha kompetencave, të cilat vetëm pjesërisht gjenden në kontekstin gjuhësor dhe shoqëror.

<sup>83</sup> Weidenhiller U. La competenza interculturale, Roma, Carocci. Fq 209-226

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Në praktikën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja, kultura futet në brendësi të tematikave lidhur me qytetarinë, por edhe me informacione stereotipe.

Mësimdhënia/mësimnxënia ndërkulturore duhet të synojë të nxisë tek nxënësit hëmpatinë, tolerancën kritike dhe aftësinë për të përballuar situata konfliktuale, ardhur si pasojë e keqkuptimeve ndërkulturore, duke lejuar në njohjen e një kulture të re dhe në të njëjtën kohë duke parë kulturën mëmë si një perspektivë e ndryshme.

Në vijim, po sjellim disa aspekte gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, të cilat shkaktojnë keqkuptime në komunikim. Mosnjohja e tyre e bën më të vështirë komunikimin midis individëve, të cilët u përkasin kulturave të ndryshme.

### **V.1.1. Vështirësitë e komunikimit ndërkulturore**

Ndryshimet kulturore provokojnë jo thjesht keqkuptime, por tension mes grupeve të folësve dhe mes folësve të veçantë. Keqkuptimi është një incident komunikativ, të cilin shpesh aktorët nuk e vënë re, të paktën jo menjëherë, i cili shkaktohet nga korniza referimi të ndryshme, lidhur me aspekte gjuhësore dhe jo gjuhësore. Le t'i analizojmë këto aspekte, me qëllim që në procesin e mësimdhënies ndërkulturore të mbahen parasysh nga mësuesi, gjatë zhvillimit të veprimtarive didaktike.

- Aspektet gjuhësore
- Aspekte pragmatike
- Aspekte jashtëgjuhësore

Përveç këtyre aspekteve, pengesë në komunikimin mes kulturave të ndryshme janë edhe:

- Stereotipet
- Paragjykimet

#### **❖ Aspekte gjuhësore**

Ekzistojnë disa aspekte gjuhësore të cilat mund të shkaktojnë incidente ndërkulturore apo keqkuptime. Njohja e tyre, përbën në vetvete edhe një mundësi për t'i evituar e për të lehtësuar komunikimin me individë të një kulture tjetër:

#### **➤ *Zgjedhje leksikore***

Përtej problemit të përkthyeshmërisë të një termi nga njëra gjuhë në tjetrën, disa vështirësi ndërkulturore krijohen edhe nga zgjedhjet leksikore, pra me përzgjedhjen e një termi mes sinonimeve të tij dhe, në rastin e gjuhëve të huaja të specialitetit, në përcaktimin e saktë të fushës në të cilën disa terma duhet të përdoren.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Gjatë një bashkëbisedimi ndërkulturor, vështirësia lind kur folësi nuk është mjaftueshmërisht i ndërgjegjshëm për nivelin në të cilin vendosen fjalët që ai përdor si dhe për reagimet që ky fakt mund të shkaktojë tek dëgjuesi.

Përzgjedhja e fjalëve është mjaft delikate në çdo kulturë, kryesisht kur ka shkëmbime kulturore të karakterit shkencor dhe teknik. Këtu verifikohet një përplasje mes kërkesës së saktësisë së termave të perëndimorëve dhe një tolerancë më të madhe ndaj ambiguitetit të lindorëve.

Një element që tërheq vëmendjen është dhe përdorimi i titujve apo gradave si në komunikimin me shkrim, me gojë apo në formë elektronike. Gjuha italiane është shumë strikte dhe, përmes një akti normativ ka përcaktuar për çdo detyrë titullin përkates.

Në këtë drejtim, mund të themi se gjuha shqipe është më e pak e pasur me shumëllojshmërinë e këtyre titujve. Kështu, për të sjellë një shembull, në gjuhën italiane titulli, 'onorevole' përdoret në referim eskuziv të anëtarëve të Parlamentit apo të Senatit, ndërsa në gjuhën shqipe nuk e kemi këtë specifikë.

### ➤ *Aspekte morfosintaksore*

Duke përjashtuar problemin e ndryshimeve mes gjuhëve me një morfologji foljore shumë të pasur (sikurse gjuha italiane) dhe gjuhëve me një morfologji foljore të varfër (sikurse është gjuha kineze), do të veçonim përdorimin e kohës së ardhshme të mënyrës dëftore. Pa u thelluar në temën e konceptimit të kohës, mund të themi se interlokutorëve jo-perëndimorë mund t'u sjellë bezdi mënyra kaq e sigurt, me të cilën interlokutorët perëndimorë flasin për të ardhmen: *inshallah* thonë arabët dhe kjo nuk është thjesht një shprehje, siç mund të mendojnë evropianët, por i përgjigjet një nevojë fetare për faktin se e ardhmja është në dorë të zotit, asgjë nuk pohohet me siguri. "*Takohemi nesër*", mbyllet biseda mes perëndimorëve, me përdorim të foljes në kohën e ardhshme, pasi e ardhmja trajtohet sikur të ishte në zotërimin e tyre.

### ➤ *Struktura e tekstit*

Struktura e tekstit ndryshon nga njëra kulturë në tjetrën. Njohja e tyre përbën një sukses të dukshëm në komunikimin ndërkulturor. Le të sjellim modele të kulturave të ndryshme lidhur me strukturën e tekstit.

**Në kulturën anglosaksone**, tekstet janë më lineare. Përbëhen nga segmente fjalish të shkurtra, të radhitura njëra pas tjetrës, ku argumenti kryesor pasohet nga informacione ndihmëse, sipas strukturës: *koha, vendi (kryefjala+kallëzues) vendi, koha*. Maksimumi i përsosmërisë, për një folës të gjuhës angleze, i cili është duke prezantuar një produkt, ose një propozim organizativ, apo duke shkruajtur një relacion, sillet nga prania e disa fjalive të shkurtra e të qarta, të lidhura mes tyre përmes lidhëzave bashkërenditëse.

Për dëgjuesit jo-anglosaksonë, kjo lloj strukture, shpesh sjell përshtypjen e një thjeshtëzimi të tepruar, e si pasojë nuk vlerësohet aftësia konceptuale e folësit.

**Në kulturën latine**, (italiane, spanjolle, franceze etj), në strukturën e tekstit, ndryshe nga kultura anglosaksone, krijohen disa segmente fjalish paralele, të vendosura në një periudhë të gjatë, ku fjalitë lidhen përmes lidhëzave nënrenditëse. Kemi pra një strukturë me fjali të nënrenditura të shkallës parë.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Një strukturë e ngjashme, me kulturën latine shfaqet edhe në **gjuhën gjermane apo në gjuhët sllave**. Tekstet e natyrës argumentuese, në këto gjuhë, shkojnë nga një pikë A drejt një pike B, përmes ndërprerjes së argumentit kryesor me një apo disa argumente dytësorë. Grafikisht, kjo mund të paraqitet si një drejtëz e copëzuar, dhe kohezioni midis fjalive, krijohet përmes një sistemi kompleks përemrash, foljesh, me përdorime të kohëve dhe mënyrave të ndryshme. Kjo lloj strukture, e ndryshme nga kultura anglosaksone, i jep dëgjuesit amerikan apo anglez ndjesinë se ndodhet përballë një interlokutori të huaj, i cili kërkon të thotë shumë, pa shprehur asgjë. Paragjykimi shkon edhe më tej duke i perceptuar, se përdorin reticencë, pasi nuk shprehet ajo që mendohet.

Nga ana tjetër, edhe pse e njëjta strukturë tekstuale përdoret edhe nga gjermanët, këta të fundit, ndryshe nga latinët, perceptohen të 'bezdizshëm', përsa i përket strukturës së nënrenditur, por seriozë dhe të besueshëm.

Ky ndryshim strukturimi, pasqyrim i kulturave të ndryshme, ndihet në hartimin e teksteve në gjuhën angleze: në momentin kur një spanjoll, italian apo një gjerman flet dhe shkruan anglisht, ai përkthen termat e specialitetit me lehtësi, por mban të pandryshuar mënyrën e konceptimit për të ndërtuar një tekst: pra sjell në anglisht impiantin e tyre, ku mbizotërojnë fjalitë nënrenditëse, si dhe ndjen domnosdoshmërinë për përdorimin e dendur të përemrave (kryesisht atyre lidhorë), apo larminë e mënyrave dhe kohëve foljore, karakteristika morfosintaksore këto, të cilat gjuha angleze nuk i zotëron.

Duke u zhvendosur në auditorë, nxënësi, i cili është mësuar me një strukturë teksti të caktuar, kur ndeshet me një vendosje të ndryshme të informacioneve në tekst, gjen vështirësi. Nga praktika e mësimdhënies, janë të shpeshta rastet kur në një fazë të caktuar të nxënies, nxënësit tentojnë të transferojnë në punimet e tyre strukturën tekstuale të gjuhës mëmë: në sytë e mësuesit ata ngjajnë konfuzë, përsëritës, pasi në të vërtetë janë duke zbatuar rregullat tekstuale të gjuhës së tyre.

Veçoritë kulturore pasqyrohen ndjeshëm edhe në rrafshin socio-pragmatik në shkëmbimet komunikuese mes evropianëve dhe aziatikëve.

**Struktura e tekstit sipas modelit aziatik apo afrikan** prezantohet në formën e '*spirales*', pra tekstet nisnin me fjali të gjata dhe afrohen dalëngadalë drejt zemrës së bisedës. Ndryshe nga kulturat e mësipërme evropiane, këtu, struktura e një teksti nis nga periferia drejt qendrës, nga ajo që është më pak e rëndësishme tek bërthama e vërtetë informuese. Por, nga ky ndryshim i strukturës së tekstit, krijohen paragjykime të cilat e vështirësojnë ose e pengojnë komunikimin. Aziatikët apo afrikanët i konsiderojnë shpesh ofenduese tekstet në të cilat arrihet drejtëpërdrejtë në zemër të problemit, që nga ana tjetër është një vlerë anglosaksone. Kjo lloj strukture është e pakuptueshme për kë nuk vjen nga një kulturë aziatike.

Të gjitha këto probleme shtrohen në komunikimin e përditshëm, por më të ndjeshme janë në komunikimin e specializuar, pasi, sikurse e kemi shpjeguar, gjuhët e specialitetit janë pjesë e makrogjuhës.

### ❖ Aspekte pragmatike



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Përveç aspekteve gjuhësore, gjatë komunikimit ekziston një repertor i gjerë i strategjive dhe veprimeve, të ndryshme në kultura të ndryshme, aq sa mund të pengojnë komunikimin. Bëhet fjalë për ‘gabime’ pragmatike, atëhere kur thyhen rregullat komunikuese, shpesh në mënyrë të pandërgjegjshme. Këto *gabime* lidhen me elementë formalë/ jo formalë (përdorimi i përemrit të vetës së dytë njëjës në kontekst formal), mënyra e prezantimit, e falenderimit, e përshendetjes etj.

Po sjellim, në vijim, disa prej tyre:

- **Fjalitë pyetëse dhe fjalitë mohore:** çdo kulturë ka kodifikuar rregulla të ndryshme për të thënë ‘jo’ dhe për të kundërshtuar. Kur pyetja i bëhet një interlokutori kinez “*a e kuptuat*”? përgjigja është gjithmonë *po*, edhe pse mund të mos jetë e vërtetë, pasi përgjigja *jo* do të ishte një fyerje për folësin, i cili mendon se nuk e ka shpjeguar qartë.
- **Regjistri formal - informal:** ka një përdorim të ndryshëm të regjistrit formal dhe informal, në kultura të ndryshme, sikurse ka edhe rregulla të ndryshme për të caktuar kush vendos për të kaluar nga informalja në formale, dhe me cilat formula.

### ❖ Aspekte jashtëgjuhësore

Në komunikimin ndërkulturor merren në konsideratë edhe kodet jashtëgjuhësore, të cilat janë në analogji me përmbajtjen së cilës i referohen. Ja si shprehet, Berrutto: “*Për të komunikuar me sukses me një subjekt që i përket një kulture të huaj, por edhe për të arritur objektivin e kompetencës ndërkulturore, janë të nevojshme një sërë nënkompetencash: paragjuhësore, gjestuale, prosepike, psikosociale dhe sociolinguistike. Të njohësh rregullat e mirësjelljes dhe elementët gjuhësorë do të thotë të jesh në gjendje të përdorësh gjuhën dhe elementët jashtëgjuhësorë në një kontekst (mikrokontekst) të caktuar dhe në një (makro) kontekst kulturor*”.<sup>84</sup>

Aspektet jashtëgjuhësore rezultojnë pra, po aq të rëndësishëm sa edhe ato gjuhësore, madje edhe mbizotëruese në interpretim. Në komunikimin me gojë, elementët jashtëgjuhësorë (*ritmi, toni i zërit, pauzat, mimika, xhestet, pozicionet në hapësirë*) marrin një rol përcaktues në çdo ngjarje komunikuese, pavarësisht nga disiplina së cilës i referohen. Po analizojmë disa prej tyre:

- **Përdorimi komunikues i trupit:** Lëvizja e kokës në rast pohimi apo mohimi, drejtimi i syve, shprehjet e fytyrës, lëvizja e duarëve ndryshojnë dhe transmetojnë mesazhe të ndryshme në kultura të ndryshme.
- **Përdorimi komunikues i veshjes.** Në kontekste zyrtare dhe jo zyrtare ndryshon

---

<sup>84</sup> Berrutto G. *Sociolinguistica dell'italiano contemporaneo*, Roma, la Nuova Italia Scientifica, 1987. Fq. 220.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- nga njëra kulturë në tjetrën.
- **Toni dhe intonacioni i zërit.** Të flasësh me një të huaj, duke ngadalësuar shpejtësinë e të folurit, është shenjë respekti, kundrejt atij që është më pak kompetent. Jo të gjithë përdorin këtë kujdesje dhe kjo mund të shkaktojë reagime negative tek interlokutori.
  - **Distanca fizike në bisedë.** Hapësira që çdo individ e quan të tijën dhe të pakapërcyeshme pa lejen e tij, ndryshon nga njëra kulturë në tjetrën. Në përgjithësi, popujt latinë janë mësuar të tolerojnë një distancë minimale mes trupave dhe madje edhe kontaktin fizik (*duart mbi shpatulla*). Kjo i krijon probleme të huajve të tjerë, të mësuar ndryshe, sikurse janë popujt nordikë.
  - **Heshtja.** Edhe administrimi i heshtjes ndryshon nga njëra kulturë në tjetrën. Ka popuj që e tolerojnë e të tjerë jo.
  - **Xhestet.** Janë veçori tipike latine. Ato shoqërojnë pjesën më të madhe të bisedave. Këto xheste që mund të jenë spontane, për kultura të tjera janë shpesh të pakuptueshme dhe mund të lënë hapësira për keqkuptime me xheste të ngjashme të kulturave të tjera.
  - **Shprehja e fytyrës.** Ndodh që në një kulturë të caktuar, shpesh, mbresat e ndjesitë shprehen duke vënë në lëvizje mimikën e fytyrës dhe jo përmes fjalëve. Ky fakt nuk kuptohet apo nuk pranohet nga kultura të tjera.
  - **Përpikmëria.** Çdo kulturë ka një konceptim të vetin për kohën. Për disa kultura qëndron parimi që ‘koha është flori’ (dhe si e tillë nuk duhet shpërdoruar). Në botë, italianët gëzojnë famën e personave jo të përpiktë: ata tolerojnë një vonesë që mbetet në harkun e 15 minutave; madje brenda këtij harku kohor, vonesa nuk konsiderohet si e tillë.

Ndryshimet gjuhësore, pragmatike dhe jashtëgjuhësore mes dy ose më shumë kulturave të ndryshme, sjellin si rezultat formimin e stereotipeve dhe të paragjykimeve. Shpesh këto dy fjalë përdoren si sinonime, por analiza e mëposhtme tregon se ato kanë përdorime të ndryshme.

### ❖ **Stereotipet**

Stereotipet përbëjnë një ‘*rrugë të shkurtër mendore*’, një formë ‘*ekonomie të mendimit*’. Zotërimi i një stereotipi lidhur me një grup individësh, bën që anëtarët e këtij grupi të perceptohen esencialisht të ngjashëm, të paktën për disa aspekte. I afërt, por jo identik me termin *stereotip* është koncepti i *kategorizimit*, i cili përfaqëson një proces mendor gjithëpërfshirës, ku një objekt i cakutur futet në konsideratën tonë në një kontekst në të cilin të gjithë e zotërojmë apo e disponojmë.

Stereotipi është pra, një ide fikse që shpëron kategorinë. Për shembull kategoria ‘*zezakë*’ ruhet në mendjen tonë si një koncept indiferent, pa vlerësime dhe përdoret vetëm në referim të një race të caktuar. Stereotipi krijohet atëhere kur kategoria nis dhe pasurohet me imazhe dhe gjykime mbi zezakët se si ata duan muzikën, janë supersticiozë etj.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

### **❖ Paragjykimi.**

Ndërsa stereotipet janë forma përgjithësimi, në vetvete neutralë, paragjykimi lidhet me një gjykim të pamotivuar dhe të pajustificuar, kundrejt qënieve të tjera (individë apo grupe), që shpesh ngjyroset emocionalisht me një konotacion negativ, por hera-herës edhe pozitiv. Po të analizojmë termin ‘paragjykim’ nga pikëpamja etimologjike, ai shpreh një gjykim që i paraprin përvojës, pra një gjykim i nxjerrë në mungesë të të dhënave të mjaftueshme.

Elementët e mësipërm, si gjuhësorë ashtu edhe jashtëgjuhësorë, shpesh prodhojnë keqkuptime apo situata problematike gjatë komunikimit, ndaj njohja e tyre është e domosdoshme për t’i tejkaluar ato.

Mësimdhënia e zhvilluar me metodën komunikuese-kulturore ndikon që nxënësit të mësojnë se si të relacionohen në mënyrë ndërkulturore, duke evituar stereotipet dhe paragjykimet. Për të parandaluar dhe shmangur keqkuptimet, nxënësit duhet të formohen nga pikëpamja ndërkulturore e më specifikisht nga ndërgjegjësimi se shpesh, ajo që merret si e mirëqënë, e prezantuar si njohuri e stereotipizuar, nuk është gjithmonë e vlefshme dhe as universale.

### **V.1.2. Strategjitë didaktike në funksion të komunikimit ndërkulturore**

Duke u nisur nga aspektet e mësipërme, të cilat vështirësojnë komunikimin mes dy individëve, që flasin gjuhë të ndryshme, marrim shkas për të analizuar rolin e mësimdhënies në lehtësim të këtij komunikimi.

Mësuesi i gjuhës së huaj, në veprimin e vet didaktik dhe edukativ, duhet të përdorë strategji didaktike, në favor të zgjidhjes së problemeve të komunikimit mes dy kulturave të ndryshme. Kjo do të ndikonte që specialisti i ardhshëm të aftësohet që në bankat e shkollës, duke fituar gradualisht kompetencën e komunikimit ndërkulturore. Njohja e aspekteve gjuhësore dhe kulturore është e rëndësishme, pasi komunikimi nuk mund të kufizohet vetëm në përmbajtjen disiplinore, por integrohet edhe me elementë shoqërorë, relationalë, të mbajtes së një qëndrimi kritik, të mënyrës së shprehjes së një opinioni të caktuar etj. Nëse komunikimi është në qendër të studimit të gjuhës, një përjasje e drejtë didaktike, nuk mund të lërë pas dore mënyrën se si shprehem.

Aftësia për të komunikuar në mënyrë efikase në gjuhë të huaj, përveç se është një praktikë, kthehet edhe në një vlerë të shtuar.

Të mësosh gjuhën e huaj do të thotë të mësosh edhe kulturën. Për këtë, është e nevojshme t’u japim studentëve instrumentat dhe strategjitë e duhura për të njohur dhe kuptuar edhe atë që nuk shprehet, por që nënkuptohet, duke zhvilluar njëkohësisht edhe kompetencën socio-pragmatike.

Komponenti pragmatik, i nënkuptuar si aftësi për të arritur objektivat komunikuese, i bashkohet aspekti socio-gjuhësor, i cili përcakton aftësinë për të zgjedhur regjistrin më të përshtatshëm për një situatë të dhënë, por edhe aspekti kulturor, që lidhet me aftësinë e

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

ndërveprimet dhe arritjes së qëllimeve, në përputhje me skemën kulturore (ngjarjen) në të cilën zhvillohet biseda.

Për të forcuar dhe rritur kompetencën ndërkulturore të nxënësve duhen sjellë për analizë, situata, ngjarje komunikuese, ku nxirren në pah diferencat kulturore (dija, besimet, vizionet, sjelljet, veprimet, marrëdhëniet ndërpersonale), me qëllim njohjen e rregullave të ndërveprimet. Mësuesit, në veprimin e tyre didaktik dhe edukativ duhet të krijojnë situata të tilla, ku theksi të vendoset tek aftësia për të menaxhuar ngjarje komunikuese.

Duke e ngushtuar analizën në mësimdhënien e gjuhëve të huaja që u përkasin shkencave ekzakte, nëse tema e një ore mësimi është realizimi i një eksperimenti në fizikë apo në kimi, mësuesi duhet të zhvillojë veprimtari të cilat nxisin komunikimin ndërveprues dhe pasqyrojnë kulturën e komunikimit. Për shembull:

- Si mund të prenotojmë një sallë laborator;
- Si mund të formulohet kërkesa për instrumenta apo materiale;
- Si mund të përgatitet letra e thirrjes për pjesëmarrësit;
- Si të jepen udhëzime;
- Si mund të përgatitet një relacion mbi eksperimentin.

Situata të tilla, që synojnë rritjen e komunikimit mund të realizohen në çdo mësimdhënie në GjHS-it, pasi dija shkencore ka nevojë për interpretim, argumentim dhe ndërveprim.

Dimensioni ndërkulturor në mësimin e gjuhës së huaj nuk përfaqëson një metodë të re të mësimin, por një vlerë të shtuar që ndihmon në rritjen e kompetencës gjuhësore, e nevojshme për të komunikuar dhe ndërvepruar me identitete të ndryshme sociale që përfaqësojnë kultura të ndryshme. Në një mësimdhënie me orientim ndërkulturor nxënësit mund të mësojnë ndoshta më pak fjalë dhe më pak forma gramatikore kundrejt kursit të mirëfilltë komunikues, por si kompensim komunikimi do të rezultonte më i natyrshëm. Në këtë kontekst, edhe gjuhët e huaja të specialitetit duhen mësuar jo thjesht si një produkt (listat terminologjike, modelet standarde), por si një proces i përshkrimit dhe reflektimit mbi kulturat e ndryshme shkencore profesionale e shoqërore.

Më poshtë po sjellim disa mendime dhe sugjerime për mësuesit e gjuhëve të huaja të specialiteteve të ndryshme, të cilat ndihmojnë nxënësin për një komunikim ndërkulturor në fusha dhe kontekste profesionale:

- Zbatimi konkretisht i ngjarjeve komunikuese, ku të nxirren në pah diferencat socio-kulturore nëpërmjet shembujve (video, dialogje me shkrim dhe me gojë, imazhe) dhe/ose eksperiencave të drejtëpërdrejta, me ndihmën e regjistrorëve ose videokamerave. Këto të fundit përfaqësojnë një katalizator për mësimdhënien me

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

fokus komunikimin ndërkulturor, ku theksi vendoset tek veprimi: ndërveprimi, sjellja, negociatat, traktativat.

- Zhvillimi i ndërgjegjësimit tek nxënësit se ekziston një univers pragmatik, por edhe një varietet i mjeteve gjuhësore për ta zbatuar atë;
- Sqarimi dhe çmontimi i stereotipeve reciprokë mes dy kulturave;
- Zbatimi i teknikave të familiarizimit me terminologjinë specifike, përmes modaliteteve të ndryshme të realizimit të akteve gjuhësore;
- Integrimi i kompetencave profesionale të orientuara, krahas atyre gjuhësore duke përdorur teknika të komunikimit të specializuar;
- Zhvillimi i aftësive shoqërore dhe relacionale;
- Edukimi ndaj të dëgjuarit aktiv;
- Vlerësimi dhe promovimi i traditës vendase, kombëtare apo ndërkombëtare;
- Përcaktimi dhe përdorimi i instrumenteve të komunikimit për të ndërhyrë në kontekste profesionale;
- Zhvillimi i një mendimi kritik dhe divergjent.

Mësimdhënia "ndërkulturore" e gjuhës së huaj ofron disa avantazhe kolaterale në drejtim të komunikimit. Kështu, aftësia e përshtatjes e fituar nga studenti, i lejon atij të përdorë më me efikasitet gjuhën e huaj, por edhe e përgatit që të kalojë mikro-konfliktualitetet, të lindura nga keqkuptime kulturore, gjithnjë e më të pranishme në shoqëritë tona multietnike.

Në përfundim, mund të themi se gjuha e huaj përfaqëson një instrument komunikimi dhe shprehjeje të një kulture të ndryshme dhe, duke qënë një mjet kontakti dhe komunikimi me persona të një prejardhje të ndryshme kulturore, kthehet në një instrument ndërkulturor. Këto ndryshime janë realitet dhe nuk duhen konsideruar si një hendek i pakapërcyeshëm. Në fusha të ndryshme të specialiteteve, ndërveprimet, shkëmbimet apo lidhjet midis kulturave mund të pasurojnë jo vetëm individët, por edhe shoqëritë. Seicila shoqëri apo kulturë ka diçka për t'u mësuar kulturave e shoqërive të tjera, por edhe të mësojë prej tyre, të përfitojë nga mundësitë e mëdha që ofrojnë takimet për të zbuluar pamje të reja të identitetit përkatës.

### **V.2. Aspekte socio-kulturore në komunikimin e specializuar**

Strategjitë didaktike në funksion të përvetësimit të kompetencës së komunikimit ndërkulturor, të analizuara në çështjen e mësipërme, gjejnë vend dhe duhen zbatuar edhe në kontekstin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit.

Në didaktikën e gjuhës së huaj të specialiteteve nevojitet të merren parasysh, jo vetëm veçoritë leksikore, morfo-sintaksore apo jashtëgjuhësore të këtyre gjuhëve, por edhe aspekti socio-kulturor, si një instrument tejet i rëndësishëm në procesin e përvetësimit

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

dhe përdorimit me kompetencë të gjuhës së huaj, në fusha specifike. Sikurse e kemi sqaruar, në pjesën e Hyrjes së këtij punimi, termi komunikim ndërkulturor në këtë punim i referohet komunikimit mes kulturave në fusha të ndryshme të specialitetit, ku përvetësimi gjuhësor, specifikisht ai terminologjik, harmonizohet me përvetësimin e kompetencës ndërkulturore.

Çdo tekst apo çdo komunikim, pavarësisht nga fusha apo disiplina së cilës i përket, mbart aspekte socio-kulturore, tipike të shoqërisë që i prodhon. Në konceptin e kulturës gjenden burimet e historisë dhe të mentalitetit të një populli. Në çdo kulturë dalin në pah elementë, të cilët burojnë nga veprimtaritë e ndryshme e, mbi të gjitha, nga qëndrimet e ndryshme që njerëzit mbajnë, në ndërtimin e dijes dhe të marrëdhënieve shoqërore. Kultura shfrytëzohet në këtë mënyrë, si një mjet për të kuptuar konceptet kryesore dhe specifike të gjuhës, për të rritur shprehitë komunikuese nëpërmjet njohjes dhe studimit të kulturës, institucioneve, arteve, zakoneve, traditave të një vendi.

Duke iu referuar mësimdhënies së gjuhëve të huaja të specialitetit dhe kontekstit përkatës komunikativ, gjuha konsiderohet si produkt i kulturës në të cilën përdoret, pjesë e saj, si dhe si kusht për realizimin ndërkulturor. Është gjuha që realizon, në pjesën më të madhe, prezantimin e kulturës, e cila ngadalësisht ndërtohet, modelohet brenda një sistemi, e gatshme për ndryshime dhe kontraktita. Edhe në komunikimin e specializuar, transferohen modele të kulturës, kundrejt njohurive dhe qëndrimeve personale. Këto modele rregullojnë marrëdhëniet dhe raportet, pra sjelljet. Është përmes sjelljeve që kultura shprehet dhe realizohet në shkëmbimet komunikuese.

Elementi kulturor pasqyrohet edhe në kontekste tekniko-shkencore apo profesionale, ku të rëndësishme janë marrëdhëniet midis individëve, si dhe shumë aspekte të sjelljes dhe raporteve ndërpersonale në një fushë të caktuar specialiteti. Në këtë mënyrë kompetenca në gjuhët e huaja të specialitetit, kthehet në një çelës për të hyrë brenda këtyre kulturave, një çelës dinamik, në përmisim të vazhdueshëm, dora-dorës me zhvillimin e kërkimit shkencor apo të praktikës profesionale. Dhe në fakt, ai që ka arritur të kuptojë logjikën e funksionimit të gjuhëve të specialitetit dhe nuk ka mësuar thjesht përmendësh një terminologji të caktuar, është i aftë të mbajë një kontakt të qëndrueshëm me kulturën shkencore, teknike, profesionale në të cilin i duhet të veprojë e të komunikojë ndërkulturalisht.

Njohja e dimensionit socio-kulturor është e rëndësishme, pasi komunikimi i specializuar realizohet në një kontekst kulturor, historik, gjeografik të mirëpërcaktuar dhe, në bazë të kontekstit, zhvillohet sipas skemave dhe rregullave të caktuara. Kulturat nuk janë entitete abstrakte, por realizohen përmes individëve, mbartës të tyre.

Brenda çdo shoqërie realizohet disiplina e specialitetit, përmes komunikimit të specializuar, ku njohja e dimensionit socio-kulturor e ndihmon këtë komunikim. Ja si shprehet O. Challe<sup>85</sup>: *“Koncepti i disiplinës ndahet mes një komuniteti kulturor dhe shoqëror; në këtë drejtim ai duhet të jetë domosdoshmërisht një koncept fleksibël, i konsideruar në ndryshimet e mundshme nga pikëpamja dinamike dhe funksionale”*.

---

<sup>85</sup> Challe *“Enseigner le français de spécialité, Economica, Paris 2002. fq. 122*

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Raporti mes gjuhëve të huaja të specialitetit dhe kulturës referuese ndryshon sipas përmbajtjeve. Një nëndarje e parë në këtë drejtim mund të bëhet mes shkencave natyrore dhe shkencave humane. Disiplinat humane janë më tepër të lidhura me dimensionin socio-kulturor të një vendi. Ndërsa disiplinat ekzakte, të tilla si matematika apo shkencat natyrore, kanë elementë të përbashkët, të unifikuar mes vendeve dhe kulturave të ndryshme. Këtu veçojmë praninë e qëndrueshme të formulave, simboleve, grafikëve, diagrameve dhe të kodeve të tjera, elementë këto jashtëgjuhësorë, të cilat edhe pse nuk disponojnë një aftësi metal-gjuhësore të tyren, janë universalë dhe të kuptueshëm nga individë që u përkasin kulturave dhe gjuhëve të ndryshme, por që gjithësesi, për interpretim dhe arsyetim, i referohen kodit gjuhësor.

Në vijim po sjellim një analizë të specifikave ndërkulturore në gjuhën italiane juridike, ekonomike dhe mjekësore.

### **V.2. 1. Specifikat socio-kulturore në gjuhën juridike**

Sikurse e kemi shpjeguar, në pjesën referuar metodologjisë së punimit, në këtë punim i jemi referuar kryesisht gjuhës italiane juridike, por një përjasje e ngjashme verifikohet edhe për studimin dhe përvetësimin e gjuhëve të tjera, të cilat mbartin dhe shprehin një kulturë juridike të caktuar.

Qëllimi është që të vërtetojmë se si gjuha juridike, përcjell qartazi mesazhin e përjasjeve dhe ndryshimeve ndërkulturore. Nga ana tjetër, do të mundohemi të sqarojmë se sa e rëndësishme është njohja e specifikave socio-kulturore për përdorimin e saktë dhe me kompetencë të gjuhës.

Shembujt e sjellë, mund të përdoren si një bazë për përgatitjen e veprimtarive didaktike gjatë procesit të mësimdhënies së gjuhës italiane juridike, në funksion të përvetësimit të kompetencës ndërkulturore të nxënësve në fushën juridike.

Në procesin e përvetësimit të gjuhëve të huaja, sikurse e theksuam edhe në lart, gjuha dhe kultura janë të pandara nga njëra-tjetra. Duke mësuar gjuhën e huaj, nxënësi merr informacione kulturore, aspekte lidhur me kodin e vlerave, me stile dhe mënyra jetese, me shprehjet organizuese të një shoqërie apo të karakterit të një populli. Nga ana tjetër, njohja e historisë dhe e kulturës së një vendi ndikon në përdorimin e saktë dhe me kompetencë të gjuhës. Teksti juridik i referohet disa realiteteve jashtëgjuhësore, të cilat nuk janë konkrete, por emërtojnë koncepte mbi sjellje shoqërore abstrakte si idetë, zakonet dhe marrëdhëniet midis individëve. Këto koncepte, mbartin një ngarkesë të madhe kulturore. Gjuha juridike, vërteton më së mirë rëndësinë e njohjes së elementëve socio-kulturorë për një komunikim të specializuar në fushën e së drejtës. Më shume se çdo gjuhë tjetër specialiteti, kjo gjuhë ndikohet nga faktorët jashtëgjuhësorë, të cilat lidhen me tiparet specifike të sferës së veprimtarisë shoqërore së cilës kjo gjuhë i shërben.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Aspekti kulturor i tekstit juridik vihet re si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Në tekstin juridik, funksioni dhe vlera komunikuese mbeten thelbësore pasi, përmes gjuhës, kodifikohen të drejta, marrëveshje dhe pakte mes palëve.

Ç do kulturë është rezultat i një realiteti të ndryshëm. Traditat juridike i përkasin dy grupeve të mëdha: traditës kontinentale dhe asaj anglosaksone.

**Tradita kontinentale**, ose e quajtur ndryshe familja ‘romano-gjermanike’, përfshin sistemet juridike, të cilat janë krijuar mbi bazën e të drejtës romake, rregullat e së cilës bazohen mbi parimet e drejtësisë dhe të moralit. Në këtë familje bëjnë pjesë sistemet juridike të shumë vendeve të Evropës kontinentale, sikurse Italia, Gjermania, Spanja, Franca, por edhe sistemet e vendeve të kolonizuara si ato të Amerikës latine, Lindjes së Mesme, Indonezisë, dhe të një pjese të Afrikës. Veçoritë themelore të kësaj tradite, e quajtur ndryshe edhe Civil Law, për ta dalluar nga tradita Common Law, janë të përmbledhura sa më poshtë:

- ❖ Rregullat e së drejtës grupohen në kategori, ku bëjnë pjesë normat me veçori të ngjashme. Le të mendojmë, për një moment në dallimet mes të drejtës publike dhe të drejtës private.
- ❖ Rëndësi themelore i jepet konceptit të normës juridike, e cila cilësohet si një sjellje e veçantë e individit mes rregullave të sjelljes së përgjithshme.
- ❖ Ligji cilësohet si burimi kryesor i së drejtës. Pjesa më e madhe e këtyre Vendeve, në fakt, kanë kode dhe kushtetuta të shkruara. Si rrjedhojë, jurisprudenca nuk ka fuqinë për të ‘krijuar’ norma, por kufizohet në interpretimin e normave të krijuara nga ligjet.

Pra tradita kontinentale bazohet mbi kode (ligje të shkruara) dhe mbi doktrinën, e përpunuar në nivele akademike si dhe mbi një interpretim tekstual institucional, kryesisht ai i llojit normativ. Sipas Busse<sup>86</sup> veprimtaria juridike ‘*mund të përcaktohet si proces tekstualizimi që prodhon tekste të reja juridike, duke u nisur nga një apo më shumë tekste bazë*’.

Ndërsa **kultura juridike anglosaksone**, njohur ndryshe si *Common law*, ose kultura e familjes ‘anglo-amerikane’ përfshin pjesën më të madhe të vendeve anglishtfolëse. Ky model, i lindur në Angli, u përhap në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Australi dhe në disa ish koloni angleze. E drejta angleze është zhvilluar në mënyrë autonome: origjina e saj i përket kohës së pushtimit norman të Anglisë, në vitin 1066, ndërsa në SHBA *common law* ka nisur të zbatohet që në vitin 1602. Veçoritë kryesore të kësaj tradite janë:

- Kategoritë së cilës i referohen janë të ndryshme nga civil law. Nuk ekziston një nëndarje mes të drejtës publike dhe të drejtës private, por krijohen vazhdimisht koncepte të reja si *equity*, *trust*, *trepass*. Vetë fjala *contract* e të drejtës angleze nuk përputhet me nocionin tonë (kontinental) të kontratës.

---

<sup>86</sup> Busse D. *Textsorten des Beeichs Rechtsäesen und Justiz, de Gruyter, 2000* në ‘*La Comunicazione Specialistica.*, Cavagnoli S, fq.101. Berlin, 2000. Fq.664.



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

- Në kulturën juridike anglosaksone i jepet rëndësi parësore procedurës. Le të mendojmë për një moment se fillimisht, *common law*, përbëhej vetëm nga rregulla të llojit procedural, të quajtura forma veprimi, ndërsa rregullat juridike substanciale, qëndronin në vend të dytë.
- Sistemi i burimeve i jep prioritet të drejtës jurisprudenciale, ku juristi nuk ka thjesht të drejtën të ‘zbatojë’ normat juridike, por edhe të ‘krijojë’ të drejtën, nën dritën e vendimeve të mëparshme, të cilat kanë gjithësesi vlerë detyruese. Ligji, sipas teorisë klasike, ndodhet në pozicion të varur kundrejt jurisprudencës, edhe pse sot tendenca është vendosja e tyre në të njëjtin nivel. Kultura juridike anglosaksone, bazohet pra vetëm mbi fakte, dhe si e tillë paraqet me tekstet e saj të referimit një potencialitet vendimarrjeje të ndryshëm kundrejt traditës kontinentale. Ajo bazohet mbi ligje jo të shkruara, të cilat janë zhvilluar mbi bazën e vendimeve të gjykatave, pra të një tipologjie zbatuese (jurisprudenciale).

Ndryshimet më të dukshme me sistemin kontinental, lidhen me mungesën e kodifikimeve, me rëndësinë e madhe të gjykatave angleze, pra me mbizotërimin e jurisprudencës si ‘formuese’ e së drejtës, në raport me zhvillimin e doktrinës universitare dhe të konceptit “*Rule of law*”.

Ndryshimet e sistemeve juridike, sipas analizës së mësipërme, pasqyrojnë padyshim edhe ndryshime gjuhësore dhe interpretuese, lidhur me përdorimin e terminologjive dhe shprehjeve të ndryshme. Një fakt i tillë, verifikohet gjatë vështirësive të përkthyesit, për të transportuar në mënyrën e duhur një tekst juridik nga njëra gjuhë në tjetrën, nga njëri sistem në tjetrin. Ky fenomen është më i prekshëm në përkthimin e teksteve nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, për shkak të kulturave të ndryshme juridike. Në fakt, përkthimi juridik, është një ndër sfidat me të cilat ndeshet një përkthyes. Përkthyesi i gjuhës juridike ka më shumë vështirësi sesa një koleg, i cili merret me përkthime të teksteve mjekësore apo shkencore. Atij i lind nevoja e njohjes së realitetit të sistemeve të ndryshme juridike që mund të dallojnë gjuhën A nga gjuha B.

Njohja e traditës kulturore është pra një parakusht për përvetësimin e kompetencës komunikuese në fushën juridike. Përveç ndryshimeve kulturore mes dy traditave juridike të mësipërme, edhe brenda sistemeve juridike të së njëjtës ‘familje’ apo tradite vërehen ndryshime dhe përjasje edhe përsa i përket mungesës së një përkatësie mes terminologjive, por akoma edhe më shumë, mes institucioneve juridike.

Fjalë apo shprehje të rrënjësura në një kulturë të caktuar përbëjnë vështirësi për përkthyesin apo përdoruesin, pasi shpesh herë janë të pamundura për t’u përkthyer apo për t’u përdorur, madje, ka pasur debate rreth teknikave, humbjeve apo kompensimeve në përkthimin dhe gjetjen e ngarkesës kulturore të një teksti juridik. Dallimet midis kulturave mund të shkaktojnë vështirësi shumë më të mëdha në përkthim, sesa ndryshimet në vetë strukturën e gjuhës.

Sa më shumë përkthyesi është i ndërgjegjshëm për kompleksitetin e ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet kulturave, aq më i saktë dhe kompetent duhet të jetë ai në ushtrimin e profesionit të vet. Pra përkthyesi duhet të jetë jo vetëm bilingual, por edhe bikultural, apo më shumë mulikultural.

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Kur analizojmë një tekst, në fushën e së drejtës në gjuhën italiane, studiuesi apo në raste të tjera, edhe përkthyesi, duhet të mbajë parasysh ndryshime të sistemeve gjyqësore, të cilat reflektohen në gjuhën juridike. Një studiues/përkthyes i teksteve ligjore duhet të zotërojë, jo vetëm zhargonin ligjor, por duhet të njohë dhe historinë e vendit, në gjuhën e të cilit kryhet përkthimi. Më poshtë, po sjellim disa shembuj, referuar organizimit të sistemit gjyqësor italian dhe atij shqiptar. Do të shikojmë përmes tyre rëndësinë e ndërthurjes së kompetencës gjyqësore me kompetencën ndërkulturore

Kështu në organizimin e gjyqësorit italian përdoret termi '*Corte*' në referim të Gjykatës së shkallës së dytë dhe të tretë, dhe termi '*Tribunale*' në referim të gjykatës së faktit. Përkatësisht kemi në gjuhën italiane: *Corte d'Appello*, *Corte di Cassazione* dhe *Tribunale ordinario*. Në gjuhën shqipe të tre shkallët e gjyqësorit shprehen vetëm me termin '**gjykatë**': *gjykata e Faktit*, *gjykata e Apelit*, *gjykata e Kasacionit*.

Ndërsa në referim të Gjykatës së Krimeve të Rënda, respektivisht në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë në gjuhën italiane përdorim *Corte d'Assise* dhe *Corte d'Assise d'Appello*<sup>87</sup>. Po kështu në gjuhën italiane përdoret termi "**Foro**", lidhur me autoritetin gjyqësor kompetent për një territor të dhënë, për shembull **Foro di Milano**, ndërsa në gjuhën shqipe përdoret fjala e përgjithshme '**gjykatë**'. Gjithnjë në kontekstin i institucioneve gjyqësore, në referim të organit të akuzës (Prokurorisë) së një rrethi gjyqësor, në gjuhën italiane përdoret termi *Procura della Repubblica*, ndërsa në gjuhën shqipe *Prokurori e Rrethit Gjyqësor*.

Duke njohur terminologjinë përkatëse të sistemit gjyqësor italian kemi forcuar kompetencën ndërkulturore dhe profesionalizmin, në përdorimin e gjuhës italiane juridike.

Një element tjetër i cili ndihmon komunikimin mes kulturave juridike është edhe **prania e latinizmave**, jo vetëm në gjuhën juridike italiane, por edhe në gjuhë të tjera. Ky fakt lidhet me prejardhjen e së drejtës nga e drejta romake, të paktën përsa i takon traditës juridike kontinentale.

Në tabelën e mëposhtme po sjellim një listë, jo përmbyllëse të latinizmave të përdorura në gjuhën juridike dhe shpesh edhe në atë burokratiko-administrative. Në këtë të fundit udhëzimet e studiuesëve të gjuhësisë dhe të komunikimit ndër-institucional shkojnë në drejtimin e një thjeshtimi dhe të një mundësie përqasjeje ndaj tekstit nga ana e të gjithë qytetarëve, edhe të atyre të cilët nuk zotërojnë nocionet latine. Krahas termave latinë, po sjellim edhe kuptimin e tyre në gjuhën italiane dhe në gjuhën shqipe.

---

<sup>87</sup> Papa M. *Aspektet kulturore të tekstit juridik*. Aktet e Konferencës së Parë kombëtare, Tiranë, 2012, fq. 238

**DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

**Tabela V.1<sup>88</sup>**

<b>Terma latinë</b>	<b>Përkthimi i termave latinë në gjuhën italiane dhe shqipe</b>
Ad quem	Fino al quale (Deri tek i cili)
Adversus omnes	Contro tutti (Kundër të gjithëve)
Civitas	Citta', cittadinanza, Stato (Qytet, nënshtetësi, Shtet)
A quo	A partire dal quale (Duke u nisur nga i cili)
Contro jus	Contro il diritto (Kundër së drejtës)
Contra legem	Contro la legge (Kundër ligjit)
De cuius	Colui che lascia un eredità (Kush lë një trashëgimi)
De iure	Di diritto (Ligjërish)
De facto	Di fatto (Faktikisht)
Dominus	Titolare di un diritto (Titullar i së drejtës)
Ex ante	Come prima (si më parë)
Ex nunc	Da ora (që në këtë moment)
Ex tunc	Da allora (që atëhere)
Ius aedificandi	Diritto di costruire (E drejta për të ndërtuar)
Ope legis	Per legge (Sipas ligjit)
Par condicio	La stessa condizione (Të njëtat kushte)
Periculum in mora	Pericolo derivante da un ritardo (Rrezik i ardhur nga një vonesë)
Per tabulas	Come risultante dagli atti (Siç rezulton nga aktet)
Quorum	Numero limitato di votanti (Numër i kufizuar votuesish)
Ratio legis	Spirito della legge (Fryma e ligjit)
Res aliena	Proprietà altrui (Prona e tjetrit)
Senatus consultum	Decreto, decisione del Senato (Dekret, Vendim i Senatit)
Una tantum	Per una volta (Për një herë)
Tribuni plebis	Comandanti della plebe, del popolo (Komandantë të popullit)
Vacatio legis	Periodo in cui la legge non produce i suoi effetti (Periudhe ku ligji nuk jep efektet e tij)

<sup>88</sup> Për më shumë, të konsultohet Fjalori i Latinizmave juridikë, Bertozzi 2001. Fjalori ofron *on line* mundësinë e gjetjes së termave dhe shprehjeve të panjohura me përkthimin përkatës në gjuhën italiane, në sitin <http://webservices.ipsoa.it/brocardilatinimi>.

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Shkaku i pranisë së latinizmave në gjuhën juridike nuk kufizohet vetëm me këtë motiv: gjuha juridike është mjaft konservatore dhe, edhe pse është një gjuhë teknike, specialistësh, është mjaft afër gjuhës së zakonshme, pasi është shprehje e një tradite historike, e një konteksti shoqëror, e një ambienti gjeografik. Për këtë arsye, prania e termave latinë apo e shprehjeve arkaike, shpesh shërben për të karakterizuar apo diferencuar gjuhën juridike nga gjuha e zakonshme.

Në disa raste, përdorimi i latinizmave ndihmon në saktësimin e shprehjes. Termat latinë, duke qënë universalë e të përdorur në gjuhë të tjera shpesh mund të na vijnë në ndihmë për përkthimin e fjalëve apo shprehjeve të vështira.

Latinizmat përfaqësojnë një specifikë kulturore të traditës së gjuhës italiane juridike. Njohja dhe përvetësimi i tyre, lejon përdorimin e saktë, në formën e tyre edhe në gjuhën shqipe dhe është një vlerë e shtuar e kompetencës komunikuese.

Për një mësimdhënie/mësimnxënie të suksesshme, mësuesi i gjuhës së huaj duhet të njohë mirë aspektet kulturore të gjuhës juridike, përpos atyre gjuhësore dhe në bazë të tyre të ndërtojë programin didaktik.

Duke konsideruar sa shpjeguar më lart, në një mësimdhënie të gjuhës së huaj në fushën juridike, qëllimi nuk është thjesht të transmetohen përmbajtjet teknike të vetë disiplinës, por të jepen strategjitë e nevojshme për kuptimin dhe interpretimin e teksteve të një argumenti të caktuar specifik. Nevojat gjuhësore të identifikuar kthehen kështu në objektiva didaktikë të mësimdhënies, ku krahas objektivave gjuhësorë dhe mikrogjuhësorë, duhet të jenë të pranishme edhe objektivat ndërkulturore si: njohja e aspekteve kulturore të tekstit juridik, njohje e sistemit juridik, aftësia për të përkthyer një tekst juridik, duke iu referuar kulturës dhe organizimit juridiko-administrativ të një vendi.

### **V.2.2. Specifikat socio-kulturore në gjuhën ekonomike**

Edhe për analizën e specifikave socio-kulturore të gjuhës ekonomike, sikurse për gjuhën juridike, i jemi referuar gjuhës italiane, pas analizës së një korpusi tekstesh ekonomiko-finnaciare si dhe glosarit bashkangjitur këtij punimi (*Shtojca nr. 3*). Mendojmë se një përjasje e ngjashme mund të realizohet në analizën edhe në gjuhë të tjera. Qëllimi është që të tregojmë se krahas analizës leksikore dhe morfo-sintaksore<sup>89</sup> në mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhës ekonomike, është i rëndësishëm edhe dimensionin ndërkulturore. Për këtë, jemi përpjekur të sjellim argumente dhe shembuj, duke përjasur elementë të kulturës ekonomike italiane me elementë të kulturës ekonomike shqiptare, si kultura të cilat kanë, sigurisht, pika të përbashkëta, falë edhe proceseve integruese ekonomike, por edhe ndryshime, ardhur si rezultat i zhvillimeve dhe organizimeve specifike ekonomike. Njohja e tyre përbën një mundësi të mirë për të forcuar tek nxënësit kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturore.

---

<sup>89</sup> Këtu, kreu i dytë

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Fillimisht kemi menduar të sjellim një përshkrim të shkurtër të lindjes dhe evoluimit të gjuhës italiane ekonomike.

Gjuha italiane ekonomike, si gjuhë specialiteti ka lindur dhe është zhvilluar si rezultat i një evolucioni të veçantë ekonomiko-tregtar dhe është përcaktuar nga një traditë e pasur dhe e gjatë e mendimit ekonomik.

Edhe pse fjalët kryesore të aktiviteteve ekonomike janë latine (*merx, mercator, commercium, lucrum, pignus*, etj.), vetëm në fillim të mesjetës, kur braktiset aktiviteti ekonomik, lidhur me administrimin e të vetmes pasuri reale të njohur, sikurse ishte pronësia mbi tokën, nisi të zhvillohej një konceptim i ri mbi ekonominë, (jo vetëm mbi veprimtarinë ekonomike, por mbi mbarë sistemin socio-politik), i cili formësoi parimet e shkëmbimit dhe tregtisë, duke pasur në qendër figurën e re të tregtarit. Në atë kontekst u formësua, duke pasur si bazë elementët leksikorë që përgjithësisht i përkisnin shekujve V-IX, fjalori i parë tregtar, ku pjesa më e madhe e fjalëve ishin latine.

Me hovin e zhvillimit ekonomik, hap pas hapi, nisi dhe u krijua një terminologji sektoriale e praktikës tregtare, e cila e përpunuar në Itali, mes shekullit XIII dhe XV, u përhap në të gjitha gjuhët evropiane, duke krijuar bërthamën më të vjetër të gjuhës së ekonomisë. Ndër këto terma mund të përmendim:

- *bilancio* (shek. XV), frëngjisht *bilan*, gjermanisht *Bilanz*;
- *cassa e cassiere* (respektivisht shekujt XIII e XIV), frëngjisht *casse*, (shek. XVII), anglisht *cash*, (shek. XVI), gjermanisht *Kasse* e *Kassier* (Shek. XVI);
- *credito* (shek. XIV), frëngjisht *crédit*, (shek. XV); anglisht *credit*, (shek. XVI), gjermanisht *Kredit*, (shek. XV.)

Një kthesë e fortë në përkufizimin konceptual dhe në asetin gjuhësor-stilistikor të gjuhës ekonomike e të financës italiane, regjistrohet mes fundit të Pesëqintës dhe fillimit të Gjashtëqintës, përmes tre veprave të para të ekonomisë moderne (*la Lezione delle monete*, 1588, i Bernardo Davanzati dhe *il Breve trattato delle cause che possono far abbondare i regni d'oro e d'argento*, 1613, i Antonio Serra-s), në të cilat përvijëzoheshin konceptet e doktrinës tregtare, ku gjuha italiane vazhonte t'i ofronte teknikizma gjuhës ndërkombëtare të ekonomisë të tilla si: *giro* (qarkullim, aktivitet tregtar), *impresa* (shoqëri), *quota* (kuotë), *addebitare* (ngarkoj me detyrim), *valuta* (valutë), etj.

Pas vitit 1770, si pasojë e përhapjes së ideve të shkollave franceze dhe angleze, si dhe të periodikëve ekonomikë, terminologjia e vjetër tregtare rinovohet thellësisht dhe ridimensionohet. Në veçanti, u afirmuan dy tendenca: leksiku abstrakt dhe teorik, i cili zhvillohej në drejtim të evropianizimit, kryesisht përdorimit të termave të gjuhës frënge, të tilla si: *valore*, *produzione*, *azione*, *azionario*, *azionista*, *budget*, *economista*, *esportare*, *esportazione*.

Ndërsa, terminologjia lidhur me emra e mallrave, institucioneve, zakoneve juridike mbetet ende e bazuar mbi gjuhën rajonale. Me nisjen e procesit të industrializimit, gjuha ekonomike diferencohet gjithnjë e më shumë nga gjuha e zakonshme. Sigurisht, një kontribut në këtë drejtim solli edhe ndarja e e punës, duke u afirmuar parimi se jo të

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

gjitha punë janë të barabarta, por duhet të ndahen dhe diferencohen sipas prirjeve natyrore të individit.

Edhe në Tetëqintën, nisën të përdoren neologjizma me prejardhje kryesisht nga frengjishtja (*assegno*, që vjen nga fjala frënge *chèque*) dhe nga anglishtja (*clearing*, *tender*, *trust*, *warrant* etj).

Në Nëntëqintën, gjuha ekonomiko-financiare italiane pëson një rritje të dukshme terminologjike. Kështu, në gjysmën e parë të shekullit, hasen ende neologjizma të krijuar nga tradita ekonomike italiane (*contropartita*, *extrastallia*, *quotazione*) dhe depërtimi i anglicizmave, jo të përshtatur, të kufizuar në sektorin makro-ekonomik (*dumping*, *gold standard*, *holding*...), dhe gjithësesi të shoqëruara edhe me përshtatje apo kalke (*inflazione*, *deflazione*, *riconversione*, *taylorismo* etj), terma nga gjuha frënge (*filiere*, *surplus*,...) si dhe ato të përshtatura në gjuhën italiane (*partenariato*, *mobiliare*,...)

Në vitet Pesëdhjetë e në vazhdim, gjejnë përdorim të gjerë anglicizmat, jo të përshtatur, të cilat u përkasin tashmë të gjithë sektorëve të fushës ekonomiko-financiare (*blue chip*, *cash flow*, *benefit*, *factoring*, *golden share* etj).

Pasojat e kësaj situate janë një distancë në rritje midis gjuhës ekonomiko-financiare dhe gjuhës së zakonshme dhe, si rrjedhojë, një vështirësi në rritje e kuptimit të këtyre teksteve nga ana e atyre që nuk janë specialistë të sektorit. Në një drejtim të kundërt vijnë veprat e ekonomistëve të njohur italianë (Luigi Einaudi, Umberto Ricci, Giovanni Demaria, Federico Caffè, Claudio Napoleoni e Piero Sraffa), të shkruara në mënyrë plotësisht të kuptueshme për lexuesin.

Nga sa shpjeguar më lart, lidhur me lindjen dhe evoluimin e gjuhës ekonomike, konstatojmë se ritmet e zhvillimit ekonomik, tendencat e reja, pasurojnë jo vetëm vendin, por edhe gjuhën. Nga ana tjetër, gjuha dhe kultura janë një binom i pandashëm. Ndaj njohja dhe studimi i tyre duhet të shkojnë paralelisht dhe kjo shprehet më së miri në kontekstin e mësimin të gjuhëve të huaja të specialitetit. Organizimi ekonomiko-financiar i një vendi, me të gjitha hallkat dhe instrumentat e tij paraqet, përveç aspekteve të përbashkëta edhe ndryshime. Shembujt janë nga më të ndryshmet, pasi të ndryshme janë edhe nënfushat e gjuhës ekonomike: gjuha tregtare, gjuha financiare, gjuha bankare, gjuha e marketingut etj. Në në këtë punim, kemi përzgjedhur disa shembuj për të vënë në dukje se për përvetësimin e gjuhës italiane ekonomike, ka rëndësi njohja e specifikave të kulturës ekonomike të tilla si: organizimi ekonomik i vendit, institucionet, shërbimet në fushën bankare, aktivitetet tregtare etj.

### ➤ Tipologjitë e shoqërive tregtare në Itali

Njohja e tipologjive të shoqërive tregtare, si pjesë e kulturës ekonomike italiane, është e rëndësishme për të realizuar një përjasje të drejtë me tipologjitë e shoqërive tregtare në Shqipëri. Kështu, Kodi Civil italian parashikon tri kategori të përgjithshme shoqëri tregtare:

- *Società di persone*, në të cilën përfshihen (shoqëri të thjeshta, shoqëri kolektive), ku të paktën njëri prej ortakëve duhet të ketë përgjegjësi të

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

pakufizuara, që do të thotë se ortakët përgjigjen edhe me kapitalin e tyre privat, nëse pasuria e shoqërisë nuk mjafton për të paguar detyrimet e saj.

- ***Societa' di Capitali***, e cila ka statusin e një personi juridik, që do të thotë se shoqëria është përgjegjëse për të gjitha detyrimet e grumbulluara. Ortakët në tërësinë e tyre përgjigjen në mënyrë të kufizuar, pra kreditorët nuk mund të veprojnë mbi kapitalin e tyre privat.
- ***Societa' cooperative***, të cilat kanë kryesisht një qëllim ndihme të ndërsjelltë. Kooperativa përbëhet nga ortakë, të cilët bashkëpunojnë për të plotësuar një nevojë të përbashkët.


Njohja dhe përvetësimi i këtij lloj organizimi të shoqërive tregtare ndihmon në përjasjen e drejtë të këtyre emërtimeve me shoqëritë përkatëse tregtare shqiptare dhe forcon tek nxënësi kompetencën komunikuese në këtë sektor.

### ➤ **Struktura organizative e shoqërive tregtare**

Në kulturën ekonomike italiane, me ligj, shoqëritë askionere përse i përket strukturës organizative të tyre duhet të përzgjedhin një nga modelet e mëposhtme.

- ***Modelin tradicional ose klasik***, i cili parashikon një *bord drejtues (consiglio di amministrazione)* ose *administratorin e vetëm (administratore unico)*, dhe një *organ kontrolli (colleggio sindacale)*. Në këtë të fundit, nëse nuk do njiheshin kompetencat e këtij organi, (ushtrim kontrolli), në përjasjen në gjuhën shqipe, për analogji me mbiemrin '*sindacale*', i cili përdoret në referim të sindikatave, mund të gabohej në sjelljen e saktë të termit në gjuhën shqipe.
- ***Modelin 'dualistik'***, i cili parashikon një Këshill Drejtues (Consiglio direttivo) dhe një Këshill Mbikqyrës (consiglio di sorveglianza), me funksionin e kontrollit.
- ***Modelin 'monastik'***, i cili parashikon një organ të vetëm: *bordin drejtues (Cda)* që drejton shoqërinë dhe brenda të cilit funksionon një komitet kontrolli (*comitato di controllo*).

Pra, në referim të termit *organ kontrolli*, në modele të ndryshme organizimi, në gjuhën italiane kemi tre përkufizime, të cilat në gjuhën shqipe do t'i përkthenim me një term të vetëm, pavarësisht modelit që ka zgjedhur shoqëria.

- *colleggio sindacale*
  - *consiglio di sorveglianza*
  - *comitato di controllo*
- 

- Në aspektin institucional, në kulturën ekonomike të Italisë, funksionon një institucion i cili jep kredi në këmbim të të mirave materiale. Termi që përdoret në referim të tij është *Monte di Pieta'*. Duke mos pasur një institucion analog në

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Shqipëri, përvetësimi i kuptimit të këtij termi, lejon që ai të përdoret në kontekstin e duhur.

- Përdorim i ndryshëm i termave ekonomikë.
- Termi '**fattura**' në gjuhën ekonomike është një dokument, i cili sipas ligjit duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:
  - të dhënat identifikuese të shitësit;
  - shuma totale që blerësi duhet të paguajë;
  - numrin e faturës;
  - të dhëna identifikuese të blerësit;
  - të dhëna mbi sasinë, cmimin e mallit.

Përdorimi i këtij termi duhet të plotësojë pra kërkesat e mësipërme.

Në gjuhën shqipe termi '*faturë*' ka një përdorim më të përgjithshëm. Ai përdoret edhe në rastet e pagesave të shërbimeve të konsumit, për të cilat në gjuhën italiane përdoret specifikisht fjala '*bolletta*'.

- Në referim të përqindjes së TVSH-së në gjuhën italiane përdoret shprehja '*aliquota IVA*' , ndërsa në gjuhën shqipe nuk ka term specifik për TVSH-në, por përdoret fjala e zakonshme **përqindje (percentuale)**, fjalë e cila nuk përdoret në gjuhën italiane në referim të TVSh-së.
- Në lidhje me format e pagesave në bankë, në gjuhën italiane përdorim termat e mëposhtëm:

*Assegno, bonifico bancario, cambiale, paghero*'.

Në gjuhën shqipe si forma pagese në bankë njihen termat: *Transferta bankare dhe urdhër-xhirim*.

- Prania në tekstet ekonomiko-financiare të **neologjizmave në gjuhë të huaj**:

Një element tjetër që mund t'i shtojmë kësaj analize lidhet me neologjizmat, kryesisht në gjuhën angleze, krijuar si rezultat i faktorëve të globalizimit ekonomik. Këtu mund të sjellim një dallim midis gjuhës italiane dhe gjuhës shqipe, në kontekstin ekonomik.

Ka mjaft neologjizma të gjuhës angleze, të cilat përdoren si në gjuhën italiane ashtu edhe në atë shqipe, apo në gjuhë të tjera, të tilla si: *bankomat, cash, telemarketing, Know how etj*. Por, në gjuhën italiane përdoren terma të gjuhës angleze të cilat në gjuhën shqipe nuk gjejnë përdorim si:

- *core business (biznesi kryesor)*,
- *business plan, (plan i biznesit)*,
- *specimen (firmë e depozituar)*,
- *organi di line (organe me përgjegjësi vendimarrëse)*,
- *Executive summary (përmbledhje) etj.*



## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Nëpërmjet njohjes dhe përvetësimit të terminologjisë së mësipërme të gjuhës bankare zgjidhet termi përkatës i gjuhës shqipe.

Këto aspekte, por edhe të tjera mund të shërbejnë si mbështetje për zhvillimin e veprimtarive didaktike, duke pasur si qëllim që njohja dhe përvetësimi i terminologjisë specifike, forcon kompetencën ndërkulturore në gjuhën ekonomike.

### V.2.3. Specifika socio-kulturore të gjuhës italiane mjekësore

Sikurse e theksuam edhe më lart, disiplinat humane janë më tepër të lidhura me dimensionin socio-kulturor të një vendi. Ndërsa disiplinat ekzakte të tilla si: matematika apo shkencat natyrore, kanë elementë të përbashkët, të unifikuar mes vendeve dhe kulturave të ndryshme. Edhe në rastin e gjuhës mjekësore, është disi e vështirë të nxjerrësh në pah elementë ndërkulturorë lidhur me disiplinën. Kjo, edhe për faktin se gjuha mjekësore mund të quhet ndryshe një gjuhë universale, për shkak se pjesa më e madhe e terminologjisë mjekësore botërore përbëhet apo ndërtohet nga fjalë greke dhe fjalë latine, të lindura që në epokën antike. Në antikitetin grek u formua bërthama e terminogjisë mjekësore, kryesisht në fushën e anatomisë dhe të patologjisë. Këto terma greko-latinë përdoren edhe sot, si në formën e tyre të krijimit. Mund të sjellim shembullin e përshkrimeve të recetave mjekësore, në të cilat përdoren, si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë italiane të njëjtat huazime të paintegruara nga gjuha latine:

*cito* (shpejt), *citissime* (urgjentisht), *ex-tempore* (në çast), apo edhe shprehjet *Lege artis*- (sipas rregullave), *bis repetatur* (të përsëritet për herë të dytë), *pro-auctore* (për vetë mjekun), *pro narcosi* (për narkozë), *per-os* (nëpërmjet gojës), *ad usum externum* (për përdorim të jashtëm), *auantum satis-as sa nevojitet*, etj<sup>90</sup>

Përsos këtyre huazimeve, pjesa e madhe e terminologjisë mjekësore të sotme përbëhet nga huazime të përshtatura nga leksiku greko-latin, ku termat pësojnë ndryshime leksiko-gramatikore si në rastet e termave:

*Polmonite/ Pulmonit* (*pulmonitis*), *laringhite/ laringit* (*laryngitis*), *infarto/ infarkt* (*infarctus*), *ricetta/ recetë* (*receptum*), *trasfusione/transfuzion* (*transfusio*), *nervo/nerv* (*nervus*), *abort/ abort* (*abortus*), *Infezione/Infeksion* (*infectio*).

<sup>90</sup> Braho S, Xhillari V. *Receptor për mjekët dhe farmacistët*. Tiranë, 1983. Fq 109

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

Nga ana tjetër, zhvillimi i dukshëm i mjekësisë, teknologjisë mjekësore sjell domosdoshmërisht edhe krijimin e fjalëve të reja, neologjizma, por edhe këto formohen në bazë të bërthamës së leksikut greko-latin. Termit mjekësorë, të huazuara nga gjuhët e sotme evropiane (anglishtja, frengjishtja, gjermanishtja dhe italishtja) dhe nga gjuhët e Lindjes, në krahasim me termit me prejardhje greko-latine, janë më të pakta.

Kështu, si në gjuhën mjekësore shqipe, ashtu dhe në atë italiane, apo gjuhë të tjera përdoren anglicizma të tillë si *Check up, strong unit, by-pass*, jo vetëm nga specialistët e fushës, por me një përdorim të gjerë edhe nga individë që nuk i përkasin komunitetit mjekësor.

Në përqasjen mes gjuhës mjekësore italiane dhe asaj shqiptare është shumë e vështirë pra të gjesh ndryshime. Mjafton të përmendim termit që përdoren në diagnostikimin e patologjive të ndryshme, për të pohuar këtë fakt. Në tabelën e mëposhtme, po sjellim përkufizimet e disa patologjive në gjuhën italiane dhe atë shqipe:

**Tabela nr.V.2.**

Përkufizimi në gjuhën italiane	Përkufizimi në gjuhën shqipe
Amnesia	Amnezi
Afasia	Afazi
Depressione	Depresion
Demenza	Demencë
Delirium	Delir
Apnea	Apne
Insonnia	Insonia
Ictus	Iktus
Meningite	Meningjit
Encefalite	Encefalit
Sclerosi	Sklerozë
Paralisi	Paralizë

## **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

Ndaj, mund të themi, se ndryshe nga gjuha juridike dhe ekonomike ku, pavarësisht efekteve të globalizimit gjenden specifika të ndryshme të kulturës juridiko-ekonomike të cilat reflektohen edhe në gjuhët përkatëse, në fushën e mjekësisë, verifikohet një unifikimin në përdorimin terminologjik e si rrjedhojë komunikimi mes kulturave mjekësore është më i lehtë.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## KREU VI

### NJËSI DIDAKTIKE NË GJUHËN ITALIANE JURIDIKE, EKONOMIKE DHE MJEKËSORE

#### VI.1. Hartimi dhe zbatimi i një njësie didaktike në gjuhën italiane juridike

##### IV.1.1. Programimi i përmbajtjes

Në projektimin e një projekti didaktik, pikënisje janë ato parime teorike themelore të argumentuara gjatë këtij punimi, të cilat përkthehen në materiale didaktikë për mësimin dhe përvetësimin e gjuhëve të huaja të specialitetit. Ky material didaktik duhet të strukturohet në mënyrë të tillë që nxënja të jetë sa më e thjeshtë dhe e shpejtë.

Programimi i përmbajtjes artikullohet në module. Pasi kemi përcaktuar qëllimet edukative dhe glotodidaktike mund të vazhdojmë me përzgjedhjen e përmbajtjes, duke pasur kujdes që ajo t'i përgjigjet analizës së nevojave specifike të nxënësve. Edhe pse mund të jetë një ekspert i argumentit specifik, nxënësi nuk është ekspert i gjuhës, prandaj materialet duhet të jenë të përshkallëzuara: nga më të thjeshtat, drejt atyre më të vështirat. Në mësimet e para tekstet duhet të jenë më të drejtuara nga ana e mësuesit, ndërsa gradualisht u lihet liri më e madhe shprehjes së nxënësve. Maksimumi i nivelit të komunikimi pritët të arrihet në përfundim të ciklit mësimor.

Ndërsa, nënprogramimi psikodidaktik bazohet në njësinë e përvetësimit, nga ana e saj e ndarë në tre faza: pasi kemi përjashtuar fazën e motivimit, pasi nxënësit janë të ndërgjegjshëm për nevojën e tyre të formimit në gjuhë specialitetit, vëmendja duhet të përqëndrohet tek **faza globale** dhe faza e **analizë-reflektimit**, për secilin nga tekstet e propozuara, duke përfunduar me fazën e **sintezës**, e përbashkët për të gjitha tekstet, sikurse sugjerohet nga Balboni<sup>91</sup> dhe nga një testim final. Veprimtaritë zhvillohen me mënyrat induktive, duke zbatuar teknika të posaçme, përmes përdorimit të glototeknologjive të tilla si videoprojektorë, pc lidhur me internet, dvd, etj. Teknikat e përdorura lidhen me drejtimin dhe kuptimin e dëgjimit dhe të leximit, teknika që sjellin zhvillimin e aftësive produktive, teknika për reflektimin mbi leksikun dhe memorizimin, koherente me metodologjinë e përzgjedhur dhe të vlefshme për arritjen e objektivit didaktik që i kemi vënë vehtes: përvetësimin e kompetencës së komunikimit.

Në diagramën e mëposhme po sjellim organizimin e fazave të një Njësie Didaktike në gjuhë të huaja specialiteti


---

<sup>91</sup> Në librin e tij “*Le microlingue scientifico-professionali*” UTET, Torino, 2000, pag. 97, P.E. Balboni tregon se nëse në njësitë e përvetësimit mikrogjuhësor ka më shumë tekste, procesi *globalitet* → *analizë* → *sintezë*, duhet të përsëritet për secilin tekst.

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## Diagrama VI.1

Diagrama e fluksit të Njesisë Didaktike



Njësia didaktike e propozuar, i drejtohet studentëve shqiptarë të Fakultetit të Drejtësisë, të cilët kanë zgjedhur të studiojnë gjuhën italiane juridiko-administrative.

Analiza gjuhësore dhe ndërkulturore e sjellë në kapitujt paraardhës shërben si bazë për përgatitjen e veprimtarive didaktike, me qëllim përvetësimin sa më efikas të kësaj gjuhe. Elementi i ri që jemi përpjekur të sjellim lidhet me dimensionin ndërkulturor, i cili sikurse e analizuam, është gjerësisht i pranishëm edhe në gjuhën juridike, dhe i bashkohet veprimtarive gjuhësore.

Në këtë njësi didaktike do të përpiqemi të analizojmë krahas objektivave gjuhësorë, të gjuhës së specialitetit, edhe ato ndërkulturore, për vetë natyrën e gjuhës juridike si mbartëse e aspekteve socio-kulturore specifike.

**Struktura e Njesisë Didaktike me titull “*Le Autonomie Territoriale nell’ordinamento repubblicano*”**

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

**Grupi eksperimental:** 24 studentë<sup>92</sup>, niveli B1-B2, të moshës midis 18 e 20 vjec, të cilët frekuentojnë, vitin e parë të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës.

**Kohëzgjatja:** 6 orë prej 60 minutash (3 ore, dy herë në javë).

**Materialet dhe instrumentat:** fotokopje, tabela, fjalorë, videoprojektor, stereo, kompiuter portabël, internet.

## **Objektivat gjuhësorë:**

Zhvillimi dhe fuqizimi i aftësisë së leximit të tekstit shkencor si dhe kuptimi dhe riprodhimi me shkrim dhe me gojë. Përdorimi i foljeve në mënyrën lidhore. Forma pësore e foljeve, përdorim i pjesores me vlerë kohore dhe me funksionin e fjalisë lidhore.

## **Objektivat e gjuhës së specialitetit:**

Kuptimi dhe riprodhimi i teksteve të specialitetit dhe njohja me veçoritë formale të një teksti juridik; Përvetësimi dhe zgjerimi i leksikut juridiko-administrativ; Njohja dhe nxjerrja në pah e termave të huazuara nga gjuha e zakonshme e që marrin një kuptim specifik në gjuhën juridike. Formimi i njësive leksikore të larta. Përdorimi i formave të pashtjelluara të foljes (*përcjellorja, pjesorja e tashme dhe pjesorja e përbërë*), si forma tipike të gjuhës juridike.

## **Objektiva ndërkulturorë:**

Nxjerrja në pah përmes veprimtarive me shkrim e me gojë të atyre elementëve socio-kulturorë, njohja e të cilave është e rëndësishme për përdorimin e saktë të termave dhe koncepteve që shprehin një kulturë juridike të caktuar, duke i krahasuar me kulturën juridiko-administrative shqiptare.

## **Objektiva jashtëgjuhësorë:**

Përdorimi i elementëve parateksualë, tipike për gjuhët të specialitetit në përgjithësi, por që gjejnë vend edhe në gjuhën juridike: të tilla si figura, simbole, sigla, shkurtime etj. Kryerja e kërkimeve në bibliotekë dhe në internet. Konsultimi i fjalorëve fizikë dhe i atyre *on-line*.

## **Metodologjia e punës:**

Në klasë, individual, në grup.

Për njësinë didaktike "*Le autonomie territoriale nell'ordinamento repubblicano*,"<sup>93</sup> janë përgatitur dy tekste të lidhura kuptimisht me njëra-tjetrën. Në bazë të këtyre teksteve kemi ndërtuar tre fazat përkatëse, sa më lart shpjeguar.

## **1. Faza globale**

## **2. Faza analizë-reflektim**

---

<sup>92</sup> Në këtë kapitull, do të përdorim fjalën 'studentë', dhe 'pedagogë' kundrejt fjalës 'nxënës' dhe 'mësues', pasi i referohemi konkretisht mësimdhënies në kontekst universitar.

<sup>93</sup> Tekstet janë shkëputur nga libri i Kushtetutës së Republikës së Italisë

# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## 3. Faza sintezë-verifikim (e përbashkët për të dyja tekstet

Teksti nr. 1: **Le Regioni, le Province, i Comuni**

*Shpjegim i veprimtarive didaktike*

### Faza 1. Faza globale

Kjo fazë paraprihet nga disa aktivitete para-përgatitore që synojnë një përjasje kuptimore në mënyrë që të ndërjegjësohen studentët për ç'ka dinë dhe se ku mund të drejtojnë inputet e tyre. Me një diskutim në klasë, pedagogu drejton pyetje dhe nxjerr konkluzione nga përgjigjet e marra. Vijon faza e para-leximit, duke vëzhguar imazhet (fig.1 dhe fig.2), pasuar nga hipotezat dhe diskutimi në klasë.

Fillohet me leximin ekstensiv individual, shoqëruar me ushtrime që synojnë kuptimin global të tekstit. Vazhdohet me leximin intensiv, individual ose në çift, shoqëruar nga ushtrime lidhur me kuptimin dhe analizën e elementëve të veçantë të tekstit juridik. Ushtrimet janë të një tipologjie të shkallëzuar dhe të strukturuar në mënyrë që të drejtojnë leximin nga e përgjithshmja tek e veçanta dhe përfshijnë: pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, ushtrim me lidhje të termit juridik me përkufizimin përkatës ku synohet memorizimi i termave të specializuar. Vazhdohet me terminologjinë juridike në gjuhën italiane, lidhur me sistemin kushtetues në përgjithësi, duke hipotizuar mbi kuptimin e termave.

### Faza II: Analizë dhe reflektim

Në këtë fazë zhvillohen veprimtari lidhur me leksikun e specializuar në fushën administrativo-juridike. Udhëhiqen studentët në përcaktimin e njësive leksikore të larta<sup>94</sup>, tipike të stilit juridik; vazhdohet me ushtrime formimi të fjalëve të prejardhura, përmes parashtesave (emra → mbiemra), (emra-folje). Pas kësaj, një ushtrim me fiksimin e strukturave të njohura dhe të panjohura. Kjo veprimtari bëhet më interesante, nëse zhvillohet me një procedurë të llojit lojë. Studentët ftohen të lidhin përkufizimin me termin e saktë. Fiton ai që lidh saktësisht më shumë terma brenda një minute. Diskutim në klasë. Në vazhdim propozohet një veprimtari lidhur me përdorimin e formave të pashtjelluara të foljes, si një veçori e gjuhës juridike. Më konkretisht, fjalitë implicite (me përdorim të formës së pashtjelluar përcjellore, transformohen në fjali eksplicite, (me përdorim të kohës së tashme të mënyrës dëftore). Pas kësaj veprimtarie, shpërndahen ushtrime gramatikore përforcimi, duke synuar dallimin mes formave të pashtjelluara dhe formave të shtjelluara të foljes.

---

<sup>94</sup> Për shpjegimin e njësive leksikore të larta, të shikohet Kreu i II i këtij punimi

# **DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR**

## **Teksti i Dytë: Le autonomie territoriali**

*Shpjegim i veprimtarive didaktike*

### **Faza I. Faza globale**

Fillohet me një veprimtari e cila i paraprin përdorimit të leksikut të specializuar që do të përdoret në tekst. Vazhdohet me leximin e tekstit, individual ose në grupe me nga dy nxënës, shoqëruar nga ushtrime *e saktë/ e gabuar*, për të verifikuar kuptimin e tekstit. Vazhdohet me një kuptim më analitik të tekstit, ku studentëve u kërkohet të hartojnë një tabelë me terma të gjuhës juridike, të ndeshura për herë të parë në tekst.

### **Faza II. Analizë dhe reflektim**

Fillon faza e analizës, përmes një veprimtarie, ku jepen përkufizimet dhe nxënësit duhet të kërkojnë termin korrispondues brenda tekstit të lexuar. Kjo veprimtari mund të zhvillohet edhe në formën e lojës, ku nxënësit ndahen në dy grupe dhe zhvillohen aftësitë ndërvepruese. Pasi është analizuar teksti i dhënë, jepet si detyrë një veprimtari me shkrim, përmes së cilës kërkohet të thjeshtohet teksti juridik në një tekst të gjuhës së zakonshme. Për këtë, nxënësit mund të përdorin fjalorin me qëllim që të gjejnë sinonimet përkatëse. Kjo bën të mundur jo vetëm kuptimin e plotë të tekstit, por duke nxjerrë në pah dallimet mes gjuhës së zakonshme dhe gjuhës juridike, si në rrafshin leksior, apo morfo-sinaksor, përvetësohen më natyrshëm veçoritë e komunikimit juridik. Vazhdohet me një veprimtari lidhur me përdorimin e mënyrës lidhore të foljes, në fjalitë e nënrenditura, veçori kjo e gjuhës juridike. Ftohen nxënësit të nënvizojnë në tekst foljet e përdorura në mënyrën lidhore, duke specifikuar kohën e përdorur.

### **Faza e III Sinteza (Teksti 1 + Teksti 2)**

Për fazën e sintezës janë parashikuar veprimtari të cilat i përkasin të gjithë materialit didaktik të paraqitur. Nxënësit ndahen në tre grupe dhe ftohen të plotësojnë një tabelë me terma në gjuhën italiane juridike, lidhur me autonominë territoriale, duke dhënë për çdo term një përkufizim. Pas kësaj, secilit grup i caktohet një kërkim lidhur me një argument të caktuar, të trajtuar më parë gjatë njësisë didaktike, të cilin do t'ua prezantojë nxënësve të tjerë dhe mësuesit gjatë një ore mësimi. Për të zhvilluar këtë veprimtari nxënësit ftohen të konsultojnë një sit në internet.

Në pjesën e sintezës parashikohet të vihet theksi edhe në përjasjen ndërkulturore, duke krijuar skeda të një analize krahasimore mes sistemit administrativ juridik shqiptar dhe sistemit administrativ juridik italian. Qëllimi është që të vihen në dukje ato aspekte socio-kulturore, të cilat kanë pika të përbashkëta, por mbartin edhe ndryshime.

Në përfundim zhvillohet një diskutim në klasë me qëllim që nxënësit të reflektojnë mbi vëshirësitë e hasura, mbi mangësitë dhe mbi aspekte që ata mund të përmisojnë.




# DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

## VI.1.2. Veprimtari të njësisë didaktike ‘Le Autonomie territoriale’ (Autonomitë territoriale)

### VEPRIMTARIA 1

*Vëreni imazhin dhe diskutoni në bazë të figurës së dhënë mbi përkufizimin e Kushtetutës. Interpretoni funksionin e imazhit trekëndësh në lidhje me Kushtetutën.*


**Fig. VI.1.**



### VEPRIMTARIA 2

*Vëreni me kujdes hartën e Italisë. Diskutoni lidhur me organizimin territorial italian.*

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR



### VEPRIMTARIA 3. LEXIM

*Po ju prezantojmë disa nene të Kushtetutës italiane lidhur me entet territoriale. Lexoni tekstin dhe nënvizoni termat juridikë të panjohur për ju.*

## DIDAKTIKA E GJUHËVE TË HUAJA TË SPECIALITETIT NË FUNKSION TË PËRVETËSIMIT TË KOMPETENCËS SË KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR

*Ar.114 La Repubblica si riparte in Regioni, Province, Comuni.*

